

URDHËR¹
Nr. 1072, datë 23.10.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJEVE TË LISTUARA”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 2, të nenit 53; pikës 3, të nenit 54; pikës 2, të nenit 55; pikës 2, të nenit 58, nenit 63; pikës 4, të nenit 64, nenit 67; pikës 2, të nenit 68; pikës 3, të nenit 70; pikës 2, të nenit 72; pikës 3, të nenit 73; pikës 4, të nenit 74; pikës 5, të nenit 76; dhe të pikës 2, të nenit 77, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të listuara”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

3. Me fillimin e efekteve të këtij urdhri, Rregullorja nr. 4, datë 11.6.2004, “Mbi kontrollin e sëmundjes së pseudopestit në shpendë”, urdhri nr. 405, datë 15.11.2007 “Për miratimin e rregullore ‘Mbi masat e marra specifike të sëmundjes së murtajës klasike të derrave’”, urdhri nr. 351, datë 15.7.2014, “Mbi masat e kontrollit të sëmundjes së aftës epizootike”, urdhri nr. 406, datë 19.9.2008, “Për miratimin e rregullore ‘Mbi masat veterinare për kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në Republikën e Shqipërisë’”, urdhri nr. 16, datë 15.1.2007, “Mbi miratimin e rregullore ‘Mbi masat specifike të kontrollit të sëmundjes së gjuhës blu’” dhe urdhri nr. 241, datë 30.7.2012, “Mbi kushtet specifike për kontrollin e murtajës afrikane të derrave”, shfuqizohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet e tij nga data 1.8.2027.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

RREGULLORE
PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE TË LISTUARA

PJESA 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

1. Kjo rregullore plotëson rregullat për ndërgjegjësimin, gatishmërinë dhe kontrollin e sëmundjeve që zbatohen në lidhje me sëmundjet e listuara, të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1 të nenit 9, të ligjit nr. 41/2025, këtu e në vijim “ligji nr. 41/2025”. Këto rregulla përfshijnë:

a) Pjesa II e kësaj rregulloreje përfshin rregullat për kafshët e mbajtura dhe të egra tokësore në veçanti:

¹ Kjo rregullore përafron rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2020/687 e datës 17 dhjetor 2019 që plotëson rregulloren (BE) 2016/429 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, në lidhje me rregullat për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të caktuara të listuara, dokument 02020R0687-20230503.

i. kreu I përcakton rregullat plotësuese për masat e kontrollit të sëmundjes në rast dyshimi dhe konfirmimi zyrtar të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët e mbajtura siç përcaktohet në nenet 53, 54, 55, 58 dhe 63, të ligjit nr. 41/2025;

ii. kreu II përcakton rregullat plotësuese në lidhje me stabilimentet në zonat e kufizuara në rastet e konfirmimit zyrtar të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët e mbajtura, siç përcaktohet në nenin 64 dhe 67, të ligjit nr. 41/2025;

iii. kreu III përcakton rregullat plotësuese në lidhje me ripopullimin e zonës së kufizuar me kafshë të mbajtura në rastet e konfirmimit zyrtar të një sëmundjeje të kategorisë A siç përcaktohet në nenin 63 dhe 68, të ligjit nr. 41/2025;

iv. kreu IV përcakton rregullat plotësuese në lidhje me masat e kontrollit të sëmundjes në rast dyshimi dhe konfirmimi zyrtar të një sëmundjeje të kategorisë A të kafshët e egra, siç përcaktohet në nenin 70, të ligjit nr. 41/2025;

v. kreu V përcakton rregullat plotësuese për masat e kontrollit të sëmundjeve në rast dyshimi dhe konfirmimi zyrtar të sëmundjeve të kategorisë B dhe C në kafshët tokësore, siç përcaktohet në nenin 74 dhe 77, të ligjit nr. 41/2025.

b) Pjesa III përfshin kafshët e mbajtura dhe të egra ujore në veçanti:

i. kreu I përcakton rregullat plotësuese për masat e kontrollit të sëmundjes në rast dyshimi dhe konfirmimi zyrtar të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët ujore siç përcaktohet në nenet 53, 54, 55, 58 dhe 63, të ligjit nr. 41/2025;

ii. kreu II përcakton rregullat plotësuese në lidhje me stabilimentet në zonat e kufizuara në rastet e konfirmimit zyrtar të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët e akuakulturës, siç përcaktohet në nenin 64 dhe 67, të ligjit nr. 41/2025;

iii. kreu III përcakton rregullat plotësuese në lidhje me masat e kontrollit të sëmundjes në rast dyshimi dhe konfirmimi zyrtar të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët e egra ujore, siç përcaktohet në nenin 70, të ligjit nr. 41/2025;

iv. kreu IV përcakton rregullat plotësuese për masat e kontrollit të sëmundjeve në rast dyshimi dhe konfirmimi zyrtar të sëmundjeve të kategorisë B dhe C në kafshët ujore, siç përcaktohet në nenin 74 dhe 77, të ligjit nr. 41/2025.

c) Pjesa IV mbulon dispozitat përfundimtare.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e përcaktuara në urdhrin nr. 277, datë 15.6.2022 *“Për zbatimin e disa rregullave për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të kategorive të listuara dhe krijimin e një liste të llojeve dhe grupeve të specieve që paraqesin rrezik të konsiderueshëm për përhapjen e këtyre sëmundjeve”* dhe udhëzimin nr. 17, datë 24.9.2021 *“Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike”*, përveç rasteve kur këto përkufizime mbulojnë terma që janë përcaktuar në paragrafin e dytë të këtij neni. Përveç kësaj, në kuptim të kësaj rregulloreje zbatohen edhe përkufizimet e mëposhtme:

1. *“Të brendshmet”* nënkupton mishin e freskët të ndryshëm nga ai i karkasës siç përcaktohet në pikën 7 të këtij neni, edhe nëse ai mbetet i lidhur natyrshëm me karkasën;

2. *“Embrion”* nënkupton fazën fillestare të zhvillimit të një kafshe ndërkohë që është në gjendje të transferohet te një nënë marrëse;

3. *“Karkasa e një kafshe thundrake”* nënkupton të gjithë trupin e një kafshe thundrake të therur ose të eliminuar pas:

- gjakderdhjes, në rastin e kafshëve të therura;
- eviscerimit;
- heqjes së gjymtyrëve në karpus dhe tarsus;
- heqjes së bishtit, gjirit, kokës dhe lëkurës, me përjashtim të kafshëve të llojit derra.

4. “Kulloshtrë” nënkupton lëngun e sekretuar nga gjëndrat e qumështit të kafshëve të mbajtura deri në pesë ditë pas lindjes, që është i pasur me antitropa dhe minerale dhe i paraprin prodhimin të qumështit të papërpunuar.

5. “Mallra të sigurta” nënkupton mallrat që mund të lëvizin pa nevojën e masave për shmangien e rrezikut posaçërisht kundër një sëmundjeje të caktuar të listuar, pavarësisht nga statusi i vendit ose zonës së origjinës, për atë sëmundjeje;

6. “Mish i freskët” nënkupton mishin, mishin e grirë dhe përgatitjet e mishit, duke përfshirë atë të mbështjellë me vakum ose të mbështjellë në një atmosferë të kontrolluar, i cili nuk ka pësuar asnjë proces tjetër përveç ftohjes, ngrirjes ose ngrirjes së shpejtë;

7. “Mjet transporti” nënkupton mjetin rrugor ose hekurudhor, anijet dhe avionët;

8. “Ovocite” nënkupton fazat haploide të otidogjenezës duke përfshirë ovocitet dytësore dhe vezët;

9. “Produkte me bazë kulloshtrë” nënkupton produktet e përpunuara që rezultojnë nga përpunimi i kulloshtrës ose nga përpunimi i mëtejshëm i produkteve të tilla të përpunuara;

10. “Produkte mishi” nënkupton produktet e përpunuara, duke përfshirë stomakun e trajtuar, fshikëzën, zorrët, yndyrnat e përpunuara, ekstraktet e mishit dhe produktet e gjakut, që rezultojnë nga përpunimi i mishit ose nga përpunimi i mëtejshëm i këtyre produkteve të përpunuara, në mënyrë që sipërfaqja e prerë të tregojë që produkti nuk ka më karakteristikat e mishit të freskët;

11. “Spermë” nënkupton materiali i përfutur nga ejakulimi e një kafshe ose kafshësh, qoftë në gjendje të pandryshuar, të përgatitur ose të holluar;

12. “Zogjtë njëditor” nënkupton shpendët më pak se 72 orë;

13. “Zinxhir furnizimi” nënkupton një zinxhir i integruar prodhimi i një statusi të përbashkët shëndetësor për sa u përket sëmundjeve të listuara, i përbërë nga një rrjet bashkëpunues stabilimentesh të specializuara, të miratuara nga autoriteti kompetent për qëllimin e nenit 45, ndërmjet të cilit kafshët zhvendosen për të përfunduar ciklin e prodhimit;

14. “Zonë e infektuar” nënkupton një zonë në të cilën mund të zbatohen kufizime për lëvizjen e kafshëve të mbajtura dhe të egra ose produkteve dhe masa të tjera të kontrollit të sëmundjeve dhe biosigurisë me synimin për të parandaluar përhapjen e një sëmundjeje të kategorisë A në rast zyrtar konfirmimi të sëmundjes të kafshët e egra;

15. “Zorrët” nënkupton fshikëzat dhe zorrët që pas pastrimit janë përpunuar përmes heqjes së indeve, largimit të yndyrës dhe larjes dhe janë trajtuar me kripë ose janë tharë.

Neni 3

Kontrollet klinike, procedurat e kampionimit dhe metodat diagnostike

1. Kur kërkohen kontrole klinike të kafshëve në përputhje me këtë rregullore, për të konfirmuar ose përjashtuar praninë e një sëmundjeje të kategorisë A, Autoriteti Kompetent i kontroleve zyrtare siç përcaktohet në Ligjin nr. 41/2025, siguron që:

a) Marrja e mostrave të kafshëve për ekzaminim klinik të kryhet në përputhje me:

i. pikën A.1, të shtojcës I për kafshët tokësore; dhe

ii. pikën 1, të shtojcës XII për kafshët ujore;

b) Kontrolli klinik përfshin:

i. një vlerësim fillestar të përgjithshëm të statusit shëndetësor të kafshëve të stabilimentit, që përfshin të gjitha kafshët e specieve të listuara që mbahen në stabiliment; dhe

ii. një kontroll individual të kafshëve të përfshira sipas shembullit të përmendur në shkronjën (a).

2. Kur kërkohen ekzaminime laboratorike në përputhje me këtë rregullore, për të konfirmuar ose përjashtuar praninë e një sëmundjeje të kategorisë A, autoriteti kompetent i kontroleve zyrtare siguron që:

a) Marrja e mostrave të kafshëve për ekzaminim laboratorik të kryhet në përputhje me:

i. pikën A.2, të shtojcës I për kafshët tokësore; dhe

- ii. pikën 1, shkronja b, c, ç dhe d, të shtojcës XII për kafshët ujore;
- b) Metodën diagnostike për ekzaminimet laboratorike të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në:
 - i. shkronjën “b”, të shtojcës I për kafshët tokësore; dhe
 - ii. pikën 2, të shtojcës XII për kafshët ujore.
- c) Mostrat dërgohen:
 - i. pa vonesë në një laborator zyrtar brenda vendit dhe/ose në një laborator reference të BE-së;
 - ii. në përputhje me shkronjën c, të shtojcës I për kafshët tokësore dhe shkronjën f, të pikës 1, të shtojcës XII për kafshët ujore; dhe
 - iii. duke ndjekur çdo udhëzim tjetër nga autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare dhe nga laboratori në lidhje me kushtet e biosigurisë dhe kushtet e sigurisë në laborator për të parandaluar përhapjen e agjentëve të sëmundjeve të kategorisë A;
- ç) në rastin e kafshëve të mbajtura:
 - i. përpilohet një inventar i të gjitha kafshëve të mbajtura në stabiliment, specieve dhe kategorive të tyre. Për shpendët dhe kafshët e akuakulturës mund të përllogaritet numri i kafshëve; dhe
 - ii. vendoset një shenjë identifikimi për çdo kafshë prej së cilës është marrë mostër të specieve të listuara, ose në rastin e shpendëve dhe kafshëve të akuakulturës, regjistrohet numri i serisë.

Neni 4 **Plani i Kontigjencës**

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare zbaton masat e përcaktuara në këtë rregullore dhe në përputhje me planin e kontigjencës të përmendur në nenin 43, të ligjit nr. 41/2025.

PJESA II KAFSHËT TOKËSORE

KREU I MASAT E KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE PËR SËMUNDJET E KATEGORISË A NË KAFSHËT E MBAJTURA TOKËSORE

Seksioni 1 **Masat paraprake të kontrollit të sëmundjes në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në kafshët e mbajtura**

Neni 5 **Detyrimet e operatorëve në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në kafshët e mbajtura në një stabiliment**

Në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në kafshët e mbajtura, operatorët marrin masat e mëposhtme të kontrollit të sëmundjes për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A nga kafshët e prekura dhe stabilimentet nën përgjegjësinë e tyre të kafshët e tjera të paprekura ose të njerëzit, derisa autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare përjashton praninë e sëmundjes së kategorisë A, duke:

- a) izoluar të gjitha kafshët e dyshuara që janë të infektuara me sëmundje të kategorisë A;
- b) mbajtur plehun, duke përfshirë jashtëqitjet, shtrojen e përdorur dhe çdo produkt, material ose substancë që mund të jetë e kontaminuar dhe të transmetojë sëmundje të kategorisë A, të izoluar dhe të mbrojtura nga insektet, brejtësit, kafshët e mbajtura të specieve të palistuar dhe kafshët e egra në masën që është teknikisht dhe praktikisht e realizueshme;
- c) zbatuar masat e duhura shpesh të biosigurisë për të shmangur çdo rrezik të përhapjes së sëmundjes së kategorisë A;

ç) ndërprerë të gjitha lëvizjet e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara nga ose drejt stabilimentit;

d) parandaluar lëvizjet jo të domosdoshme të specieve të kafshëve që nuk janë të listuara, produkteve, materialeve, substancave, personave dhe mjeteve të transportit nga ose drejt stabilimentit;

dh) siguruar që të dhënat e prodhimit, shëndetit dhe gjurmueshmërisë së stabilimentit të jenë të përditësuara;

e) i dhënë autoritetit kompetent të kontrolleve zyrtare, me kërkesën e tij, çdo informacion përkatës në lidhje me sëmundjen e kategorisë A; dhe

f) ndjekur çdo udhëzim të dhënë nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare në lidhje me kontrollin e sëmundjes së kategorisë A, në përputhje me ligjin nr. 41/2025.

Neni 6

Hetimi nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në kafshët e mbajtura në një stabiliment

1. Në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në kafshët e mbajtura në një stabiliment, në përputhje me legjislacionin për rregullat për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin pa sëmundje për disa sëmundje të listuara dhe ato emergjente, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare kryen menjëherë një hetim për të konfirmuar ose përjashtuar praninë e sëmundjes së listuar të dyshuar.

2. Gjatë hetimit të përmendur në pikën 1, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare siguron që veterinerët zyrtarë të kryejnë të paktën:

- a) kontrollet klinike të kafshëve të mbajtura të specieve të listuara në stabiliment; dhe
- b) marrjen e mostrave për ekzaminime laboratorike.

Neni 7

Masat paraprake të kufizimit dhe biosigurisë në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në kafshët e mbajtura në një stabiliment

1. Në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në një stabiliment, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare vendos stabilimentin nën mbikëqyrje zyrtare dhe masat paraprake të kufizimit dhe të biosigurisë, për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A nga kafshët e prekura dhe stabilimenti, për të kafshët e tjera të paprekura ose të njerëzit. Këto masa përfshijnë:

- a) ndalimin e lëvizjeve të kafshëve të mbajtura të specieve të listuara për dhe nga stabilimenti;
- b) ndalimin e lëvizjeve të kafshëve të mbajtura të specieve të palistuara për dhe nga stabilimenti;
- c) ndalimin e lëvizjeve të çdo produkti, materiali ose lënde që mund të jetë i kontaminuar me ose mund të transmetojë sëmundje të kategorisë A nga stabilimenti;
- ç) izolimin e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara dhe mbrojtja e tyre nga kafshët e egra, kafshët e specieve të palistuara dhe kur është e nevojshme nga insektet dhe brejtësit;
- d) ndalimin e eliminimit të kafshëve të specieve të listuara, përveç nëse autorizohet nga autoriteti kompetent; dhe
- dh) ndalimin e lëvizjeve jo të domosdoshme të produkteve, materialeve, substancave, personave dhe mjeteve të transportit për në stabiliment.

2. Me përjashtim të shkronjës a, b dhe c, të pikës 1, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të autorizojë lëvizjet e kafshëve dhe produkteve nga stabilimenti, ku dyshohet për një sëmundje të kategorisë A, pas kryerjes së një vlerësimi të riskut, dhe me kusht që:

- a) lëvizjet e kafshëve dhe produkteve janë në përputhje me të gjitha kushtet dhe masat e biosigurisë të nevojshme për të shmangur përhapjen e sëmundjes;
- b) në stabilimentin e destinacionit nuk ka kafshë të tjera të mbajtura të specieve të listuara; dhe

c) stabilimenti i destinacionit nuk është një thertore.

3. Kur jepen përjashtime të parashikuara në pikën 2, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të vendosë masat e kontrollit të sëmundjes të parashikuara në pikën 1 në stabilimentin e destinacionit.

4. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të urdhërojë eliminimin parandalues, në përputhje me pikat 1 dhe 2, të nenit 12, të kafshëve të specieve të listuara, në stabilimentin ku dyshohet për një sëmundje të kategorisë A, kur situata epidemiologjike e kërkon.

5. Të gjitha nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor nga kafshë të ngordhura, të cilat kanë ngordhur ose janë eliminuar në stabilimentin ku dyshohet për një sëmundje të kategorisë A, përpunohen ose asgjësohen në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, për të siguruar që agjenti i sëmundjes së dyshuar është inaktivizuar dhe për të parandaluar përhapjen e sëmundjes të kafshët e paprekura ose të njerëzit.

Neni 8

Analiza e inventarit dhe të dhënave në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në kafshët e mbajtura në një stabiliment

1. Në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron dhe verifikon pa vonesë që operatorët e stabilimenteve, ku dyshohet për një sëmundje të kategorisë A, të hartojnë dhe të mbajnë një inventar të përditësuar, për:

a) speciet, kategoritë dhe numri i kafshëve që mbahen në stabiliment. Për shpendët, numri i kafshëve mund të përlogaritet;

b) numrin e matrikullit të të gjitha kafshëve të specieve për të cilat identifikimi individual është i detyrueshëm në përputhje me urdhrin nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave për regjistrimin e kafshëve në bazën kombëtare të të dhënave dhe gjurmueshmërinë e tyre”;

c) speciet, kategoritë dhe numrin e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara të cilat kanë lindur, ngordhur, shfaqur shenja klinike ose mund të jenë të infektuara ose të kontaminuara me sëmundjen e kategorisë A në stabiliment;

ç) çdo produkt, material ose substancë që mund të jetë i kontaminuar ose mund të transmetojë sëmundjen përkatëse të kategorisë A në stabiliment; dhe

d) kur është e nevojshme, të gjitha vendet (mjediset) që kanë gjasa të mundësojnë mbijetesën e vektorëve të sëmundjes përkatëse të kategorisë A në stabiliment.

2. Kur stabilimenti përbëhet nga disa njësi epidemiologjike, informacioni në pikën 1 specifikohet për secilën njësi epidemiologjike.

3. Në kuadër të hetimit epidemiologjik, siç përcaktohet në nenin 57, të ligjit nr. 41/2025, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare analizon të paktën të dhënat e mëposhtme të stabilimentit ku dyshohet për një sëmundje të kategorisë A:

a) inventarin e përmendur në pikën 1;

b) të dhënat në lidhje me origjinën dhe datën e mbërritjes dhe nisjes në ose nga stabilimenti i kafshëve të mbajtura të specieve të listuara;

c) të dhënat në lidhje me origjinën dhe datën e mbërritjes dhe nisjes në ose nga vendi i stabilimenteve të tjera nga ku mund të ketë lëvizje të nevojshme për transport;

ç) të dhënat e prodhimit; dhe

d) të dhënat në lidhje me vizitat në stabilimente, nëse janë të disponueshme.

4. Analiza e të dhënave të përmendura në pikën 3 mbulon të paktën periudhën e monitorimit të përcaktuar në shtojcën II për sëmundjen përkatëse, e llogaritur retrospektivisht nga data në të cilën është njoftuar dyshimi.

Neni 9

Zonat e përkohshme të kufizuara në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në kafshët tokësore të mbajtura në një stabiliment

1. Në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në kafshët e mbajtura në një stabiliment, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare krijon një zonë të përkohshme të kufizuar duke marrë parasysh rrethanat e mëposhtme:

- a) vendndodhjen e stabilimentit në një zonë me një dendësi të lartë të kafshëve të mbajtura të specieve të listuara për të cilat dyshohet një sëmundje e kategorisë A;
- b) lëvizjen e kafshëve ose personave në kontakt me kafshët e mbajtura të specieve të listuara për të cilat dyshohet për një sëmundje të kategorisë A;
- c) vonesa në konfirmimin e sëmundjes së kategorisë A në përputhje me nenin 11;
- ç) informacioni i pamjaftueshëm për origjinën dhe rrugët e mundshme të paraqitjes së sëmundjes së kategorisë A të dyshuar; dhe
- d) profilin e sëmundjes, në veçanti rrugët, shpejtësinë e transmetimit të sëmundjes dhe vazhdimësinë e sëmundjes në popullatën e kafshëve.

2. Në stabilimentet brenda zonës së përkohshme të kufizuar, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare zbaton të paktën masat e parashikuara në nenin 7.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mban zonën e përkohshme të kufizuar deri në momentin që prania e sëmundjes së kategorisë A është përjashtuar në stabilimentin ku dyshohet ose është konfirmuar prania e asaj sëmundje dhe është krijuar një zonë e kufizuar në përputhje me nenin 21 të kësaj rregulloreje.

4. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të urdhërojë eliminimin parandalues, në përputhje me pikat 1 dhe 2 të nenit 12, ose therjen e kafshëve të specieve të listuara, në zonat e përkohshme të kufizuara kur këtë e kërkon situata epidemiologjike.

Neni 10

Masat që zbatohen në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, pikat e kontrollit kufitar, stabilimentet e nënprodukteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor ose çdo vendndodhje tjetër të rëndësishme, duke përfshirë mjetet e transportit

1. Në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në përputhje me legjislacionin për rregullat për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin pa sëmundje për disa sëmundje të listuara dhe ato emergjente, në bizneset ushqimore dhe ushqimit për kafshë, pikat e kontrollit kufitar, stabilimentet e nënprodukteve të kafshëve ose çdo vendndodhje tjetër të rëndësishme, duke përfshirë mjetet e transportit, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare të zbatojë:

- a) dispozitat përkatëse të përcaktuara në nenet 5 deri në 9; dhe
- b) nëse është e nevojshme, masa shtesë të përshtatura për situatën specifike për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A të kafshët e paprekura ose të njerëzit.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare zbaton gjithashtu dispozitat e përcaktuara në nenet 5 deri në 9 në stabilimentet e origjinës së kafshëve ose produkteve të pranishme në stabiliment dhe vendndodhjet e përmendura në pikën 1, të cilat dyshohet se janë të infektuara dhe të bashkëpunojnë me autoritete përgjegjëse për inspektimin dhe kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë sipas fushës së veprimt.

Seksioni 2

Masat e kontrollit të sëmundjeve në rast të konfirmimit zyrtar të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshë të mbajtura

Neni 11

Konfirmimi zyrtar i një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët e mbajtura tokësore

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare konfirmon zyrtarisht një shpërthim të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët tokësore të mbajtura kur një rast konfirmohet në përputhje me legjislacionin për rregullat për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin pa sëmundje për disa sëmundje të listuara dhe ato emergjente.

Neni 12

Masat e kontrollit të sëmundjeve në rast të konfirmimit zyrtar të një shpërthimi të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët e mbajtura në një stabiliment

1. Pas konfirmimit zyrtar të një shpërthimi të një sëmundjeje të kategorisë A në një stabiliment në përputhje me nenin 11, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron që, përveç masave të parashikuara në nenin 7, zbatimin e menjëhershëm të masave të mëposhtme të kontrollit të sëmundjes nën mbikëqyrjen e veterinerëve zyrtarë:

a) të gjitha kafshët e specieve të listuara që mbahen në stabilimentin e prekur eliminohen në vend sa më shpejt të jetë e mundur, brenda stabilimentit, në mënyrë të tillë që të shmanget çdo rrezik i përhapjes së agjentit përkatës të sëmundjes së kategorisë A gjatë dhe pas eliminimit;

b) marrjen e të gjitha masave të duhura dhe të nevojshme të biosigurisë për të shmangur çdo përhapje të mundshme të sëmundjes së kategorisë A të kafshët e paprekura të mbajtura, të egra ose të njerëzit;

c) asgjësimin e trupave ose pjesëve të kafshëve të mbajtura të specieve të listuara që kanë ngordhur ose që janë eliminuar në përputhje me shkronjën “a” të këtij paragrafi në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor;

ç) izolimin e të gjitha produkteve, materialet ose substancat potencialisht të kontaminuara të pranishme në stabiliment derisa:

i. ato asgjësohen ose përpunohen në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, në rastin e nënprodukteve shtazore jo për konsum njerëzor (përfshirë ato që rezultojnë nga eliminimi, produktet me origjinë shtazore dhe produktet germinale);

ii. masat e pastrimit dhe dezinfektimit kryhen në përputhje me nenin 15, në rastin e materialeve dhe substancave të tjera të përshtatshme për pastrim dhe dezinfektim;

iii. asgjësimi kryhet nën mbikëqyrjen e veterinerëve zyrtarë, në rastin e ushqimit për kafshë dhe materialeve të tjera të papërshtatshme për pastrim dhe dezinfektim.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron dhe mbikëqyr, që:

a) transporti nga stabilimenti i prekur i nënprodukteve të kafshëve të përmendura në shkronjën “c”, të pikës 1 dhe shkronjën “ç”, (i); të pikës 1 të këtij neni, është në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor;

b) transporti nga stabilimenti i prekur i materialeve ose substancave të përmendura në shkronjën “ç”, (iii); të pikës 1 të këtij neni, është në përputhje me udhëzimet në lidhje me kushtet e biosigurisë dhe kushtet e sigurisë për të parandaluar përhapjen e agjentit të sëmundjes së kategorisë A.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mbledh mostra për ekzaminim laboratorik nga kafshët e mbajtura të specieve të listuara, para ose kur ato eliminohen ose ngordhin, për qëllimet e hetimit epidemiologjik të përmendur në nenin 57, të ligjit nr. 41/2025.

4. Duke përjashtuar shkronjën “a”, të pikës 1 të këtij neni, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, pasi të kryejë një vlerësim të riskut dhe duke marrë parasysh mundësinë e zbatimit të masave të tjera zbutëse të rrezikut, mund të vendosë:

a) të urdhërojë eliminimin e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara në vendin më të afërt të përshtatshëm në mënyrë të tillë që të shmanget çdo rrezik i përhapjes së sëmundjes së kategorisë A gjatë eliminimit, transportit; ose

b) të shtyjë eliminimin e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara, me kusht që ato kafshë t'i nënshtrohen vaksinimit urgjent siç parashikohet në nenin 69, të ligjit nr. 41/2025.

Neni 13

Përfashtime specifike të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 12

1. Në rast të një shpërthimi të një sëmundjeje të kategorisë A në stabilimente që mbajnë kafshë të specieve të listuara në dy ose më shumë njësi epidemiologjike, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të lejojë përfashtime nga shkronja “a”, e pikës 1, të nenit 12, për njësitë epidemiologjike në të cilat sëmundja nuk është konfirmuar, pas kryerjes së një vlerësimi të rrezikut dhe, kur është e nevojshme, pas marrjes së rezultateve të favorshme në ekzaminimet laboratorike, dhe me kusht që:

a) hetimi epidemiologjik i përcaktuar në nenin 57, të ligjit nr. 41/2025 nuk ka zbuluar ndonjë lidhje epidemiologjike midis njërive epidemiologjike në të cilat është konfirmuar sëmundja e kategorisë A dhe atyre në të cilat sëmundja nuk është konfirmuar, për të dyshuar për përhapjen e sëmundjes së kategorisë A midis tyre; dhe

b) Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare ka konfirmuar se, të paktën gjatë periudhës së monitorimit, të përcaktuar në shtojcën II për sëmundjen përkatëse, përpara konfirmimit të sëmundjes së kategorisë A, njësitë epidemiologjike në të cilat sëmundja nuk është konfirmuar janë mbajtur krejtësisht të ndara dhe të trajtuara nga personel i ndryshëm.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të lejojë përfashtime nga shkronja a, e pikës 1, të nenit 12, për kategoritë e mëposhtme të kafshëve me kusht që të plotësohen kushtet në pikën 3:

a) kafshët e mbajtura në një stabiliment të mbyllur;

b) kafshët e mbajtura për qëllime shkencore ose qëllime që lidhen me ruajtjen e specieve të mbrojtura ose të rrezikuara;

c) kafshët e regjistruara zyrtarisht paraprakisht si raca të rralla; dhe

ç) kafshët me një vlerë të lartë gjenetike, kulturore ose edukative të justifikuar siç duhet.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare siguron që të plotësohen kushtet e mëposhtme kur jep përfashtimin e parashikuar në paragrafin 2:

a) autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare ka kryer një vlerësim të dhënies së efekteve të këtij përfashtimi dhe në veçanti të efekteve në statusin e shëndetit të kafshëve në vend dhe në rastet e importit për vendet nga është kryer importi i kafshëve, ku rezultati i këtij vlerësimi ka treguar se gjendja shëndetësore e kafshëve nuk është e rrezikuar;

b) zbatohen masat e duhura të biosigurisë për të parandaluar rrezikun e transmetimit të sëmundjes së kategorisë A të kafshët e mbajtura të paprekura, të kafshët e egra ose të njerëzit, duke marrë parasysh:

i. profilin e sëmundjes; dhe

ii. speciet e prekura të kafshëve;

c) kafshët i nënshtrohen izolimit dhe mbikëqyrjes klinike të përshtatëshme, duke përfshirë ekzaminimet laboratorike, derisa autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare të sigurojë që kafshët nuk paraqesin rrezik për transmetimin e sëmundjes së kategorisë A.

4. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të lejojë përfashtime specifike nga shkronja “a”, e pikës 1, të nenit 12, për kafshët e familjes së kuajve të mbajtura në stabilimentet ku është konfirmuar një shpërthim i sëmundjes të kategorisë A të përmendur në shtojcën III, sipas kushteve të përcaktuara në atë shtojcë.

Neni 14

Masat shtesë të kontrollit të sëmundjes në rast të një shpërthimi të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët tokësore të mbajtura në një stabiliment

1. Përveç masave të parashikuara në nenin 12, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare vendos procedurat e marrjes së mostrave për kafshët e mbajtura të specieve të palistuara dhe kafshët e egra të specieve të listuara, bazuar në informacionin e marrë nga hetimi epidemiologjik i përcaktuar në nenin 57, të ligjit nr. 41/2025.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, pas kryerjes së një vlerësimi të riskut të përhapjes së mëtejshme të sëmundjes përkatëse të kategorisë A dhe duke marrë parasysh mundësinë e zbatimit të masave të tjera për zbutjen e riskut, urdhëron eliminimin e kafshëve të mbajtura të specieve të palistuara dhe kafshëve të egra në mënyrë të tillë që të shmanget çdo rrezik i përhapjes së sëmundjes së kategorisë A gjatë eliminimit, transportit dhe deri në asgjësimin e të gjithë kadavrave ose pjesëve të kafshëve të ngordhura.

Neni 15

Pastrimi, dezinfektimi paraprak, kontrolli i insekteve dhe brejtësve në stabilimentin e prekur

1. Menjëherë pas përfundimit të masave të parashikuara në nenin 12, dhe kur është e nevojshme në nenin 14, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, mbikëqyr dhe urdhëron një pastrim dhe dezinfektim paraprak dhe sipas rastit, kontrollin e insekteve dhe brejtësve, në stabilimentin e prekur për të shmangur përhapjen e sëmundjes së kategorisë A.

2. Pastrimi, dezinfektimi dhe kontrolli paraprak i përmendur në pikën 1:

a) kryhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në shkronjat A dhe B, të shtojcës IV duke përdorur produktet e duhura biocide për të siguruar shkatërrimin e agjentit përkatës të sëmundjes së kategorisë A; dhe

b) dokumentohet në mënyrën e duhur.

3. Kur autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare jep një nga përjashtimet e parashikuara në pikën 2 dhe 4 të nenit 13, ai urdhëron pastrimin paraprak, dezinfektimin dhe kontrollin e përmendur në pikën 1, duke përshtatur procedurat e përmendura në shkronjën “a”, të pikës 2 të këtij neni, për situatën specifike pa penguar kontrollin e përhapjes së sëmundjes së kategorisë A nga kafshët e prekura, stabilimentet dhe zonat e prekura të kafshët e tjera të paprekura ose të njerëzit.

4. Përveç masave të përmendura në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron dhe mbikëqyr që mjetet e transportit të përdorura për transportin e kafshëve drejt dhe nga stabilimenti i prekur të pastrohen dhe dezinfektohen siç duhet dhe, sipas rastit, t'i nënshtrohen masave që sigurojnë kontrollin e insekteve dhe brejtësve.

Neni 16

Përjashtime dhe rregulla të veçanta për pastrimin dhe dezinfektimin paraprak dhe kontrollin e vektorëve

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të lejojë përjashtime ndaj kërkesës në lidhje me pastrimin, dezinfektimin dhe kontrollin e insekteve dhe brejtësve të përcaktuar në nenin 15, në rast se:

a) kullotat e lidhura epidemiologjikisht me stabilimentin e prekur, sipas procedurave specifike për të siguruar inaktivizimin efektiv të agjentit përkatës të sëmundjes së kategorisë A, duke marrë parasysh profilin e sëmundjes, llojin e stabilimentit, kushtet klimatike; dhe

b) plehun organik, duke përfshirë shtrojat dhe materialet e përdorura për shtrojat, nga stabilimenti i prekur, sipas procedurave specifike për të siguruar inaktivizimin efektiv të agjentit përkatës të sëmundjes së kategorisë A në përputhje me provat shkencore.

Neni 17

Identifikimi i stabilimenteve të lidhura epidemiologjikisht dhe vendndodhjeve të tjera të rëndësishme, duke përfshirë mjetet e transportit

1. Në kuadër të hetimit epidemiologjik, siç përmendet në nenin 57, të ligjit nr. 41/2025 dhe me qëllim identifikimin e të gjitha stabilimenteve të lidhura epidemiologjikisht dhe vendndodhjet e tjera të rëndësishme, duke përfshirë mjetet e transportit, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare gjurmon të gjitha kafshët e mbajtura të pranishme në stabilimentet ku është konfirmuar një shpërthim i një sëmundjeje të kategorisë A dhe çdo produkt, material, lëndë, mjet transporti ose njerëz që mund të përhapin sëmundjen përkatëse të kategorisë A, duke përfshirë:

- a) ata që dërgohen në dhe nga stabilimenti; dhe
- b) ata që kanë hyrë në kontakt me stabilimentin.

2. Gjurmimi i përmendur në pikën 1 mbulon të paktën periudhën e monitorimit, të përcaktuar shtojcën II për sëmundjen përkatëse, të llogaritur retrospektivisht nga data kur dyshimi është njoftuar.

3. Pas kryerjes së një vlerësimi të rrezikut, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të përjashtojë nga gjurmimi i përmendur në pikën 1 ato produkte që konsiderohen si mallra të sigurta, siç parashikohet në shtojcën VII.

Neni 18

Masat që zbatohen në stabilimentet e lidhura epidemiologjikisht dhe vendndodhje të tjera të rëndësishme, duke përfshirë mjetet e transportit

1. Kur gjurmimi i parashikuar në pikën 1, të nenit 17 tregon se kafshët e specieve të listuara janë dërguar nga ose në stabilimentin e prekur gjatë periudhës së përmendur në pikën 2, të nenit 17, autoriteti kompetent:

- a) kryen hetime dhe vendos masa kufizimi dhe biosigurie në përputhje me nenet 6, 7 dhe nenin 8 në stabilimentet e destinacionit ose origjinës së lëvizjes; ose
- b) zgjeron menjëherë masat në nenin 12 për vendin e origjinës ose përcaktimin e destinacionit të lëvizjes në rast se ka prova epidemiologjike të përhapjes së sëmundjes në, nga ose nëpërmjet këtij stabilimenti.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare zbaton masat e përmendura në pikën 1 në stabilimente dhe vendndodhje të tjera të rëndësishme, duke përfshirë mjetet e transportit, që mund të kontaminohen si rezultat i kontaktit me kafshët, produktet, materialet, substancat, personat ose mjetet e transportit nga stabilimenti i prekur i identifikuar në kuadër të gjurmimit të përmendur në nenin 17 ose bazuar në çdo informacion tjetër përkatës nga hetimi epidemiologjik, siç përcaktohet në nenin 57, të ligjit nr. 41/2025.

Neni 19

Masat që duhen zbatuar për produktet e identifikuara nga gjurmimi

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron dhe mbikëqyr që sperma, ovocitet dhe embrionet e identifikuara si të kontaminuara nga gjurmimi i përmendur në nenin 17 asgjësohen në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron dhe mbikëqyr trajtimin, përpunimin ose asgjësimin e produkteve të identifikuara nga gjurmimi i përmendur në nenin 17, të paktën deri në:

- a) stabilimentin e parë të përpunimit të ushqimit në rastin e produkteve me origjinë shtazore;
- b) vendin për çeljen e zogjve ose stabilimenti ku vezët janë dërguar për çelje, në rastin e vezëve për çelje të cilat ende nuk kanë çelur; dhe
- c) stabilimentin e parë të përpunimit në rastin e produkteve me origjinë shtazore, përveç plehut organik; ose

ç) vendin ku ruhet, në rastin e plehut organik, duke përfshirë shtrojën dhe materialin e përdorur për shtrojë.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare vendos kryerjen e mbikëqyrjes zyrtare mbi zogjtë e çelur gjatë periudhës së gjurmimit të përmendur në pikën 2, të nenit 17 nga vezët për çelje me origjinë nga stabilimenti i prekur. Kjo mbikëqyrje vendoset në të gjitha stabilimentet e destinacionit të vezëve për çelje dhe mbahet për një periudhë kohore prej 21 ditësh pas çeljes.

4. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron dhe mbikëqyr që transporti nga stabilimentet e nënprodukteve shtazore jo për konsum njerëzor t'i nënshtrohet rregullave të përcaktuara në legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor.

5. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron dhe mbikëqyr që materialet ose substancat që mund të jenë të kontaminuara ose që mund të transmetojnë sëmundjen përkatëse të kategorisë A, të jenë në përputhje me udhëzimet e tij në lidhje me kushtet e biosigurisë dhe sigurisë në laborator për të parandaluar përhapjen e agentit të sëmundjes së kategorisë A.

Neni 20

Masat që zbatohen në rast konfirmimi zyrtar të një shpërthimi të një sëmundjeje të kategorisë A në bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, pikat e kontrollit kufitar, stabilimentet e nënprodukteve të kafshëve dhe çdo vendndodhje tjetër me rëndësi, duke përfshirë mjetet e transportit

1. Në rast të konfirmimit zyrtar të një shpërthimi në përputhje me nenin 11, në bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, pikat e kontrollit kufitar, stabilimentet e nënprodukteve të kafshëve dhe çdo vendndodhje tjetër me rëndësi, duke përfshirë mjetet e transportit, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare zbaton:

- a) rregullat përkatëse të përcaktuara në nenet 12 deri në 19; dhe
- b) nëse është e nevojshme, masa shtesë të përshtatura për situatën specifike për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A nga kafshët e prekura, stabilimentet dhe vendet e prekura të kafshët e tjera të paprekura ose të njerëzit.

2. Autoritetet kompetente të kontrolleve zyrtare, sipas fushës së veprimit për veterinarinë dhe sigurinë ushqimore zbatojnë rregullat e përcaktuara në nenet 12 deri në 19 edhe në stabilimentet e origjinës së kafshëve ose produkteve të prekura të pranishme në stabilimentet dhe vendet e përmendura në pikën 1.

KREU II

MASAT E KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE PËR SËMUNDJET E KATEGORISË A TË KAFSHËVE TË MBAJTURA TOKËSORE NË ZONAT E KUFIZUARA

Seksioni 1

Masat e përgjithshme të kontrollit të sëmundjes në zonën e kufizuar

Neni 21

Përcaktimi i një zone të kufizuar

1. Në rast të një shpërthimi të një sëmundjeje të kategorisë A në një stabiliment, biznes ushqimor dhe ushqimi për kafshë, stabiliment e nënprodukteve të kafshëve ose çdo vendndodhje tjetër me rëndësi, duke përfshirë mjetet e transportit, autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare vendos menjëherë rreth stabilimentit ose vendit të prekur një zonë të kufizuar, e cila përfshin:

- a) një zonë mbrojtjeje bazuar në rrezen minimale nga shpërthimi i përcaktuar për sëmundjen përkatëse të kategorisë A, në shtojcën V;
- b) një zonë mbikëqyrjeje bazuar në rrezen minimale nga shpërthimi i përcaktuar për sëmundjen përkatëse të kategorisë A, në shtojcën V; dhe

c) nëse është e nevojshme, në bazë të kriterëve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 41/2025, zona të mëtejshme të kufizuara përreth ose ngjitur me zonat e mbrojtjes dhe të mbikëqyrjes, ku autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare zbaton të njëjtat masa si ato të parashikuara në Seksionin 3 të këtij kreu për zonën e mbikëqyrjes.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare përshtat kufijtë e zonës fillestare të kufizuar, duke përfshirë kufijtë për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe zonave të tjera të kufizuara, në rast të mbivendosjes së dy ose më shumë zonave të kufizuara për shkak të shpërthimeve të mëtejshme të sëmundjes së kategorisë A.

3. Me përjashtim të pikës 1, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare vendos, pas kryerjes së një vlerësimi risku, duke marrë parasysh profilin e sëmundjes, të mos krijojë një zonë të kufizuar kur një shpërthim i një sëmundjeje të kategorisë A ndodh në vendet e mëposhtme:

- a) stabilimentet që mbajnë kafshë të përcaktuara në pikën 2, të nenit 13;
- b) vendet e çeljes;
- c) bizneset ushqimore dhe ushqimit për kafshë, pikat e kontrollit kufitar, stabilimentet e nënprodukteve të kafshëve;
- ç) mjetet e transportit;
- d) vendet ku zhvillohen veprimtaritë e grumbullimit ose ekspozimit të përkohshëm ose asistencës veterinarë të kafshëve;
- dh) çdo vendndodhje tjetër që nuk është një stabiliment; dhe
- e) stabilimentet që mbajnë deri në 50 zogj të mbajtur në kaptivitet/robëri, me kusht që të mos kenë kontakt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me shpendët ose stabilimentet e tjera që mbajnë zogj të mbajtur në kaptivitet/robëri.

Neni 22

Masat që duhen zbatuar në zonën e kufizuar

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare përpilon pa vonesë dhe mban të përditësuar një inventar të të gjitha stabilimenteve që mbajnë kafshë të specieve të listuara, të vendosura në zonën e kufizuar, duke përfshirë speciet, kategoritë dhe numrin e kafshëve në çdo stabiliment. Për shpendët, numri i kafshëve mund të përllogaritet.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, për të parandaluar përhapjen e sëmundjes dhe bazuar në informacionin epidemiologjik ose prova të tjera, zbaton eliminimin parandalues, në përputhje me pikat 1 dhe 2, të nenit 12, ose therjen e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara në stabilimentet e vendosura në zonën e kufizuar.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron dhe mbikëqyr që lëvizjet e të gjithë kadavrave ose pjesëve të kafshëve të egra dhe kafshëve të mbajtura të ngordhura të specieve të listuara nga zona e kufizuar, të dërgohen për përpunim ose asgjësim në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor në një qendër përpunimi (*rendering plant*) të miratuar për këto qëllime:

- a) brenda territorit të vendit; ose
- b) në një shtet tjetër në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, kur nuk është e mundur të përpunohen ose asgjësohen të gjithë kadavrat ose pjesët e kafshëve të ngordhura në një qendër përpunimi (*rendering plant*) të miratuar në territorin e vendit ku ndodhi shpërthimi.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare vendos kushte specifike për transportin e kafshëve dhe produkteve përmes zonës së kufizuar në mënyrë që të sigurohet se ato kryhen:

- a) pa ndalim ose shkarkim në zonën e kufizuar;
 - b) duke i dhënë përparësi rrugëve kryesore ose hekurudhave kryesore; dhe
 - c) duke shmangur afërsinë me stabilimente që mbajnë kafshë të specieve të listuara.
4. Nënproduktet e kafshëve nga kafshët e specieve të listuara, me origjinë nga dhe të lëvizura jashtë zonës së kufizuar, shoqërohen me një certifikatë shëndetësore të kafshëve të lëshuar nga

një veteriner zyrtar i kontrolleve zyrtare që vërteton që ato lejohen të lëvizin nga zona e kufizuar sipas kushteve të përcaktuara nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare në përputhje me këtë krye.

5. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare vendos që certifikata e përmendur në pikën 5 të këtij neni të mos lëshohet për lëvizjet e nënprodukteve shtazore jo për konsum njerëzor brenda vendit kur Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mendon se ekziston një mënyrë tjetër që siguron që ngarkesat e këtyre produkteve janë të gjurmueshme dhe që produktet plotësojnë kërkesat për shëndetin e kafshëve për lëvizje të tilla.

6. Të autorizohet nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare çdo grumbullim i mostrave në stabilimentet në zonën e kufizuar që mbajnë kafshë të specieve të listuara për qëllime të ndryshme nga ato për të konfirmuar ose të përjashtuar praninë e sëmundjeve përkatëse të kategorisë A.

Neni 23

Përjashtime nga masat që zbatohen në zonën e kufizuar

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare lejon përjashtime nga dispozitat e përcaktuara në këtë krye në lidhje me masat që zbatohen në zonat e kufizuara, në masën e nevojshme dhe pas kryerjes së një vlerësimi risku:

- a) në zonat e mëtejshme të kufizuara të përmendura në shkronjën c, të pikës 1, të nenit 21;
- b) në rastin kur autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare vendos të krijojë një zonë të kufizuar kur një shpërthim i një sëmundjeje të kategorisë A ndodh në stabilimentet dhe vendet e përmendura në pikën 3, të nenit 21;
- c) në rast se shpërthimi ndodh në një stabiliment që mban deri në 50 zogj të mbajtur; ose
- ç) në stabilimentet dhe vendet e përmendura në pikën 3, të nenit 21 të vendosura në një zonë të kufizuar.

Neni 24

Kërkesat për mjetet e transportit të kafshëve të mbajtura të specieve të listuara dhe produkteve të tyre

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare siguron që mjetet e transportit të përdorura për lëvizjen e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara dhe produkteve të tyre brenda, nga, në dhe përmes zonës së kufizuar kanë qenë:

- a) të ndërtuara dhe të mirëmbajtura në mënyrë të tillë që të shmangin çdo arratisje të kafshëve, rrjedhje të produkteve ose ndonjë artikulli që përfaqëson një rrezik për shëndetin e kafshëve;
- b) pastrohet dhe dezinfektohet menjëherë pas çdo transporti të kafshëve, produkteve ose çdo objekti që paraqet rrezik për shëndetin e kafshëve dhe nëse është e nevojshme, më pas dezinfektohet sërish, dhe në çdo rast thahet ose lihet të thahet, përpara çdo ngarkimi të ri të kafshëve ose produkteve; dhe
- c) sipas rastit, i nënshtrohen masave për kontrollin e insekteve dhe brejtësve përpara transportit.

2. Pastrimi dhe dezinfektimi i mjeteve të transportit të përmendura në pikën 1 kryhet:

- a) në përputhje me udhëzimet ose procedurat e parashikuara nga autoriteti kompetent duke përdorur produktet e duhura biocide për të siguruar shkatërrimin e agjentit përkatës të sëmundjes së kategorisë A; dhe
- b) i dokumentuar në mënyrën e duhur.

Seksioni 2

Masat e kontrollit të sëmundjeve në zonën e mbrojtjes

Neni 25

Masat që zbatohen në stabilimentet që mbajnë kafshë të specieve të listuara në zonën e mbrojtur

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron pa vonesë zbatimin e masave të mëposhtme në zonën e mbrojtur në stabilimentet që mbajnë kafshë të specieve të listuara, përveç stabilimentit në të cilin është konfirmuar sëmundja e kategorisë A:

a) mbajtjen e kafshëve të specieve të listuara të ndara nga kafshët e egra dhe kafshët e specieve të palistuara;

b) zbatimin e mbikëqyrjes shitesë për të identifikuar çdo përhapje të mëtejshme të sëmundjes së kategorisë A në stabiliment, duke përfshirë çdo rritje të sëmundshmërisë, mortalitetit ose rënie të konsiderueshme në të dhënat e prodhimit. Çdo rritje ose rënie e tillë i njoftohet menjëherë autoritetit kompetent;

c) kur është e përshtatshme, zbatimin e mënyrat e duhura për kontrollin e insekteve, brejtësve dhe vektorëve të tjerë të sëmundjeve brenda dhe përreth stabilimentit;

ç) përdorimin e mjeteve të përshtatshme të dezinfektimit në hyrjet dhe daljet e stabilimentit;

d) zbatimin e masave të duhura të biosigurisë për të gjithë personat në kontakt me kafshët e mbajtura të specieve të listuara ose që hyjnë ose dalin nga stabilimenti, si dhe mjetet e transportit, në mënyrë që të shmangët çdo rrezik i përhapjes së sëmundjes përkatëse të kategorisë A;

dh) mbajtjen e të dhënave e të gjithë personave që vizitojnë stabilimentin, duke i mbajtur ato të përditësuara në mënyrë që të lehtësojë mbikëqyrjen dhe kontrollin e sëmundjes dhe t'i vërë ato në dispozicion të autoritetit kompetent sipas kërkesës;

e) asgjësimin e kadavrave ose pjesëve të kafshëve të mbajtura të ngordhura ose të eliminuara të specieve të listuara sipas pikës 3, të nenit 22.

2. Me përjashtim të shkronjës dh, të pikës 1 të këtij neni, të dhënat për vizitorët nuk kërkohen në stabilimentet ku mbahen kafshët e përmendura në pikën 2, të nenit 13, nëse vizitorët nuk kanë akses në zonat ku mbahen kafshët.

Neni 26

Vizita nga veterinerët zyrtarë në stabilimentet në zonën e mbrojtur

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare siguron që veterinerët zyrtarë të kryejnë të paktën një vizitë në të gjitha stabilimentet e përmendura në nenin 25, sa më shpejt të jetë e mundur dhe pa vonesa të pajustificuara, pas konfirmimit zyrtar të një shpërthimi të një sëmundjeje të kategorisë A.

2. Gjatë kryerjes së vizitave të përmendura në pikën 1, veterinerët zyrtarë kryejnë së paku këto veprime:

a) kontrolle të dokumenteve, duke përfshirë analizën e të dhënave të shëndetit, prodhimit dhe gjurmueshmërisë;

b) verifikimin e zbatimit të masave të zbatuara për të parandaluar hyrjen ose përhapjen e sëmundjes përkatëse të kategorisë A në përputhje me nenin 25;

c) kontrollin klinik të kafshëve të mbajtura të specieve të listuara; dhe

ç) nëse është e nevojshme, mbledhja e mostrave të kafshëve për ekzaminim laboratorik me qëllim që të konfirmohet ose përjashtohet prania e sëmundjes përkatëse të kategorisë A.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare kërkon vizita të mëtejshme veterinarë në stabilimentet në zonën e mbrojtur për të ndjekur situatën.

4. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mban një regjistër të aktiviteteve dhe vizitave të përmendura në pikën 1, 2 dhe 3 të këtij neni dhe gjetjet e tyre.

5. Me përjashtim të pikës 1, kur rrezja e zonës së mbrojtjes të përcaktuar në shtojcën V është më e madhe se 3 km, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të vendosë të kërkojë të mos vizitohen të gjitha stabilimentet e përmendura në nenin 25, por të vizitohen një numër përfaqësues të atyre stabilimenteve në përputhje me pikën A.3 të shtojcës I.

Neni 27

Ndalimet në lidhje me veprimet, duke përfshirë lëvizjet në lidhje me kafshët, produktet dhe materialet e tjera brenda, nga ose në zonën e mbrojtjes

1. Autoritetet kompetente të kontrolleve zyrtare për veterinarinë dhe sigurinë ushqimore sipas fushës së veprimit ndalojnë veprimet, duke përfshirë lëvizjet në lidhje me kafshët e specieve të listuara, produktet e tyre dhe materialet e tjera brenda, nga dhe drejt zonës së mbrojtjes në përputhje me tabelën në shtojcën VI.

2. Autoritetet kompetente të kontrolleve zyrtare (sipas pikës 1) mund të zgjerojë ndalimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni në:

- a) kafshë të specieve të palistuar dhe produkte nga kafshë të tilla; dhe
- b) veprimtaritë, duke përfshirë lëvizjet, të ndryshme nga ato të përcaktuara në shtojcën VI.

3. Produktet e mëposhtme janë të përjashtuara nga ndalimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni:

a) produktet me origjinë shtazore të konsideruara si mallra të sigurta, në përputhje me shtojcën VII, në lidhje me sëmundjen përkatëse;

b) produktet me origjinë shtazore të cilat i janë nënshtruar trajtimit përkatës në përputhje me shtojcën VII;

c) produkte ose materialet e tjera që mund të përhapin sëmundjen, të marra ose të prodhuara përpara periudhës së monitorimit të përcaktuar në shtojcën II për sëmundjen përkatëse të llogaritur retrospektivisht nga data në të cilën dyshimi u njoftua;

ç) produktet e prodhuara në zonën e mbrojtur të cilat janë marrë nga kafshët e mbajtura të specieve të listuara:

- i. mbahen jashtë zonës së mbrojtjes;
 - ii. mbahen dhe theren jashtë zonës së mbrojtjes; ose
 - iii. mbahen jashtë zonës së mbrojtjes dhe theren në zonën e mbrojtur;
- d) produktet e derivuara.

4. Ndalimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen për produktet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni nëse:

a) produktet nuk janë të ndara qartë, gjatë procesit të prodhimit, ruajtjes dhe transportit, nga produktet që nuk kualifikohen për dërgim jashtë zonës së kufizuar në përputhje me këtë rregullore; ose

b) Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare ka prova epidemiologjike të përhapjes së sëmundjes në, nga ose nëpërmjet këtyre produkteve.

Neni 28

Kushtet e përgjithshme për të lejuar përjashtime nga ndalimet në zonën e mbrojtjes

1. Me përjashtim të ndalimeve të parashikuara në nenin 27, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të autorizojë lëvizjet e kafshëve dhe produkteve në rastet e përcaktuara nga nenet 29 deri në 38 dhe sipas kushteve specifike të parashikuara në ato nene dhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara në pikën 2 deri në 7 të këtij neni. Para dhënies së autorizimit, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare vlerëson rrisqet që rrjedhin nga ai autorizim dhe vlerësimi të tregojë se risku i përhapjes së sëmundjes së kategorisë A është i papërfillshëm.

2. Të gjitha lëvizjet e autorizuara kryhen:

- a) ekskluzivisht nëpërmjet rrugëve të caktuara;
- b) duke i dhënë përparësi rrugëve kryesore ose hekurudhave kryesore;
- c) shmangia e afërsisë me stabilimente që mbajnë kafshë të specieve të listuara; dhe
- ç) pa shkarkim ose ndalim, deri në shkarkimin në qendrën e destinacionit.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare i stabilimentit të origjinës cakton stabilimentin e destinacionit për lëvizjet nga ose në zonën e mbrojtur. Nëse autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare i stabilimentit të origjinës është i ndryshëm nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare të destinacionit, ai e bën përcaktimin në bashkëpunim me autoritetin kompetent i kontrolleve zyrtare të stabilimentit të destinacionit.

4. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare të stabilimentit të origjinës verifikon që stabilimenti i destinacionit pranon të caktohet dhe të marrë çdo ngarkesë të kafshëve ose produkteve.

5. Autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare kur autorizon lëvizjet e kafshëve nga zona e mbrojtur, siguron që këto lëvizje të mos paraqesin rrezik për përhapjen e sëmundjes së kategorisë A bazuar në:

a) një kontroll klinik, me rezultate të favorshme, të kafshëve të mbajtura në stabiliment, duke përfshirë ato kafshë që zhvendosen;

b) nëse është e nevojshme, një ekzaminim laboratorik, me rezultate të favorshme, të kafshëve që mbahen në stabiliment, duke përfshirë ato kafshë që zhvendosen; dhe

c) rezultatin e vizitave të përmendura në nenin 26.

6. Në rastin e autorizimit të transportit të produkteve nga zona e mbrojtur, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare për sigurinë ushqimore mbikëqyr dhe urdhëron që:

a) gjatë gjithë procesit të prodhimit dhe magazinimit të tyre, produktet të ndahen qartë nga produktet që nuk kualifikohen për dërgim jashtë zonës së kufizuar në përputhje me këtë rregullore; dhe

b) produktet nuk transportohen me produkte që nuk kualifikohen për dërgim jashtë zonës së kufizuar në përputhje me këtë rregullore.

7. Kur jep një autorizim sipas pikës 1, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare siguron që masat shpesh të biosigurisë të zbatohen që nga momenti i ngarkimit, gjatë të gjitha veprimtarive të transportit dhe deri në shkarkimin në stabilimentin e caktuar të destinacionit në përputhje me udhëzimet e tij.

Neni 29

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjeve për therjen e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara në zonën e mbrojtur

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara nga stabilimentet e vendosura në zonën e mbrojtur në një thertore që ndodhet:

a) sa më afër që të jetë e mundur me stabilimentin e origjinës, brenda zonës së mbrojtjes;

b) në zonën e mbikëqyrjes, kur nuk është e mundur të theren kafshët në zonën e mbrojtjes; ose

c) sa më afër zonës së mbikëqyrjes kur nuk është e mundur të theren kafshët në zonën e kufizuar.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare jep autorizimet e parashikuara në pikën 1 vetëm në kushtet e mëposhtme:

a) mjetet e transportit janë të plumbosur në momentin e ngarkimit nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare i dërgimit ose nën mbikëqyrjen e tij;

b) autoriteti kompetent i thertoresh:

i. informohet paraprakisht nga operatori i thertoresh për qëllimin për të marrë kafshë të mbajtura të specieve të listuara;

ii. konfirmon mungesën e ndonjë shenje treguese të sëmundjes së kategorisë A gjatë inspektimeve para dhe pas therjes;

iii. mbikëqyr operatorin e thertoresh që ka procedura efektive për të siguruar që kafshët e mbajtura të specieve të listuara me origjinë nga zona e mbrojtjes të mbahen veçmas dhe të theren

veçmas nga këto kafshë ose në kohë të ndryshme, mundësisht në fund të ditës së punës të mbërritjes së kafshëve;

iv. konfirmojë therjen e kafshëve tek autoriteti kompetent i stabilimentit të origjinës së kafshëve;

v. mbikëqyr operatorin e thertores për pastrimin dhe dezinfektimin e ambienteve ku janë mbajtur dhe therur kafshët dhe procesi i pastrimit dhe dezinfektimit ka përfunduar përpara se kafshët e tjera të mbajtura të specieve të listuara të mbahen ose theren në ato ambiente; dhe

vi. mbikëqyr marrjen (përfitimin) e mishit nga kafshë të tilla në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 33.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara nga stabilimentet që ndodhen jashtë zonës së mbrojtur në një thertore të vendosur në zonën e mbrojtur nëse:

a) kafshët mbahen veçmas nga kafshët e tjera me origjinë nga zona e mbrojtjes dhe theren veçmas nga ato kafshë ose në kohë të ndryshme;

b) mishi i freskët i përfutur pritët, transportohet dhe ruhet veçmas nga mishi i freskët i përfutur nga kafshët me origjinë nga zona e mbrojtur; dhe

c) pastrimi dhe dezinfektimi i mjeteve të transportit të përmendura në nenin 24 bëhet nën mbikëqyrjen zyrtare pas shkarkimit të kafshëve.

4. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon përpunimin dhe përdorimin e nënprodukteve shtazore, jo për konsum njerëzor, të marra nga kafshët e therrura në përputhje me pikat 1, 2 dhe 3 si materiale të kategorisë 3 në përputhje legjisllacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor në një qendër për përpunimin ose asgjësimin e nënprodukteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, të miratuara, të vendosura brenda territorit të vendit, ose në një shtet tjetër, ku nuk është e mundur të përpunohen ose asgjësohen në një qendër të miratuar në territorin e vendit ku ka ndodhur shpërthimi.

Në rast se nënproduktet shtazore jo për konsum njerëzor të përmendura në nënparagrafin e parë zhvendosen në një qendër përpunimi të vendosur në një shtet tjetër, shteti i destinacionit dhe shtetet tranzitore të kalimit autorizojnë një dërgim të tillë dhe autoritetet kompetente të destinacionit autorizojnë përpunimin dhe përdorimin e këtyre nënprodukteve shtazore jo për konsum njerëzor, si material i kategorisë 3, në përputhje me legjisllacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor.

Neni 30

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjeve të caktuara të shpendëve nga stabilimentet që ndodhen në zonën e mbrojtur

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e zogjve njëditor nga një stabiliment i vendosur në zonën e mbrojtur në një stabiliment të vendosur brenda vendit, por nëse është e mundur, jashtë zonës së kufizuar, me kusht që:

a) në rastin e zogjve njëditor të çelur nga vezët me origjinë nga zona e kufizuar:

i. mjeti i transportit është i plumbosur në momentin e ngarkimit nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare ose nën mbikëqyrjen e tij;

ii. vendosja e vendit të destinacionit vihet nën mbikëqyrje zyrtare nga veterinerët zyrtarë pas mbërritjes së kafshëve; dhe

iii. nëse zhvendoset jashtë zonës së kufizuar, shpendët qëndrojnë në stabilimentin e destinacionit të paktën për një periudhë prej 21 ditësh.

b) në rastin e zogjve njëditor të çelur nga vezët me origjinë jashtë zonës së kufizuar, vendi/rajoni i dërgimit mund të sigurojë që të mos ketë ndodhur asnjë kontakt midis këtyre vezëve dhe çdo vezë tjetër për çelje ose zogjve njëditor me origjinë nga zona e kufizuar.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e shpendëve për shtrim të vezëve nga stabilimentet e vendosura në zonën e mbrojtjes në stabilimentet e vendosura brenda vendit dhe nëse është e mundur, brenda zonës së kufizuar, me kusht që:

- a) nuk ka asnjë kafshë tjetër të mbajtur të specieve të listuara në stabilimentin ose njësinë epidemiologjike të destinacionit;
- b) mjeti i transportit është i plumbosur në momentin e ngarkimit nga autoriteti kompetent ose nën mbikëqyrjen e tij;
- c) vendi i destinacionit vihet nën mbikëqyrje zyrtare nga veterinerët zyrtarë pas mbërritjes së kafshëve; dhe
- ç) nëse zhvendosen jashtë zonës së kufizuar, kafshët qëndrojnë në vendin e destinacionit të paktën për një periudhë prej 21 ditësh.

Neni 31

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjeve të caktuara të vezëve të çeljes në zonën e mbrojtjes

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e vezëve për çelje:

- a) nga një stabiliment i vendosur në zonën e mbrojtjes në një vend për çelje të vezëve të vendosur brenda vendit; ose
- b) nga një stabiliment i vendosur brenda vendit në një inkubator për çelje të vezëve të vendosur në zonën e mbrojtjes.

2. Autorizimi i parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1 të këtij neni, i nënshtrohet kushteve të mëposhtme:

- a) tufat mëmë nga të cilat rrjedhin vezët e çeljes i janë nënshtruar një kontrolli klinik dhe janë marrë kampione për ekzaminim laboratorik me rezultate të favorshme;
- b) vezët e çeljes dhe paketimi i tyre dezinfektohen përpara dërgimit dhe sigurohet gjurmimi i vezëve të çeljes; dhe
- c) vezët e çeljes transportohen me mjete transporti të plumbosura nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e vezëve të çeljes nga një stabiliment i vendosur në zonën e mbrojtjes në një stabiliment për çelje brenda vendit, nëse:

- a) tufat mëmë nga të cilat rrjedhin vezët e çeljes i janë nënshtruar një kontrolli klinik dhe janë marrë kampione për ekzaminim laboratorik me rezultate të favorshme;
- b) vendosja e destinacionit vihet nën mbikëqyrje zyrtare deri në 21 ditë pas çeljes së vezëve;
- c) shpendët qëndrojnë në stabilimentin e destinacionit gjatë periudhës së përmendur në shkronjën “b”; dhe
- ç) janë përmbushur kërkesat e përmendura në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 2 të këtij neni.

Neni 32

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjeve të materialit biologjik nga stabilimentet e miratuara të produkteve germinale në zonën e mbrojtjes

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e materialit biologjik (spermë) të mbledhur nga kafshët e specieve të listuara të mbajtura në stabilimentet e miratuara të produkteve germinale, me përjashtim të inkubatorëve të çeljes, të vendosura në zonën e mbrojtjes pas datës së vlerësimit të shfaqjes së infeksionit në fazën më të hershme të stabilimentit të prekur, duke iu nënshtruar kushteve të mëposhtme:

- a) të gjitha masat e kontrollit të sëmundjes në lidhje me sëmundjen e kategorisë A janë hequr në zonën e mbrojtjes në përputhje me nenin 39;
- b) të gjitha kafshët e mbajtura të specieve të listuara në qendrën e grumbullimit të materialit biologjik (spermë) i janë nënshtruar një kontrolli klinik dhe janë marrë kampione për ekzaminim

laboratorik me qëllim që të përjashtohet prania e sëmundjes së kategorisë A në qendrën e grumbullimit të materialit biologjik (spermë) ; dhe

c) kafsha dhuruese i është nënshtruar një ekzaminimi laboratorik me një rezultat të favorshëm nga një kampion të marrë jo më herët se shtatë ditë pas periudhës së monitorimit të përcaktuar në shtojcën II për sëmundjen përkatëse, e llogaritur përpara nga data në të cilën është mbledhur materiali biologjik.

Neni 33

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjeve të mishit të freskët dhe qumështit të papërpunuar të marrë nga kafshët e mbajtura të specieve të listuara nga stabilimentet në zonën e mbrojtur

1. Autoritetet kompetente të kontrolleve zyrtare në fushën e veterinarisë dhe sigurisë ushqimore sipas fushës së veprimit mund të autorizojë lëvizjet e mishit të freskët dhe qumështit të papërpunuar të përftuar nga kafshët e specieve të listuara që mbahen në stabilimentet e vendosura në zonën e mbrojtur, nëse:

a) ato zhvendosen në një stabiliment përpunimi për t'iu nënshtruar një prej trajtimeve përkatëse për zbutjen e rrezikut të përcaktuara në shtojcën VII; ose

b) në rastin e mishit të freskët të shpendëve:

i. është shënjuar në përputhje me pikën 1, të shtojcës IX që nga momenti kur është marrë në thertore; dhe

ii. nuk është për qëllim dërgimi në një shtet tjetër.

2. Autoritetet kompetente të kontrolleve zyrtare në fushën e veterinarisë dhe sigurisë ushqimore sipas fushës së veprimit sigurojnë që lëvizjet në një stabiliment përpunimi të përmendur në shkronjën “a”, të pikës 1, të jenë në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) mishi i freskët shënjohe në thertore në përputhje me pikën 2, të shtojcës IX, pas inspektimit postmortem dhe të mbajë një shenjë të tillë derisa të trajtohet;

b) lëvizja e mishit të freskët dhe qumështit të papërpunuar nga vendi i origjinës në stabilimentin e përpunimit kryhet në kontejnerë të mbyllur; dhe

c) stabilimenti i përpunimit është i vendosur në të njëjtën zonë të kufizuar ose sa më afër zonës së kufizuar dhe funksionon nën mbikëqyrjen e veterinerëve zyrtarë.

Neni 34

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjeve të vezëve për konsum njerëzor nga stabilimentet që ndodhen në zonën e mbrojtur

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare në fushën e sigurisë ushqimore autorizon lëvizjen e vezëve për konsum njerëzor nga stabilimentet e vendosura në zonën e mbrojtur në destinacionet e mëposhtme brenda vendit:

a) në një qendër paketimi, me kusht që ato të jenë të paketuara me:

i. një paketim të disponueshëm; ose

ii. një ambalazh që mund të pastrohet dhe dezinfektohet në mënyrë të tillë që të shkatërrojë agjentin përkatës të sëmundjes së kategorisë A;

c) në një stabiliment për prodhimin e produkteve të vezëve siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për “Mbi kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore” dhe trajtohen në legjislacionin në fuqi për “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”.

Neni 35

Kushtet e veçanta të autorizimit të lëvizjes së plehut organik, duke përfshirë materialin e shtresës dhe shtrojën e përdorur nga stabilimentet që ndodhen në zonën e mbrojtjes të një landfilli

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjen e plehut organik, duke përfshirë shtresën dhe shtrojën e përdorur, nga stabilimentet që ndodhen në zonën e mbrojtur me qëllim që të asgjësohen në një landfill që ndodhet brenda vendit vetëm pas përpunimit sipas legjislacionit të nënprodukteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor.

Neni 36

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjes së lëndëve ushqimore me origjinë bimore dhe kashtës nga zona e mbrojtjes

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e lëndëve ushqimore me origjinë bimore dhe kashtës të prodhuar në zonën e mbrojtur me kusht që:

- a) të jenë prodhuar në vende ku nuk mbahen kafshë të specieve të listuara;
- b) ato janë prodhuar në stabilimentet e përpunimit të ushqimit të kafshëve që nuk mbajnë kafshë të specieve të listuara dhe lënda e parë bimore e ka origjinën:
 - i. nga vendndodhjet e përmendura në shkronjën “a” ; ose
 - ii. nga jashtë zonës së mbrojtjes;
- c) ato janë të destinuara për përdorim brenda zonës së mbrojtjes; ose
- ç) ato i janë nënshtruar të paktën njërit prej trajtimeve për zbutjen e riskut në përputhje me shtojcën VIII.

Neni 37

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjeve të kafshëve të mbajtura të specieve dhe produkteve të listuara në një qendër/fabrikë përpunimi të miratuar për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara nga stabilimentet e vendosura në zonën e mbrojtur në një qendër/fabrikë përpunimi të miratuar për përpunimin ose asgjësimin e nënprodukteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor në të cilat:

- a) kafshët e mbajtura eliminohen menjëherë; dhe
- b) nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor që përftohen asgjësohen në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e produkteve nga stabilimentet dhe vendndodhjet në zonën e mbrojtur në një qendër/fabrikë përpunimi të miratuar për përpunimin ose asgjësimin e nënprodukteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, në të cilën produktet asgjësohen ose përpunohen në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor.

Neni 38

Masat që zbatohen në bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, pikat e kontrollit kufitar, stabilimentet e nënprodukteve jo për konsum njerëzor ose çdo vendndodhje tjetër të rëndësishme në zonën e mbrojtjes, duke përfshirë mjetet e transportit

1. Autoritetet kompetente për kryerjen e kontrolleve zyrtare në fushën e veterinarisë dhe të sigurisë ushqimore sipas fushës së veprimit zbatojnë masat përkatëse të përcaktuara në nenin 25 dhe nenet 27, deri në 38, në bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, pikat e kontrollit

kufitar, stabilimentet e nënprodukteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor ose çdo vendndodhje tjetër të rëndësishme në zonën e mbrojtjes, duke përfshirë mjetet e transportit.

2. Në stabilimentet dhe vendndodhjet e përmendura në pikën 1, autoritetet kompetente për kryerjen e kontrolleve zyrtare mund të zbatojnë masa shtesë të përshtatura për situatën specifike për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A, brenda dhe nga zona e mbrojtur.

Neni 39

Kohëzgjatja e masave të kontrollit të sëmundjes në zonën e mbrojtjes

1. Autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare heq masat e parashikuara në seksionet 1 dhe 2 të këtij kreu vetëm, nëse:

a) periudha minimale e përcaktuar në shtojcën X ka kaluar pas datës së përfundimit të pastrimit dhe dezinfektimit paraprak dhe sipas rastit, kontrollit të insekteve dhe brejtësve, të kryera në përputhje me nenin 15 në stabilimentin e prekur; dhe

b) në të gjitha stabilimentet që mbajnë kafshë të specieve të listuara në zonën e mbrojtur, kafshët e specieve të listuara i janë nënshtruar, me rezultate të favorshme, kontrolleve klinike dhe kur është e nevojshme, laboratorike në përputhje me nenin 26.

2. Kur sëmundja përkatëse e kategorisë A transmetohet nga një vektor i listuar, siç përmendet në urdhrin nr. 277, date 15.6.2022, “Për zbatimin e disa rregullave për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të kategorive të listuara dhe krijimin e një liste të specieve dhe grupeve të specieve që paraqesin rrezik të konsiderueshëm për përhapjen e këtyre sëmundjeve”, autoriteti kompetent:

a) përcakton kohëzgjatjen e masave në zonën e mbrojtjes rast pas rasti, duke marrë parasysh çdo faktor që ndikon në rrezikun e përhapjes së sëmundjes; dhe

b) siguron hyrjen e kafshëve sentinele.

3. Pas heqjes së masave të përmendura në pikën 1, masat e parashikuara në seksionin 3 të këtij kreu zbatohen në zonën e mbrojtjes për të paktën për periudhën shtesë të përcaktuar në shtojcën X.

Seksioni 3

Masat e kontrollit të sëmundjeve në zonën e mbikëqyrjes

Neni 40

Masat që zbatohen në stabilimentet në zonën e mbikëqyrjes

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron zbatimin, pa vonesë, të masave të parashikuara në nenin 25 në të gjitha stabilimentet në zonën e mbikëqyrjes që mbajnë kafshë të specieve të listuara.

Neni 41

Vizitat nga veterinerët zyrtarë në stabilimentet në zonën e mbikëqyrjes

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare siguron që veterinerët zyrtarë kryejnë vizita në stabilimente përfaqësuese që mbajnë kafshë të specieve të listuara në zonën e mbikëqyrjes në përputhje me nenin 26 dhe pikën A.3, të shtojcës I.

Neni 42

Ndalimet në lidhje me veprimet, duke përfshirë lëvizjet, në lidhje me kafshët, produktet dhe materialet e tjera brenda, nga ose në zonën e mbikëqyrjes

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare në fushën e veterinarisë dhe të sigurisë ushqimore sipas fushës së veprimit zbaton ndalimet, përjashtimet, kufizimet për aktivitetet, duke përfshirë

lëvizjet në lidhje me kafshët e specieve të listuara, produktet e tyre dhe materiale të tjera, nga dhe në zonën e mbikëqyrjes në përputhje me nenin 27.

Neni 43

Kushtet e përgjithshme për dhënien e përjashtimeve nga ndalimet e parashikuara në nenin 42

1. Me përjashtim të nenit 42, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare në fushën e veterinarisë dhe të sigurisë ushqimore sipas fushës së veprimit autorizon lëvizjet e kafshëve dhe produkteve vetëm në rastet e mbuluara nga nenet 44 deri në 52, sipas kushteve specifike të parashikuara në ato nene dhe kushteve të përgjithshme të përcaktuara në pikën 2 deri në pikën 7 të këtij neni.

Para dhënies së autorizimit, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare vlerëson rrisqet që rrjedhin nga ai autorizim. Vlerësimi tregon se rreziku i përhapjes së sëmundjes së kategorisë A është i papërfillshëm.

2. Të gjitha lëvizjet e autorizuar kryhen, duke:

- a) i dhënë përparësi rrugëve kryesore ose hekurudhave kryesore;
- b) shmangur afërsinë me stabilimente që mbajnë kafshë të specieve të listuara; dhe
- c) moslejuar shkarkimin apo ndalimin gjatë transportit, deri në shkarkimin e kafshëve në vendin e destinacionit.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare i vendit/rajonit të origjinës cakton vendin e destinacionit për lëvizjet nga ose në zonën e mbikëqyrjes. Nëse autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare i stabilimentit të origjinës është i ndryshëm nga autoriteti kompetent i i kontrolleve zyrtare i vendit/rajonit të destinacionit, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare i vendi të origjinës përcakton vendin e destinacionit në bashkëpunim me autoritetin kompetent të vendit të destinacionit.

4. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare i stabilimentit të origjinës verifikon që vendi/rajoni i destinacionit pranon të caktohet si vend destinacioni dhe të marrë çdo ngarkesë të kafshëve ose produkteve.

5. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, kur autorizon lëvizjet e kafshëve nga zona e mbikëqyrjes, siguron që këto lëvizje të mos paraqesin rrezik për përhapjen e sëmundjes së kategorisë A, bazuar në:

- a) një kontroll klinik me rezultate të favorshme të kafshëve të mbajtura në stabiliment, duke përfshirë edhe ato kafshë që zhvendosen;
- b) nëse është e nevojshme, një ekzaminim laboratorik me rezultate të favorshme të kafshëve të mbajtura në stabiliment, duke përfshirë edhe ato kafshë që zhvendosen; dhe
- c) rezultatin e vizitave të përmendura në nenin 41, nëse ka.

6. Gjatë autorizimit të transportit të produkteve nga zona e mbikëqyrjes, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare siguron që:

- a) gjatë gjithë procesit të prodhimit dhe magazinimit, produktet janë ndarë qartë nga produktet që nuk klasifikohen për dërgim jashtë zonës së kufizuar në përputhje me këtë rregullore;
- b) produktet nuk transportohen me produkte që nuk klasifikohen për dërgim jashtë zonës së kufizuar në përputhje me këtë rregullore.

7. Kur bëhen përjashtime të parashikuara sipas pikës 1, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare siguron që masat shtesë të biosigurisë të zbatohen që nga momenti i ngarkimit, gjatë të gjitha veprimtarive të transportit dhe deri në shkarkimin e kafshëve në stabilimentin e caktuar të destinacionit në përputhje me udhëzimet e tij.

Neni 44

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjeve për therjen e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara brenda, nga dhe në zonën e mbikëqyrjes

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara me origjinë nga zona e mbikëqyrjes në një thertore që ndodhet:

- a) sa më afër që të jetë e mundur me vendndodhjen e origjinës, brenda zonës së kufizuar; ose
- b) jashtë zonës së kufizuar, sa më afër zonës së mbikëqyrjes, kur nuk është e mundur të theren kafshët në zonën e kufizuar dhe pas kryerjes së një vlerësimi të riskut.

2. Mishi i përftuar nga kafshët e përmendura në pikën 1, i nënshtrohet masave të parashikuara në nenin 49.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara me origjinë jashtë zonës së mbikëqyrjes në një thertore të vendosur në zonën e mbikëqyrjes.

4. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon përpunimin dhe përdorimin e nënprodukteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, të marra nga kafshët e therura në përputhje me pikat 1, 2 dhe 3, si materiale të kategorisë 3 në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor në një qendër/fabrikë të miratuar për përpunim ose asgjësim të nënprodukteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor të vendosura në territorin e tyre, ose në një shtet tjetër, ku nuk është i mundur përpunimi ose asgjësimi i tyre në një qendër të miratuar në territorin e shtetit/vendit ku ka ndodhur shpërthimi.

Në rast se nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor të përmendura në nënparagrafin e parë zhvendosen në një fabrikë të vendosur në një shtet tjetër, shteti i destinacionit dhe shtetet tranzitore të kalimit, autorizojnë një dërgim të tillë dhe autoriteti kompetent i destinacionit autorizon përpunimin dhe përdorimin e këtyre nënprodukteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor si material i kategorisë 3 në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor.

Neni 45

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjeve të caktuara të thundrakëve të mbajtur të specieve të listuara nga stabilimentet në zonën e mbikëqyrjes

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjen e thundrakëve të mbajtur të specieve të listuara në kullotat që ndodhen brenda zonës së mbikëqyrjes, me kusht që:

- a) ka kaluar një periudhë prej 15 ditësh pasi është përfunduar dhe miratuar pastrimi dhe dezinfektimi paraprak i përmendur në nenin 15; dhe

- b) kafshët nuk bien në kontakt me kafshë të specieve të listuara nga stabilimente të tjera.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare pas kryerjes së një vlerësimi të riskut, autorizon lëvizjen e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara të thundrakëve në një stabiliment që i përket të njëjtit zinxhir furnizimi, që ndodhet brenda ose jashtë zonës së mbikëqyrjes, për të përfunduar ciklin e prodhimit përpara therjes. Nëse stabilimenti i destinacionit ndodhet jashtë zonës së mbikëqyrjes, autoriteti kompetent zbaton në atë stabiliment masat e parashikuara në nenin 40, 41 dhe 42 për sa kohë që masat e kontrollit të sëmundjes në zonën e origjinës së mbikëqyrjes mbahen siç parashikohet në nenin 55.

Neni 46

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjeve të caktuara të shpendëve nga stabilimentet e vendosura në zonën e mbikëqyrjes

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e zogjve njëditore me origjinë nga zona e mbikëqyrjes:

- a) të stabilimenteve brenda vendit ku ato janë nxjerrë nga vezët me origjinë nga stabilimentet brenda zonës së kufizuar, nëse:

- i. stabilimenti i destinacionit vihet nën mbikëqyrje zyrtare pas mbërritjes së shpendëve;

ii. nëse zhvendosen jashtë zonës së kufizuar, shpendët qëndrojnë në stabilimentet e destinacionit për të paktën 21 ditë; dhe

iii. mjeti i transportit është i plumbosur në momentin e ngarkimit nga autoriteti kompetent ose nën mbikëqyrjen e tij;

b) të stabilimenteve brenda vendit ku janë çelur vezët të cilat janë me origjinë jashtë zonës së kufizuar, nëse vendi i çeljes së vezëve të dërgimit mund të sigurojë që nuk ka ndodhur asnjë kontakt midis këtyre vezëve dhe çdo vezë tjetër për çelje ose zogj njëditor të përfutur nga shpendë të cilat mbahen brenda zonës së kufizuar.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e shpendëve gati për shtrim nga stabilimentet në zonën e mbikëqyrjes në stabilimentet brenda vendit, nëse:

a) nuk ka kafshë tjetër të mbajtur të specieve të listuara në stabilimentin ose njësinë epidemiologjike të destinacionit;

b) stabilimenti i destinacionit vihet nën mbikëqyrje zyrtare pas mbërritjes së shpendëve gati për shtrim; dhe

c) shpendët qëndrojnë në stabilimentin e destinacionit për të paktën 21 ditë.

Neni 47

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjeve të caktuara të vezëve të çeljes drejt dhe nga stabilimentet në zonën e mbikëqyrjes

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e vezëve të çeljes nga një stabiliment i vendosur brenda vendit, për:

a) një vend për çelje të vendosur në zonën e mbikëqyrjes; ose

b) një stabiliment për çelje brenda shtëpisë, e vendosur në zonën e mbikëqyrjes.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e vezëve të çeljes nga një stabiliment i vendosur në zonën e mbikëqyrjes në një vend për çelje brenda vendit ose në një stabiliment për çelje brenda vendit, vetëm nëse vezët e çeljes dhe paketimi i tyre dezinfektohet përpara dërgimit dhe mund të sigurohet gjurmimi i këtyre vezëve.

Neni 48

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjeve të materialit biologjik nga qendrat e miratuara të produkteve germinale në zonën e mbikëqyrjes

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të autorizojë lëvizjet e spermës së mbledhur nga kafshët e specieve të listuara të mbajtura në stabilimentet e miratuara të produkteve germinale, me përjashtim të vendeve për çelje, të vendosura në zonën e mbikëqyrjes pas datës së parashikuar të infektimit më të hershëm të stabilimentit së prekur, me kusht që:

a) të gjitha masat e kontrollit të sëmundjes në lidhje me sëmundjen përkatëse të kategorisë A janë hequr në zonën e mbikëqyrjes në përputhje me nenin 55;

b) të gjitha kafshët e mbajtura të specieve të listuara në qendrën e grumbullimit të spermës i janë nënshtruar një ekzaminimi klinik dhe janë marrë kampione për ekzaminime laboratorike në mënyrë që të përjashtohet prania e sëmundjes së kategorisë A në qendrën e grumbullimit të materialit biologjik;

c) kafsha dhuruese i është nënshtruar me rezultate të favorshme një ekzaminimi laboratorik në një kampion të marrë jo më herët se shtatë ditë pas periudhës së monitorimit të përcaktuar në shtojcën II për sëmundjen përkatëse, e llogaritur përpara nga data në të cilën është mbledhur sperma.

Neni 49

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjeve të mishit të freskët dhe qumështit të papërpunuar të marrë nga kafshët e mbajtura të specieve të listuara nga stabilimentet që ndodhen në zonën e mbikëqyrjes

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare në bashkëpunim me autoritetin kompetent për kontrollin zyrtar në fushën e sigurisë ushqimore autorizon lëvizjet e mishit të freskët dhe qumështit të papërpunuar të përftuar nga kafshët e specieve të listuara që mbahen në stabilimentet e vendosura në zonën e mbikëqyrjes nëse, ose:

a) mishi i freskët ose qumështi i papërpunuar zhvendoset në një stabiliment përpunimi për t'iu nënshtruar një prej trajtimeve për të shmangur rreziqet e përcaktuara në shtojcën VII; ose

b) mishi i freskët është marrë nga shpendët.

2. Autoriteti kompetent përgjegjës për kontrollin e produkteve me origjinë shtazore siguron që mishi i freskët dhe qumështi i papërpunuar i lëvizur sipas paragrafit 1 (a), të jenë në përputhje me sa vijon:

a) mishi i freskët shënjohehet në përputhje me shtojcën IX kur merret në thertore dhe e mban këtë shenjë derisa të trajtohet; dhe

b) trajtimi zbatohet në një stabiliment të vendosur në të njëjtën zonë të kufizuar ose sa më afër zonës së kufizuar, e cila funksionon nën mbikëqyrjen e veterinerëve zyrtarë.

Neni 50

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjeve të vezëve për konsum njerëzor nga stabilimentet në zonën e mbikëqyrjes

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare në fushën e sigurisë ushqimore mund të autorizojë lëvizjet e vezëve për konsum njerëzor nga stabilimentet në zonën e mbikëqyrjes në një qendër paketimi të vendosur brenda vendit me kusht që ato të jenë të paketuara me:

a) një paketim të disponueshëm; ose

b) një ambalazh që mund të pastrohet dhe dezinfektohet në mënyrë të tillë që të shkatërrojë agjentin e sëmundjes së kategorisë A.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare në fushën e sigurisë ushqimore mund të autorizojë lëvizjet e vezëve për konsum njerëzor nga stabilimentet e vendosura në zonën e mbikëqyrjes në një stabiliment për prodhimin e produkteve të vezëve të vendosura brenda vendit ku:

a) stabilimenti për prodhimin e produkteve të vezëve është në përputhje me kreun II, të udhëzimit nr. 22, datë 25.11.2010, “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor” dhe vezët zhvendosen në stabilimentin për prodhimin e produkteve të vezëve në mënyrë që të trajtohen në përputhje me kreun II, të udhëzimit nr. 22, datë 25.11.2010, “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”.

Neni 51

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjeve të plehut organik, duke përfshirë shtresën dhe shtrojen e përdorur nga stabilimentet në zonën e mbikëqyrjes

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjen e plehut organik, duke përfshirë shtresën dhe shtrojen e përdorur, nga stabilimentet e vendosura në zonën e mbikëqyrjes:

a) pa përpunim, në një landfill, të autorizuar më parë për këtë qëllim nga autoriteti kompetent, i vendosur në të njëjtën zonë mbikëqyrjeje; ose

b) pas përpunimit, në një landfill, të autorizuar më parë për këtë qëllim nga autoriteti kompetent, i vendosur brenda vendit.

Neni 52

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjes së lëndëve ushqimore me origjinë bimore dhe kashtë nga zona e mbikëqyrjes

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare në bashkëpunim me autoritetin kompetent për kontrollin zyrtar për shëndetin e bimëve, sipas fushës së veprimit autorizon lëvizjet e materialeve ushqimore me origjinë bimore ose kashtë së prodhuar në zonën e mbikëqyrjes, me kusht që materialet për ushqim ose kashta:

- a) janë prodhuar në vende ku nuk mbahen kafshë të specieve të listuara, përveç stabilimenteve të përpunimit të ushqimit të kafshëve;
- b) janë prodhuar në stabilimentet e përpunimit të ushqimit të kafshëve që nuk mbajnë kafshë të specieve të listuara dhe lënda e parë bimore ka origjinën:
 - i. nga vendndodhjet e përmendura në shkronjën “a”; ose
 - ii. nga jashtë zonës së mbikëqyrjes;
- c) janë të destinuara për përdorim brenda zonës së mbikëqyrjes; ose
- ç) i janë nënshtruar të paktën njërit prej trajtimeve të zbutjes së riskut të përcaktuara në shtojcën VIII.

Neni 53

Kushtet specifike për autorizimin e lëvizjeve të kafshëve të mbajtura të specieve dhe produkteve të listuara në një stabiliment të miratuar

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara nga stabilimentet e vendosura në zonën e mbikëqyrjes në një qendër të miratuar për përpunimin ose asgjësimin e nënprodukteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, kur:

- a) kafshët e mbajtura eliminohen menjëherë; dhe
- b) nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor që përftohen, asgjësohen në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e produkteve nga stabilimentet dhe vendndodhjet e tjera në zonën e mbikëqyrjes në një stabiliment të miratuar për përpunimin ose asgjësimin e nënprodukteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, ku ato asgjësohen ose përpunohen në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor.

Neni 54

Masat që zbatohen në bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, pikat e kontrollit kufitar, stabilimentet e nënprodukteve të kafshëve ose çdo vendndodhje tjetër të rëndësishme në zonën e mbikëqyrjes, duke përfshirë mjetet e transportit

1. Autoritetet kompetente të kontrolleve zyrtare në fushën e veterinarisë dhe të sigurisë ushqimore sipas fushës së veprimit zbatojnë masat përkatëse të përcaktuara në nenin 40 dhe nenin 42 deri në nenin 53, në bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, pikat e kontrollit kufitar, stabilimentet e nënprodukteve të kafshëve jo për konsum njerëzor ose çdo vendndodhje tjetër të rëndësishme në zonën e mbikëqyrjes, duke përfshirë mjetet e transportit.

2. Në stabilimentet dhe vendndodhjet e përmendura në pikën 1, autoritetet kompetente të kontrolleve zyrtare zbatojnë masa shtesë të përshtatura për situatën specifike për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A brenda dhe nga zona e mbikëqyrjes.

Neni 55

Kohëzgjatja e masave të kontrollit të sëmundjes në zonën e mbikëqyrjes

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare heq masat e kontrollit të sëmundjes të zbatuara në zonën e mbikëqyrjes në përputhje me seksionet 1 dhe 3 vetëm, nëse:

a) periodha minimale e përcaktuar në shtojcën XI ka kaluar pas datës së përfundimit të pastrimit dhe dezinfektimit paraprak dhe sipas rastit, kontrollit të insekteve dhe brejtësve, të kryera në përputhje me nenin 15 në stabilimentin e prekur;

b) kërkesat e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 39, janë përmbushur në zonën e mbrojtur; dhe

c) një numër përfaqësues stabilimentesh që mbajnë kafshë të specieve të listuara i janë nënshtruar, me rezultate të favorshme, vizitave të kryera nga veterinerët zyrtarë, në përputhje me nenin 41.

2. Kur sëmundja përkatëse e kategorisë A transmetohet nga një vektor i listuar, në përputhje me urdhrin nr. 277, datë 15.6.2022, “Për zbatimin e disa rregullave për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të kategorive të listuara dhe krijimin e një liste të specieve dhe grupeve të specieve që paraqesin rrezik të konsiderueshëm për përhapjen e këtyre sëmundjeve”, autoriteti kompetent:

a) cakton kohëzgjatjen e masave në zonën e mbikëqyrjes rast pas rasti duke marrë parasysh faktorët që ndikojnë në rrezikun e përhapjes së sëmundjes; dhe

b) parashikon hyrjen e kafshëve sentinel.

Seksioni 4

Përrjashtimet e zbatueshme në zonën e kufizuar në rast të shpërthimeve të mëtejshme të sëmundjes

Neni 56

Përrjashtimet nga ndalimet e lëvizjes së kafshëve brenda zonave të kufizuara kur mbahen masat kufizuese

1. Kur ndalimet e lëvizjes së kafshëve të parashikuara në nenet 27 dhe nenin 42 mbahen përtej periudhës së përcaktuar në shtojcën XI për shkak të konfirmimit zyrtar të shpërthimeve të mëtejshme të sëmundjes së kategorisë A, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, në rrethana të jashtëzakonshme, mund të autorizojë lëvizjen e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara nga një stabiliment brenda zonës së kufizuar në rastet që nuk mbulohen nga përrjashtimet e parashikuara në nenet 27 dhe nenin 42, nëse:

a) operatori ka paraqitur një kërkesë të arsyetuar për atë autorizim;

b) rreziqet që rrjedhin nga autorizimi i lëvizjeve të tilla janë vlerësuar përpara autorizimit dhe vlerësimi tregon se rreziku i përhapjes së sëmundjes së kategorisë A është i papërfillshëm;

c) veterinerët zyrtarë kanë kryer ekzaminime klinike dhe kanë mbledhur mostra për ekzaminime laboratorike nga kafshët e specieve të listuara, përfshirë ato që zhvendosen, kanë dhënë rezultate të favorshme.

2. Kur lëvizjet e kafshëve autorizohen në përputhje me pikën 1, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare siguron që transporti të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 24.

KREU III

RIPOPULLIMI I STABILIMENTEVE NË ZONA TË KUFIZUARA ME KAFSHË TOKËSORE

Neni 57

Kushtet për të autorizuar ripopullimin e stabilimentit së prekur

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon ripopullimin e stabilimentit të prekur vetëm nëse plotësohen kërkesat e mëposhtme:

a) një pastrim dhe dezinfektim përfundimtar dhe kur është e nevojshme, kontrolli i insekteve dhe brejtësve është:

i. kryer në përputhje me procedurat e përcaktuara në shkronjat A dhe C, të shtojcës IV, duke përdorur produktet e duhura biocide për të siguruar shkatërrimin e agjentit përkatës të sëmundjes së kategorisë A; dhe

ii. dokumentuar në mënyrë adekuate;

b) periudha e monitorimit e përcaktuar në shtojcën II për sëmundjen përkatëse, e llogaritur nga data në të cilën është kryer pastrimi dhe dezinfektimi përfundimtar i parashikuar në shkronjën “a”, ka kaluar.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mbikëqyr që pastrimi dhe dezinfektimi përfundimtar dhe kur është i nevojshëm kontrolli i insekteve dhe brejtësve në stabilimentin e prekur të kryhet në përputhje me kërkesat në shkronjën “a”, të pikës 1.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare nuk lejon hyrjen në një kullotë të kafshëve të mbajtura të specieve të listuara gjatë periudhës kohore gjatë së cilës kullota konsiderohet e kontaminuar. Kjo periudhë kohore përcaktohet pas kryerjes së një vlerësimi risku.

4. Kur për arsye të justifikuara siç duhet pastrimi dhe dezinfektimi përfundimtar dhe sipas rastit, kontrolli i insekteve dhe brejtësve të përmendur në pikën 1, nuk janë kryer plotësisht në stabilimentin e prekur, autoriteti kompetent autorizon ripopullimin me anë të përjashtimit nga pika 1, me kusht që:

a) një periudhë prej të paktën 3 muajsh ka kaluar që kur është kryer pastrimi dhe dezinfektimi paraprak, siç përcaktohet në nenin 15; dhe

b) para dhënies së autorizimit, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare ka vlerësuar rreziqet që rrjedhin nga ai autorizim dhe vlerësimi tregon se rreziku i përhapjes së sëmundjes së kategorisë A është i papërfillshëm.

Neni 58

Përjashtimet nga kërkesa e parashikuar në shkronjën “b”, pika 1, e nenit 55

Në rast të konfirmimit zyrtar të një shpërthimi të një sëmundjeje të kategorisë A në bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, qendrat e grumbullimit, pikat e kontrollit kufitar, stabilimentet e nënprodukteve me origjinë ose çdo vendndodhje tjetër e rëndësishme, përfshirë mjetet e transportit, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon rihyrjen e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara për therje, veprimtaritë e mbledhjes së kafshëve, inspektimi ose transporti, 24 orë pas përfundimit të:

a) masave të përmendura në nenet 12, 14, 15, 17, 18 dhe shkronjën “a”, pika 1, në nenin 57; dhe

b) çdo masë shtesë e zbatuar nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare përshtatur me situatën specifike.

Neni 59

Kërkesat për ripopullimin e stabilimentit të prekur me kafshë të mbajtura të specieve të listuara

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mbikëqyr ripopullimin me kafshë të mbajtura të specieve të listuara në stabilimentin e prekur në përputhje me dispozitat e këtij neni.

2. Kafshët e mbajtura të specieve të listuara të destinuara për ripopullim:

a) të mos kenë origjinën nga një stabiliment që i nënshtrohet kufizimeve të parashikuara në kreun II; dhe

b) të merret kampion për ekzaminim laboratorik për të përjashtuar praninë e sëmundjes me rezultate të favorshme përpara hyrjes së kafshëve në stabiliment.

3. Për qëllimet e shkronjës b, të pikës 2, mostrat mbledhen nga:

a) një numër, përfaqësues i të gjitha kafshëve që futen në stabiliment, nëse ato futen të gjitha në të njëjtën kohë dhe nga i njëjti stabiliment origjine; ose

b) një numër, përfaqësues të kafshëve të secilës ngarkesë, nëse kafshët futen të gjitha në kohë të ndryshme ose nga stabilimente të ndryshme të origjinës.

Në rastin e zogjve njëditor, autoriteti kompetent mund të vendosë të mos kryejë kampionimin për ekzaminim laboratorik të përmendur në shkronjën “b”, të pikës 2.

4. Kafshët e mbajtura të specieve të listuara të destinuara për ripopullim hyjnë në stabilimentet si më poshtë:

a) në të gjitha njësitë epidemiologjike dhe ndërtesat e stabilimentit të prekur;

b) mundësisht në të njëjtën kohë ose brenda periudhës së monitorimit të përcaktuar në shtojcën II për sëmundjen përkatëse, e llogaritur përpara nga data në të cilën kafsha e parë është futur; ose

c) në rastin e stabilimenteve bujqësore të hapura ose kur kërkesa e përcaktuar në shkronjën “a” është jopraktike, përpara se kafshët të futen në stabiliment, përdoren kafshë sentinele të cilat janë kampionuar për ekzaminime laboratorike me rezultate të favorshme për sëmundjen përkatëse të kategorisë A.

5. Veterinerët zyrtarë të kryejnë të paktën një vizitë në stabilimentin e prekur në ditën e fundit të periudhës së monitorimit të përcaktuar në shtojcën II për sëmundjen përkatëse, e llogaritur në mënyrë retrospektive nga data në të cilën kafshët janë vendosur në stabiliment dhe në çdo rast para se të kenë kaluar 30 ditë nga ajo ditë, duke kryer të paktën:

a) kontrole dokumentare, duke përfshirë analizën e të dhënave të prodhimit, shëndetit dhe gjurmueshmërisë;

b) ekzaminimin klinik të kafshëve të mbajtura të specieve të listuara; dhe

c) mbledhjen e mostrave të kafshëve për ekzaminim laboratorik me qëllim që të konfirmohet ose përjashtohet prania e sëmundjes përkatëse të kategorisë A.

6. Çdo person që hyn ose del nga stabilimenti respekton masat e duhura të biosigurisë që synojnë parandalimin e përhapjes së sëmundjes përkatëse të kategorisë A.

7. Kafshët e mbajtura të specieve të listuara largohen nga stabilimenti vetëm me autorizimin e autoritetit kompetent të kontrolleve zyrtare dhe vetëm pasi të kenë marrë rezultate të favorshme nga ekzaminimi laboratorik i përmendur në shkronjën c, të pikës 5.

8. Në përputhje me nenin 61, duke filluar nga data që kafshët janë vendosur në stabiliment deri në fund të ripopullimit, operatori:

a) përditëson të dhënat e shëndetit të kafshëve dhe të dhënave të prodhimit për kafshët e mbajtura të specieve të listuara; dhe

b) njofton menjëherë autoritetin kompetent për çdo ndryshim të rëndësishëm në të dhënat e prodhimit dhe çdo anomali tjetër.

9. Nëse autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare i njoftohet për mortalitete të pazakonta ose shenja klinike të sëmundjes përkatëse të kategorisë A gjatë periudhës së përmendur në pikën 8, veterinerët zyrtarë mbledhin pa vonesë mostrat për ekzaminim laboratorik për të përjashtuar praninë e sëmundjes përkatëse të kategorisë A.

10. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të përjashtojë stabilimentet e mbyllura nga një ose më shumë dispozita të përcaktuara në pikat 1 deri në 9 pas vlerësimit të rrisqeve që rrjedhin nga ky përjashtim dhe ky vlerësim tregon se rreziku i përhapjes së sëmundjes së kategorisë A është i papërfillshëm.

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon ripopullimin e stabilimentit të prekur me kafshë të ndryshme nga speciet e listuara të mbajtura duke marrë parasysh rrezikun e përhapjes së sëmundjes përkatëse të kategorisë A dhe rrezikun e persistencës së vektorit.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare zgjeron disa ose të gjitha dispozitat e parashikuara në nenet 57 dhe 59 nëse zbatohet eliminimi parandalues siç parashikohet në pikën 4, të neneve 7 dhe 9.

Neni 61

Përfundimi i ripopullimit të stabilimentit të prekur dhe heqja e masave të kontrollit të sëmundjeve në stabilimentin e prekur

1. Ripopullimi i stabilimentit të prekur konsiderohet i përfunduar kur masat e parashikuara në nenet 57 dhe 59, dhe kur është e nevojshme në nenin 60, kanë përfunduar me sukses.

2. Autoriteti kompetent i kontrollit zyrtar heq të gjitha masat e kontrollit të sëmundjes të zbatuara në stabilimentin e prekur në përputhje me këtë rregullore kur ripopullimi konsiderohet i përfunduar, siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni.

KREU IV

MASAT E KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE NË KAFSHËT E EGRA TË SPECIEVE TË LISTUARA

Neni 62

Masat në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në kafshë të egra të specieve të listuara

1. Në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në kafshët e egra të specieve të listuara, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare kryen menjëherë një hetim për të konfirmuar ose përjashtuar praninë e sëmundjes së dyshuar të listuar.

2. Gjatë hetimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare organizon të paktën ekzaminimet *postmortem* dhe mbledhjen e mostrave për ekzaminim laboratorik të kafshëve të egra të specieve të listuara të qëlluara ose të gjetura të ngordhura për të konfirmuar ose përjashtuar praninë e sëmundjes së kategorisë A.

3. Për sa u përket trupave të kafshëve të egra të ngordhura në të cilat dyshohet sëmundja përkatëse e kategorisë A, pavarësisht nëse kafshët e egra janë eliminuar apo janë gjetur të ngordhura, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare siguron që:

a) të gjithë kadavrat e kafshëve të egra të ngordhura ose pjesët e tyre asgjësohen ose përpunohen në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor; dhe

b) kur është e mundur, çdo material ose substancë që mund të kontaminohet nga kontakti me kadavrat e kafshëve të egra të ngordhura ose nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor të marra prej tyre i nënshtrohet pastrimit dhe dezinfektimit ose asgjësohet duke ndjekur udhëzimet dhe nën mbikëqyrjen e veterinerëve zyrtarë.

Neni 63

Masat në rast të shpërthimit të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshë të egra të specieve të listuara

1. Në rast të një konfirmimi zyrtar të një shpërthimi të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët e egra të specieve të listuara, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare përcakton një zonë të infektuar për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të sëmundjes bazuar në:

a) profilin e sëmundjes;

- b) popullatën e vlerësuar të kafshëve të egra të specieve të listuara;
 - c) faktorët e riskut që kontribuojnë në përhapjen e sëmundjes përkatëse të kategorisë A, në veçanti, rrezikun e hyrjes së një sëmundjeje të kategorisë A në stabilimentet që mbajnë kafshë të specieve të listuara;
 - ç) rezultatet e kampionimit; dhe
 - d) faktorë të tjerë përkatës.
2. Për sa u përket kadavrave të kafshëve të egra në të cilat është konfirmuar sëmundja përkatëse e kategorisë A, nëse kafshët e egra janë eliminuar apo janë gjetur të ngordhura, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare siguron që:
- a) kadavrat e kafshëve të egra të ngordhura ose pjesët e tyre asgjësohen ose përpunohen në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor;; dhe
 - b) kur është e mundur, çdo material ose substancë që mund të kontaminohet nga kontakti me kadavrat e kafshëve të egra të ngordhura ose nënproduktet e tyre, i nënshtrohet pastrimit dhe dezinfektimit ose asgjësohet duke ndjekur udhëzimet dhe nën mbikëqyrjen e veterinerëve zyrtarë.
3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare përshtat kufijtë e zonës fillestare të infektuar:
- a) për të kontrolluar përhapjen e mëtejshme të sëmundjes përkatëse të kategorisë A; dhe
 - b) në rastin e konfirmimit të shpërthimeve të mëtejshme të sëmundjes së kategorisë A te kafshët e egra.
4. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare informon menjëherë operatorët, veterinerët klinikë, gjuetarët, autoritetet e tjera kompetente përkatëse dhe çdo person tjetër fizik ose juridik të interesuar për shpërthimin e sëmundjes dhe masat e kontrollit të miratuara.

Neni 64

Masat që zbatohen në zonën e infektuar

1. Në përputhje me nenin 63, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, në zonën e infektuar të përcaktuar, organizon ekzaminime postmortem të kafshëve të egra të specieve të listuara të eliminuara ose të gjetura të ngordhura, duke përfshirë kur është e nevojshme marrjen e mostrave për ekzaminim laboratorik.
2. Në zonën e infektuar, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare të paktën:
- a) zbaton zbutjen e riskut dhe masa të përforcuara të biosigurisë për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A nga kafshët e prekura dhe zona e infektuar te kafshët e paprekura ose te njerëzit;
 - b) ndalon lëvizjet e kafshëve të egra të specieve të listuara dhe produkteve me origjinë shtazore të tyre siç parashikohet në legjislacionin që përcakton kërkesat e shëndetit të kafshëve për lëvizjet brenda vendit të kafshëve tokësore dhe vezëve për çelje; dhe
 - c) siguron që të gjitha kadavrat e kafshëve të egra të ngordhura të specieve të listuara, pavarësisht nëse kafshët janë vrarë ose janë gjetur të ngordhura, apo pjesë të tyre, asgjësohen ose përpunohen në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor.

Neni 65

Masat shtesë për t'u zbatuar në zonën e infektuar

- Për të shmangur përhapjen e sëmundjes së kategorisë A, në zonën e infektuar autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, të:
- a) rregullojë lëvizjet e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara;
 - b) rregullojë aktivitetet e gjuetisë dhe aktivitetet e tjera në natyrë;
 - c) kufizojë ushqimin e kafshëve të egra të specieve të listuara; dhe
 - ç) zhvillojë dhe zbatojë një plan çrrënjësije për sëmundjen e kategorisë A në kafshët e egra të specieve të listuara, nëse këtë e kërkon situata epidemiologjike.

Neni 66
Grupi operativ i ekspertëve

Në rast të një shpërthimi të konfirmuar zyrtarisht të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët e egra të specieve të listuara dhe në rast se autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare përcakton një zonë të infektuar në përputhje me nenin 63, autoriteti kompetent i qendror krijon një grup operativ ekspertësh siç përcaktohet në nenin 43, të ligjit nr. 41/2025, për të ndihmuar autoritetin kompetent të kontrolleve zyrtare në:

- a) vlerësimin e situatës epidemiologjike dhe zhvillimin e saj;
- b) përcaktimin e zonës së infektuar;
- c) vendosjen e masave të duhura që zbatohen në zonën e infektuar në përputhje me këtë kapitull dhe kohëzgjatjen e tyre; dhe
- ç) zhvillimin e një plani çrrënjësjeje, kur është e nevojshme.

Neni 67
Kohëzgjatja e masave në zonën e infektuar

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, në përputhje me këtë krye, mban në fuqi masat në zonën e infektuar derisa informacioni epidemiologjik tregon se popullata përkatëse e egër nuk paraqet më rrezik për hyrjen e një sëmundjeje të kategorisë A në subjektet që mbajnë kafshë të specieve të listuara dhe grupi operacional rekomandon heqjen e këtyre masave.

KREU V
**MASAT E KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE PËR SËMUNDJET E KATEGORISË B
DHE C TË KAFSHËVE TOKËSORE**

Neni 68
Masat paraprake të kontrollit të sëmundjes që zbatohen kur një sëmundje e kategorisë B ose C dyshohet nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare ose zona të cilave ju është dhënë statusi i pastër nga sëmundja

Në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë B ose C në përputhje me legjislacionin për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin e pastër nga sëmundje të listuara dhe ato emergjente, në vend ose zonat që i është dhënë statusi i pastër nga sëmundja në bazë të legjislacionit për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin pa sëmundje, për disa sëmundje të listuara dhe ato emergjente ose pikës 4, të nenit 36, të ligjit nr. 41/2025 autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare zbaton masat e përcaktuara në:

- a) legjislacionin për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin e pastër nga sëmundja për disa sëmundje të listuara dhe ato emergjente për infeksionin me *Brucella abortus*, *B. melitensis*, *B. suis*, infeksioni me *Mycobacterium tuberculosis complex*, leukozën enzootike të gjedhit, rinotrakeitit infektiv të gjedhit/vulvovaginitis pustular infektiv, infeksioni me virusin e sëmundjes së Aujeskut dhe diarrea virale e gjedhit;
- b) legjislacionin për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin pa sëmundje për disa sëmundje të listuara dhe ato emergjente për infeksionin me virusin e tërbimit; dhe
- c) legjislacionin për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin pa sëmundje për disa sëmundje të listuara dhe ato emergjente për infeksionin me virusin e gjuhës blu (stereotipi 1-24).

Neni 69
**Masat e kontrollit të sëmundjeve që zbatohen kur konfirmohet një sëmundje e
kategorive B ose C**

Në rast të konfirmimit të një sëmundjeje të kategorisë B ose C në përputhje me legjislacionin për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin e pastër nga sëmundja për disa sëmundje të listuara dhe ato emergjentenë në vend ose zona që u është dhënë statusi i pastër nga sëmundja sipas legjislacionit për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin pa sëmundje, për disa sëmundje të listuara dhe ato emergjente dhe pikës 4, të nenit 36, të ligjit nr. 41/2025, autoriteti kompetent zbaton masat e përcaktuara në:

a) legjislacionin për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin pa sëmundje për disa sëmundje të listuara dhe ato emergjente për infeksionin me *Brucella abortus*, *B. melitensis*, *B. suis*, infeksionin me *Mycobacterium tuberculosis complex*, leukozën enzootike të gjedhit, rinotrakeit infektiv të gjedhit/vulvo-vaginitit pustular, infeksioni me virusin e sëmundjes Aujeszky dhe diarreja virale e gjedhit;

b) sipas legjislacionit për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin e pastër nga sëmundja për disa sëmundje të listuara dhe ato emergjente për infeksionin me virusin e tërbimit; dhe

c) sipas legjislacionit për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin e pastër nga sëmundja për disa sëmundje të listuara dhe ato emergjente për infeksionin me virusin e gjuhës blu (stereotipi 1-24).

PJESA III KAFSHËT UJORE

KREU I MASAT E KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE PËR SËMUNDJET E KATEGORISË A NË KAFSHËT E AKUAKULTURËS

Seksioni 1

Masat paraprake të kontrollit të sëmundjes në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në kafshët e akuakulturës

Neni 70

Detyrimet e operatorëve në rast dyshimi për sëmundje të kategorisë A në kafshët e akuakulturës në stabiliment

Në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në kafshët e akuakulturës të specieve të listuara, operatorët marrin masat e mëposhtme të kontrollit të sëmundjes për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A nga kafshët e prekura dhe stabilimentet e akuakulturës nën përgjegjësinë e tyre të kafshët e tjera ujore të paprekura derisa autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare përjashton praninë e sëmundjes së kategorisë A:

a) izolon, kur është teknikisht e mundur të gjitha kafshët e akuakulturës në stabiliment që dyshohet se janë të infektuara me sëmundjen e kategorisë A;

b) parandalojnë lëvizjet e kafshëve të akuakulturës në dhe nga stabilimenti;

c) mban shënime për të gjitha vizitat dhe lëvizjet nga dhe drejt stabilimentit;

ç) mban çdo produkt, pjesë të pajisjeve, material ose substancë që mund të kontaminohet dhe të transmetojë sëmundje të kategorisë A të izoluar dhe për aq sa është praktikisht e mbrojtur nga vektorët dhe kafshët e tjera ujore;

d) zbatojnë masat e duhura të biosigurisë për të shmangur përhapjen e sëmundjes së kategorisë A;

dh) i jep autoritetit kompetent të kontrolleve zyrtare, me kërkesën e tij, çdo informacion përkatës në lidhje me sëmundjen e kategorisë A; dhe

d) ndjek çdo udhëzim të dhënë nga autoriteti kompetent të kontrolleve zyrtare në lidhje me kontrollin e sëmundjes së kategorisë A, në përputhje me Ligjin nr. 41/2025 dhe këtë rregullore.

Neni 71

Hetimi nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare në rast të dyshimit për një sëmundje të kategorisë A në kafshët e akuakulturës në një stabiliment

1. Në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në kafshët e akuakulturës në një stabiliment në përputhje me legjislacionin për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin e pastër nga sëmundja për disa sëmundje të listuara dhe ato emergjente, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare kryen menjëherë një hetim për të konfirmuar ose përjashtuar praninë e sëmundjes së dyshuar të listuar.

2. Gjatë hetimit të përmendur në paragrafin 1, autoriteti kompetent siguron që veterinerët zyrtarë të kryejnë së paku:

- a) ekzaminimet klinike të kafshëve të akuakulturës; dhe
- b) mbledhjen e mostrave për ekzaminim laboratorik.

Neni 72

Masat paraprake të kufizimit dhe biosigurisë që zbatohen në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në kafshët e akuakulturës

1. Në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në një stabiliment, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare vendos stabilimentin nën mbikëqyrje zyrtare dhe vendos menjëherë masat paraprake të kufizimit dhe të biosigurisë, për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A nga kafshët e prekura të akuakulturës dhe stabilimentit të kafshëve ujore të paprekura si:

- a) ndalimi i lëvizjeve të kafshëve të akuakulturës në dhe nga stabilimenti;
- b) ndalimi i lëvizjeve jo të nevojshme/rëndësishme nga stabilimenti i mjeteve të transportit dhe pajisjeve;
- c) ndalimi i therjes së kafshëve të akuakulturës për konsum njerëzor;
- ç) kur është teknikisht e mundur dhe konsiderohet e nevojshme, të urdhërojë izolimin e të gjitha kafshëve të akuakulturës; dhe
- d) kur është e mundur, të zbatohen mjetet dhe masat e duhura për të kontrolluar zogjtë dhe grabitqarët e tjerë.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron eliminimin parandalues të specieve të listuara në stabilimentin e prekur kur dyshohet për një sëmundje të kategorisë A, me kusht që të zbatohen të gjitha masat e nevojshme të biosigurisë dhe të tjera për zbutjen e riskut për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A nga stabilimenti.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, duke përjashtuar legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor dhe pas kryerjes së vlerësimit të riskut, autorizon lëvizjen e kafshëve të akuakulturës vetëm për eliminimin e menjëhershëm në një stabiliment ushqimore të kafshëve të ujit për kontrollin e sëmundjeve ose në një fabrikë e cila është e miratuar për përpunimin dhe asgjësimin e tyre si nënprodukte me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor që i përkasin kategorisë 1 ose kategorisë 2, në përputhje me atë legjislacion. Autorizimi jepet vetëm kur zbatohen masat e nevojshme të biosigurisë dhe masat e tjera për zbutjen e rrezikut për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A.

4. Të gjitha nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor nga kafshët e akuakulturës të ngordhura, të cilat kanë ngordhur ose janë eliminuar në përputhje me këtë nen, duke përfshirë guaskat e molusqeve me mish, duke përjashtuar legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, përpunohen ose asgjësohen si material i kategorisë 1 ose kategorisë 2 në përputhje me atë legjislacion për të siguruar që agjenti përkatës i sëmundjes është i çaktivizuar dhe për të parandaluar transmetimin e sëmundjes te kafshët e tjera ujore.

Neni 73

Inventarizimi dhe analizimi i të dhënave në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në kafshët e akuakulturës

1. Në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron dhe verifikon pa vonesë operatorët e stabilimenteve ku dyshohet për një sëmundje të kategorisë A, të hartojnë dhe të mbajnë një inventar të përditësuar për:

- a) speciet, kategoritë dhe sasisë (numrat, vëllimi ose pesha) e të gjitha kafshëve të akuakulturës që mbahen në stabiliment;
- b) çdo produkt, material ose substancë që ka gjasa të jetë i kontaminuar ose ka gjasa të transmetojë sëmundjen e kategorisë A; dhe
- c) mortalitetin në çdo njësi epidemiologjike brenda stabilimentit, e regjistruar në mënyrë ditore.

2. Në kuadër të hetimit epidemiologjik, siç përcaktohet në nenin 57, të ligjit nr. 41/2025, dhe të kryer në stabilimentet ku dyshohet për sëmundjen, veterinerët zyrtarë të analizojnë të paktën të dhënat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 186, të ligjit nr. 41/2025.

Neni 74

Shtrirja e masave të kontrollit të sëmundjes në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në stabilimente të tjera

Për të parandaluar përhapjen e një sëmundjeje të kategorisë A, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare kryen një hetim siç parashikohet në nenin 71 dhe pas kryerjes së një vlerësimi të riskut shtrën masat përkatëse të parashikuara në nenin 72 dhe 73 në:

- a) stabilimentet e vendosura në të njëjtën kompartament/ndarje me stabilimentin ku dyshohet për sëmundjen, ose të cilat, për shkak të distancës, kushteve hidrodinamike ose kushteve topografike, kanë një rrezik në rritje për infektimin nga agjenti përkatës i sëmundjes nga stabilimenti ku dyshohet për sëmundjen;
- b) çdo stabiliment tjetër përveç atyre të përmendura në shkronjën “a”, i cili ka një lidhje të drejtpërdrejtë epidemiologjike me stabilimentin ku dyshohet për sëmundjen.

Neni 75

Zona të përkohshme të kufizuara përreth stabilimentit

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare vendos një zonë të përkohshme të kufizuar rreth stabilimentit ku ekziston dyshimi për sëmundje të kategorisë A dhe ku zbatohen masat paraprake të kontrollit të sëmundjes, siç përmendet në nenin 72 dhe nenin 73, duke marrë parasysh rrethanat e mëposhtme:

- a) vendndodhjen e stabilimentit në një zonë me stabilimente të tjera që mbajnë kafshë akuakulture të specieve të listuara për të cilat dyshohet një sëmundje e kategorisë A;
- b) lëvizjen e kafshëve në afërsi të stabilimentit të dyshuar;
- c) vonesat në konfirmimin e sëmundjes së kategorisë A sipas nenit 77;
- ç) informacioni i pamjaftueshëm për origjinën dhe rrugët e mundshme të paraqitjes së sëmundjes së kategorisë A të dyshuar; dhe
- d) profilin e sëmundjes, në veçanti rrugët dhe shpejtësinë e transmetimit të sëmundjes dhe persistencën e sëmundjes në popullatën përkatëse të kafshëve të akuakulturës të specieve të listuara.

Neni 76

Masat që zbatohen në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, qendrën e depurifikimit, qendrën e shpërndarjes,

pikat e kontrollit kufitar, stabilimentet e nënprodukteve të kafshëve jo për konsum njerëzor ose çdo vendndodhje tjetër të rëndësishme, duke përfshirë mjetet e transportit

1. Në rast dyshimi për një sëmundje të kategorisë A në përputhje me legjislacionin për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin pa sëmundje për disa sëmundje të listuara dhe ato emergjente në bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, qendrat e pastrimit depurifikimit, qendrat e shpërndarjes, pikat e kontrollit kufitar, stabilimentet e nënprodukteve të kafshëve jo për konsum njerëzor ose çdo vendndodhje tjetër e rëndësishme, duke përfshirë mjetet e transportit, autoriteti kompetent zbaton:

a) masat e parashikuara në nenin 71 deri në 75; dhe
b) nëse është e nevojshme, masa shtesë të përshtatura për situatën specifike për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A nga kafshët dhe stabilimentet ose vendndodhjet nën dyshim të kafshët e paprekura.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare zbaton dispozitat e përcaktuara në nenet 71 deri në 75 edhe në stabilimentet e origjinës së kafshëve ose produkteve të pranishme në stabilimentet dhe vendndodhjet e përmendura në pikën 1.

Seksioni 2

Masat e kontrollit të sëmundjeve në rast të konfirmimit zyrtar të sëmundjes së kategorisë A në kafshët e akuakulturës

Neni 77

Konfirmimi zyrtar i një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët e akuakulturës

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare konfirmon zyrtarisht një shpërthim të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët e akuakulturës kur plotësohen kushtet e përcaktuara në legjislacionin për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin e pastër nga sëmundja për disa sëmundje të listuara dhe ato emergjente.

Neni 78

Masat e kontrollit të sëmundjeve në rast të konfirmimit zyrtar të një shpërthimi të sëmundjes së kategorisë A në një stabiliment

1. Pas konfirmimit zyrtar të shpërthimit të një sëmundjeje të kategorisë A në përputhje me nenin 77, autoriteti kompetent përveç masave të parashikuara në nenin 72 dhe nenin 73, urdhëron që masat e mëposhtme të kontrollit të sëmundjes të zbatohen menjëherë nën mbikëqyrjen e veterinerëve zyrtarë, në stabilimentin ku ka ndodhur konfirmimi zyrtar i një shpërthimi të një sëmundjeje të kategorisë A:

a) peshqit dhe krustacet e specieve të listuara të eliminohen sa më shpejt të jetë e mundur dhe molusqet e specieve të listuara të hiqen nga uji sa më shpejt të jetë e mundur;

b) kafshët e përmendura të shkronja "a", asgjësohen si materiale të kategorisë 1 ose të kategorisë 2, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor;

c) masat e parashikuara në shkronjat a dhe b kryhen:

i. në stabilimentin ku ka ndodhur konfirmimi zyrtar i një shpërthimi të një sëmundjeje të kategorisë A, me përpunim të mëvonshëm në terren; ose

ii. në një stabiliment ushqimor uxor për kontrollin e sëmundjeve, ose në një stabiliment të miratuar në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor për përpunim ose asgjësim në një mënyrë që parandalohet rreziku i përhapjes së sëmundjes së kategorisë A;

ç) kafshët e akuakulturës të specieve të palistuara, eliminohen ose theren për konsum njerëzor sa më shpejt të jetë e mundur, ose, në rastin e molusqeve, hiqen nga uji në përputhje me shkronjën “b”, të pikës 1;

d) zbatohen masat e duhura për të kufizuar çdo përhapje të mundshme të sëmundjes së kategorisë A, të dhe nga çdo kafshë e egër ujore që mund të jetë në kontakt epidemiologjik me stabilimentin;

dh) të gjitha produktet, materialet ose substancat potencialisht të kontaminuara izolohehen derisa:

i. ato asgjësohen në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, në rastin e nënprodukteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor;

ii. me përjashtim të rasteve kur në legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor përcaktohet ndryshe, ato asgjësohen ose përpunohen si materiale të kategorisë 1 ose kategorisë 2 në përputhje me atë rregullore, në rastin e produkteve me origjinë shtazore;

iii. masat e pastrimit dhe dezinfektimit janë kryer në përputhje me dispozitat e nenit 80, në rastin e materialeve dhe substancave që janë të përshtatshme për pastrim dhe dezinfektim; dhe

iv. ato hiqen nga stabilimenti dhe eliminohen nën mbikëqyrjen e veterinerëve zyrtarë, në rastin e ushqimeve për kafshë dhe materialeve të tjera të papërshtatshme për pastrim dhe dezinfektim.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare për veterinarinë dhe sigurinë ushqimore sipas fushës së veprimit, urdhëron dhe mbikëqyr:

a) transportin nga stabilimenti i prekur i nënprodukteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor dhe i produkteve me origjinë për konsum njerëzor të bëhet në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor; dhe

b) transporti nga stabilimenti i prekur i materialeve ose substancave të përmendura në pikën “iv”, shkronja “dh”, të pikës 1, duke qenë në përputhje me udhëzimet e tij në lidhje me kushtet e biosigurisë dhe sigurisë për të parandaluar përhapjen e agjentit të sëmundjes së kategorisë A.

3. Me përjashtim të shkronjës a, të pikës 1, autoritetet kompetente të kontrolleve zyrtare, pas kryerjes së një vlerësimi të riskut, lejojnë therjen e peshqve ose krustaceve ose në rast të largimit të molusqeve nga uji, për konsum njerëzor në stabiliment ose në një stabiliment ushqimor ujor për kontrollin e sëmundjeve, me kusht që të merren masat e duhura të biosigurisë dhe masa të tjera të nevojshme për zbutjen e rrezikut për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A. Të gjitha nënproduktet shtazore jo për konsum njerëzor që rezultojnë nga ai përjashtim, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, përpunohet ose asgjësohet si material i kategorisë 1 ose kategorisë 2.

4. Me përjashtim të shkronjës “ç”, të pikës 1, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, pas kryerjes së një vlerësimi të riskut, mund të vendosë të mos eliminojë, ose të largojë nga uji kafshët e akuakulturës të specieve të palistuara, me kusht që të jenë marrë masat e duhura për të parandaluar çdo rrezik të përhapjes së sëmundjes përkatëse të kategorisë A nga stabilimenti.

5. Me përjashtim të pikës “ii”, shkronja “dh”, e pikës 1, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, pas kryerjes së një vlerësimi të rrezikut, mund të lejojë vendosjen në treg të produkteve me origjinë shtazore në përputhje me nenin 83.

Neni 79

Përjashtime specifike nga masat e kontrollit në stabilimentet ku speciet e listuara mbahen për qëllime shkencore ose qëllime që lidhen me ruajtjen e specieve të rrezikuara

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të lejojë përjashtime nga masat e parashikuara në shkronjën “a” dhe c, të pikës 1, të nenit 78, në rast të një konfirmimi zyrtar të një sëmundjeje të kategorisë A, në stabilimentet ku speciet e listuara mbahen për qëllime shkencore ose për qëllime të tjera lidhur me ruajtjen e specieve të rrezikuara, me kusht që:

a) statusi shëndetësor i kafshëve në të gjithë vendet ose në rajone, nuk është i rrezikuar; dhe

b) janë marrë të gjitha masat e duhura të biosigurisë, siç përcaktohen në nenin 78, për të parandaluar çdo rrezik të përhapjes së agjentit të sëmundjes së kategorisë A.

2. Kur një përjashtim jepet në përputhje me pikën 1, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare siguron që kafshët e akuakulturës të specieve të listuara të mbuluara nga përjashtimi janë:

a) të mbajtura në ambiente ku zbatohen masat e duhura të biosigurisë për të shmangur përhapjen e sëmundjes përkatëse të kategorisë A; dhe

b) nënshtruar mbikëqyrjes dhe ekzaminimit laboratorik të mëtejshëm dhe nuk lëvizin nga stabilimenti derisa testet laboratorike të kenë treguar se ato nuk paraqesin rrezik për përhapjen e mëtejshme të sëmundjes përkatëse të kategorisë A.

Neni 80

Pastrimi dhe dezinfektimi

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron operatorët menjëherë pas përfundimit të masave të kontrollit të sëmundjes, të parashikuara në nenin 78, të kryejnë pastrimin dhe dezinfektimin e:

a) stabilimentit, për aq sa autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare e konsideron se është teknikisht e mundur;

b) çdo pajisje që lidhet me blegtorinë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në ushqim, klasifikim, trajtim, vaksinim dhe varkat e punës;

c) çdo pajisje që lidhet me prodhimin, duke përfshirë, por pa u kufizuar në kafaze, rrjeta, qese, strukturat mbështetëse dhe linja të gjata peshkimi;

ç) çdo veshje mbrojtëse ose pajisje sigurie të përdorur nga operatorët dhe vizitorët; dhe

d) të gjitha mjetet e transportit duke përfshirë tanket dhe pajisjet e tjera të përdorura për të lëvizur kafshët e infektuara ose personelin që ka qenë në kontakt me kafshët e infektuara.

2. Pastrimi dhe dezinfektimi i parashikuar në pikën 1 kryhet:

a) në përputhje me një protokoll të rënë dakord më parë midis autoritetit kompetent i kontrolleve zyrtare dhe operatorit; dhe

b) nën mbikëqyrjen e veterinerëve zyrtarë.

Neni 81

Periudha e pushimit të aktivitetit të stabilimentit të prekur

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron operatorët, pas përfundimit të pastrimit dhe dezinfektimit të parashikuar në nenin 80, të kryejnë një periudhë pushimi aktiviteti të stabilimentit të prekur për periudhën kohore të përcaktuar në shtojcën XIII.

Neni 82

Shtirja e masave të kontrollit të sëmundjes në rast konfirmimi të një sëmundjeje të kategorisë A

Për të parandaluar përhapjen e një sëmundjeje të kategorisë A, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare kryen një hetim të parashikuar në nenin 71 dhe pas kryerjes së një vlerësimi të riskut, shtrin disa ose të gjitha masat e parashikuara në nenet 78, 80 dhe 81 për:

a) stabilimentet e të njëjtës ndarje/kompartament ose që për shkak të distancës, kushteve hidrodinamike ose kushteve topografike, kanë një rrezik në rritje për infektimin nga agjenti përkatës i sëmundjes nga stabilimenti i dyshuar ku është konfirmuar sëmundja;

b) çdo stabiliment i cili si rezultat i hetimit të parashikuar në nenin 57, të ligjit nr. 41/2025 ka treguar një lidhje të drejtpërdrejtë epidemiologjike me stabilimentin ku është konfirmuar sëmundja.

Neni 83

Vendosja në treg e produkteve me origjinë shtazore nga kafshët e akuakulturës të specieve të listuara të prodhuara në stabilimentet e infektuara

1. Kur jep një përjashtim në përputhje me pikën 5 të nenit 78, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare për sigurinë ushqimore dhe të veterinarisë sipas fushës së veprimit lejon vendosjen në treg të produkteve me origjinë shtazore vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) peshqit theren dhe të eviscerohet para dërgimit;
- b) përpara dërgimit, molusqet dhe krustacet janë plotësisht të gjurmueshëm dhe transformohen në produkte jo të gjalla që nuk janë në gjendje të mbijetojnë nëse vendosen përsëri në ujë.

Nëse pastrimi është i nevojshëm përpara përpunimit dhe vendosjes në treg, ai kryhet në një stabiliment ushqimor ujqor për kontrollin e sëmundjeve ose një qendër pastrimi me nivel të lartë biosigurie.

2. Produktet me origjinë shtazore të përmendura në pikën 1 janë të destinuara për:

- a) konsumatorin përfundimtar drejtpërsëdrejti; ose
- b) përpunimin e mëtejshëm në një stabiliment ushqimor për kontrollin e sëmundjeve.

Neni 84

Masat që zbatohen në rast të konfirmimit të sëmundjeve të kategorisë A në bizneset ushqimore dhe ushqimit për kafshë, qendrat e depurifikimit, qendrat e dërgimit, pikat e kontrollit kufitar ose çdo vendndodhje tjetër të rëndësishme, duke përfshirë mjetet e transportit

1. Në rast të konfirmimit të një sëmundjeje të kategorisë A në bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, qendrat e depurifikimit, qendrat e dërgimit, pikat e kontrollit kufitar ose çdo vendndodhje tjetër të rëndësishme, duke përfshirë mjetet e transportit, në përputhje me nenin 77, autoriteti kompetent për sigurinë ushqimore zbaton:

- a) masat e parashikuara në nenet 78, 80 dhe 81; dhe
- b) nëse është e nevojshme, masa shtesë të përshtatura për situatën specifike për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A nga kafshët dhe stabilimentet ose vendndodhjet e prekura të kafshët e paprekura.

2. Autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare në fushën e veterinarisë dhe sigurisë ushqimore sipas fushës së veprimit zbatojnë dispozitat e përcaktuara në nenin 78, 80 dhe 81 gjithashtu në stabilimentet e origjinës së kafshëve ose produkteve të pranishme në stabilimentet dhe vendndodhjet e përmendura në pikën 1.

KREU II

MASAT E KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE PËR SËMUNDJET E KATEGORISË A TË KAFSHËVE TË AKUAKULTURËS NË ZONËN E KUFIZUAR

Seksioni 1

Masat e përgjithshme të kontrollit të sëmundjes në zonën e kufizuar

Neni 85

Krijimi i një zone të kufizuar

1. Në rast të konfirmimit zyrtar të një shpërthimi të një sëmundjeje të kategorisë A në një stabiliment, biznes ushqimor dhe ushqimi për kafshë, stabiliment të nënprodukteve të kafshëve, jo për konsum njerëzor ose çdo vendndodhje tjetër të rëndësishme, duke përfshirë mjetet e

transportit, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare vendos menjëherë një zonë të kufizuar rreth stabilimentit ose vendndodhjes së prekur, duke përfshirë:

a) një zonë mbrojtjeje rreth stabilimentit ose vendndodhjes ku konfirmohet sëmundja e kategorisë A;

b) një zonë mbikëqyrjeje rreth zonës së mbrojtjes; dhe

c) nëse është e nevojshme, në bazë të kriterëve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 41/2025, zona të tjera të kufizuara përreth ose ngjitur me zonat e mbrojtjes dhe të mbikëqyrjes.

2. Shtrirja e zonave përcaktohet rast pas rasti, duke marrë parasysh faktorët që ndikojnë në rrezikun e përhapjes së sëmundjes. Për këtë qëllim, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare bazohet në të dhënat dhe kriteret e mëposhtme:

a) të dhënat nga hetimi epidemiologjik në përputhje me nenin 57, të ligjit nr. 41/2025;

b) të dhënat përkatëse hidrodinamike;

c) kriteret e renditura në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 41/2025; dhe

ç) kriteret e parashikuara në shtojcën XIV të kësaj rregulloreje.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare përshtat kufijtë e zonës fillestare të kufizuar, duke përfshirë kufijtë e zonës së mbrojtjes, zonës së mbikëqyrjes dhe zonave të tjera të kufizuara, në rastin e mbivendosjes së dy ose më shumë zonave të kufizuara për shkak të shpërthimeve të mëtejshme të sëmundjes së kategorisë A.

4. Me përjashtim të pikës 1, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, në sajë të rrethanave specifike gjeografike, hidrodinamike dhe epidemiologjike, dhe pas kryerjes së një vlerësimi të rrisikut duke marrë parasysh profilin e sëmundjes, mund:

a) të mos krijojë zonën e kufizuar siç parashikohet në pikën 1 rreth stabilimentit ose vendndodhjes së infektuar;

b) të krijojë një zonë të kufizuar të përbërë nga një zonë mbrojtëse pa ndonjë zonë mbikëqyrjeje ngjitur; dhe

c) të mos krijojë një zonë të kufizuar kur një sëmundje e kategorisë A konfirmohet në bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, qendra të pastrimit, qendra të dërgimit të kafshëve, pikat e kontrollit kufitar, qendrat e nënprodukteve të kafshëve ose çdo vendndodhje tjetër të rëndësishme, duke përfshirë mjetet e transportit.

5. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare bën përjashtime, deri në masën e nevojshme dhe pasi ka kryer një vlerësim risku bazuar në rrethanat gjeografike, hidrodinamike, epidemiologjike dhe profilin e sëmundjes, në dispozitat e këtij kreu:

a) në zonat e mëtejshme të kufizuara; dhe

b) në rastin kur autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare vendos të krijojë zonën e kufizuar kur një shpërthim i një sëmundjeje të kategorisë A ndodh në stabiliment ose në çdo vendndodhje tjetër të rëndësishme të përmendur në shkronjën c, të pikës 4.

Neni 86

Masat që duhen zbatuar në zonën e kufizuar

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare harton pa vonesë dhe mban një inventar të përditësuar të të gjitha stabilimenteve që mbajnë kafshë akuakulture të specieve të listuara të vendosura në zonën e kufizuar, duke përfshirë speciet, kategoritë dhe numrin e parashikuar të kafshëve në secilin stabiliment.

2. Në stabilimentet e vendosura brenda zonës së kufizuar, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare në bazë të informacionit epidemiologjik ose provave të tjera përkatëse dhe pas kryerjes së një vlerësimi të riskut, zbaton eliminimin parandalues ose therjen për konsum njerëzor ose, në rastin e molusqeve, largimi nga uji i kafshëve të akuakulturës të specieve të listuara në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 1 dhe pikës 2, të nenit 78.

3. Çdo grumbullim mostrash, në stabilimentet që ndodhen në zonën e kufizuar dhe që mbajnë kafshë akuakulture të specieve të listuara, për qëllime të tjera përveçse për të konfirmuar ose përjashtuar praninë e sëmundjes përkatëse të kategorisë A, autorizohet nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare.

Seksioni 2

Masat e kontrollit të sëmundjeve në zonën e mbrojtjes

Neni 87

Masat që zbatohen në stabilimentet që mbajnë kafshë të akuakulturës në zonën e mbrojtjes

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron operatorët e stabilimenteve që mbajnë kafshë akuakulture të çdo lloji në zonën e mbrojtjes, përveç stabilimentit në të cilin është konfirmuar sëmundja e kategorisë A, të ndërmarrin të paktën masat e mëposhtme për të parandaluar dhe kontrolluar përhapjen e sëmundjes:

- a) përditëson pa vonesë të dhënat e inventarit të parashikuar në pikën 1, të nenit 73;
- b) të zbatojë, kur është e mundur, masat e duhura për të kufizuar çdo përhapje të mundshme të sëmundjes së kategorisë A të dhe nga çdo kafshë e egër ujore që mund të jetë në kontakt epidemiologjik me stabilimentin;
- c) të parandalojë largimin e kafshëve të akuakulturës nga stabilimenti në të cilin mbahen, përveç rasteve kur autorizohet nga autoriteti kompetent;
- ç) të zbatojë masat e duhura të biosigurisë për çdo produkt, pajisje, material ose substancë që mund të përhapë sëmundjen përkatëse të kategorisë A;
- d) të zvogëlojë numrin e vizitorëve, përveç atyre që janë rreptësisht të nevojshëm për funksionimin e stabilimentit në mënyrën e duhur; dhe
- dh) aty ku është e mundur, të përdorë mjete të përshtatshme pastrimi dhe dezinfektimi në hyrje dhe dalje të stabilimentit.

2. Autoriteti kompetent urdhëron dhe mbikëqyr që operatori ka përpunuar ose asgjësuar si material të kategorisë përkatëse në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor të përfutuara nga kafshë të akuakulturës që bëjnë pjesë në specie të listuara të cilat kanë ngordhur ose janë eliminuar, duke përfshirë guaskat e molusqeve me mish, në stabilimentet që mbajnë specie të listuara brenda zonës së mbrojtjes.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare vendos pas kryerjes së një vlerësimi risku që nenet 87 dhe 88 zbatohen vetëm për kafshët e akuakulturës të specieve të listuara.

Neni 88

Vizita në stabilimentet e zonës së mbrojtur nga veterinerët zyrtarë

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare siguron që veterinerët zyrtarë të kryejnë të paktën një vizitë në të gjitha stabilimentet e përmendura në nenin 87, sa më shpejt të jetë e mundur dhe pa vonesë, pas konfirmimit zyrtar të një shpërthimi të sëmundjes së kategorisë A, me prioritet të drejtuar në stabilimentet që Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare ka vlerësuar si me një rrezik më të lartë për sa i përket prekjes/infektimit ose përhapjes së sëmundjes.

2. Gjatë kryerjes së vizitave të përmendura në paragrafin 1, veterinerët zyrtarë kryejnë së paku këto aktivitete:

- a) kontrolle dokumentare dhe analiza të të dhënave;
- b) verifikimin e zbatimit të masave që synojnë të parandalojnë hyrjen ose përhapjen e sëmundjes përkatëse të kategorisë A, në përputhje me nenin 87;
- c) ekzaminimin klinik të kafshëve të akuakulturës të specieve të listuara; dhe

ç) nëse është e nevojshme, mbledhja e mostrave për ekzaminim laboratorik për të konfirmuar ose përjashtuar praninë e sëmundjes përkatëse të kategorisë A.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të kërkojë vizita të mëtejshme veterinare në stabiliment për të ndjekur situatën.

4. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mban një regjistër të aktiviteteve dhe vizitave të përmendura në pikën 1, 2 dhe 3, si dhe gjetjet e tyre.

Neni 89

Ndalimet në lidhje me lëvizjet e kafshëve të akuakulturës, produkteve nga kafshët e akuakulturës, substancave dhe materialeve të tjera brenda, nga ose në zonën e mbrojtjes

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare ndalon lëvizjet e mëposhtme brenda zonës së mbrojtjes:

a) lëvizjen e kafshëve të akuakulturës të specieve të listuara ndërmjet stabilimenteve në zonën e mbrojtur;

b) lëvizjen e kafshëve të akuakulturës të specieve të listuara nga ose në zonën e mbrojtur;

c) çdo lëvizje nga stabilimentet brenda zonës së mbrojtjes së mjeteve të transportit dhe çdo pajisje, produkt, material ose substancë që mund të transmetojë sëmundjen përkatëse të kategorisë A;

ç) transportin e kafshëve të akuakulturës me “*anije cistern*” për transportin e peshkut të gjallë përmes zonës së mbrojtjes; dhe

d) largimin e nënprodukteve shtazore jo për konsum njerëzor të papërpunuara nga kafshët e akuakulturës të çdo lloji, nga stabilimentet në zonën e mbrojtur.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, pas kryerjes së një vlerësimi të riskut, mund të zgjerojë ndalimet e parashikuara në shkronjën “a”, në pikën 1, deri në shkronjën ç, të pikës 1, për kafshët e specieve të palistuar dhe produktet e tyre.

Neni 90

Kushtet e përgjithshme për të dhënë përjashtime nga ndalimet e lëvizjes dhe transportit në lidhje me kafshët ujore dhe produktet në zonën e mbrojtur

1. Me përjashtim të ndalimeve të parashikuara në pikën 1, të nenit 89, Autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare në fushën e veterinarisë dhe sigurisë ushqimore sipas fushes së veprimit autorizon lëvizjen dhe transportin e kafshëve dhe produkteve ujore në rastet e përcaktuara në nenet 91 deri në 94 sipas kushteve specifike të parashikuara në ato nene dhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

2. Gjatë dhënies së autorizimeve të parashikuara në pikën 1, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare siguron që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) të gjitha lëvizjet kryhen ekskluzivisht përmes rrugëve të përcaktuara, për të cilat është rënë dakord me autoritetin kompetent të kontrolleve zyrtare, pa shkarkim ose ndalim;

b) çdo shkëmbim dhe shkarkim i ujit gjatë transportit kryhet në zona, stabilimente ose pika shkëmbimi uji të miratuara nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare;

c) mjetet e transportit ndërtohen dhe mirëmbahen në mënyrë të tillë që t’i nënshtrohen pastrimit dhe dezinfektimit të duhur;

ç) mjetet e transportit pastrohen dhe dezinfektohen:

i. përpara transportit; dhe

ii. pas transportit nën mbikëqyrjen e veterinerit zyrtar;

d) çdo masë tjetër plotësuese e biosigurisë që konsiderohet e nevojshme nga autoriteti kompetent merret në lidhje me transportin.

Neni 91

Kushtet specifike për therjen dhe lëvizjet për therje ose përpunim të kafshëve të akuakulturës të specieve të listuara të stabilimenteve në zonën e mbrojtur

1. Kafshët e akuakulturës nga stabilimentet që mbajnë specie të listuara në zonën e mbrojtur mund të jenë:

- a) therur brenda stabilimentit në përputhje me masat e biosigurisë të parashikuara nga autoriteti kompetent; ose
- b) zhvendosur për therje të menjëhershme për konsum njerëzor në një stabiliment për kontrollin e sëmundjeve për ushqimet me origjinë nga uji; ose
- c) në rastin e molusqeve, të hequr nga uji dhe të zhvendosur në një stabiliment ushqimor të produkteve ujore për kontrollin e sëmundjeve për pastrim dhe nëse është e nevojshme dhe përpunim të mëtejshëm.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, pas kryerjes së një vlerësimi të riskut bazuar në të dhënat përkatëse epidemiologjike, kufizon zbatimin e masave të parashikuara në pikën 1 në stabilimentet që mbajnë vetëm kafshë akuakulture të specieve të listuara në kolonën e katërt të shtojcës I, të urdhrit nr. 277, datë 15.6.2022, “Për zbatimin e disa rregullave për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të kategorive të listuara dhe krijimin e një liste të specieve dhe grupeve të specieve që paraqesin rrezik të konsiderueshëm për përhapjen e këtyre sëmundjeve”.

3. Kur autorizon lëvizjet e kafshëve të akuakulturës të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare përgjegjës për stabilimentin e ushqimit ujor për kontrollin e sëmundjeve:

- a) informohet nga operatori i stabilimentit për qëllimin për të dërguar kafshë të akuakulturës të specieve të listuara në stabilimentet ujore të ushqimit për kontrollin e sëmundjeve;
- b) pranon të marrë kafshët e akuakulturës në fjalë;
- c) mbikëqyr dhe konfirmon therjen e kafshëve tek autoriteti kompetent i dërgimit;
- ç) siguron që kafshët e akuakulturës të specieve të listuara me origjinë nga zona e mbrojtur të mbahen të ndara nga kafshët e akuakulturës të specieve të listuara me origjinë nga jashtë zonës së mbrojtur, dhe të theren ose të përpunohen veçmas nga ato kafshë;
- d) monitoron therjen ose përpunimin;
- dh) siguron që pastrimi dhe dezinfektimi i ambienteve të përfundojë përpara se kafshët e akuakulturës nga stabilimentet jashtë zonës së mbrojtjes të theren ose të përpunohen;
- d) siguron që produktet me origjinë shtazore të marra nga kafshët e akuakulturës të jenë në përputhje me kushtet specifike për vendosjen në treg të parashikuara në nenin 92; dhe
- ë) siguron që nënproduktet shtazore jo për konsum njerëzor nga therja ose proceset e tjera të përmendura në paragrafin 1, të përpunohen ose asgjësohen në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor.

Neni 92

Kushtet specifike për vendosjen në treg të produkteve me origjinë shtazore nga kafshët e akuakulturës të specieve të listuara të prodhuara në stabilimentet e paprekura nga sëmundja në zonën e mbrojtur

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare në fushën e sigurisë ushqimore autorizon vendosjen në treg të produkteve me origjinë shtazore të marra nga kafshët e akuakulturës të specieve të listuara në stabilimentet e paprekura në zonën e mbrojtur, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) peshqit të theren dhe të nxirren jashtë para dërgimit; dhe
- b) molusqet dhe krustacet të jenë plotësisht të gjurmueshëm dhe të përpunuar në produkte jo të qëndrueshme që nuk mund të mbijetojnë nëse kthehen në ujë, përpara dërgimit.

2. Produktet me origjinë shtazore të përmendura në pikën 1 synohen:

- a) për furnizim të drejtpërdrejtë të konsumatorit përfundimtar; ose

b) për përpunim të mëtejshëm në një stabiliment ushqimor për kontrollin e sëmundjeve.

Neni 93

Kushtet e veçanta për autorizimin e transportit të nënprodukteve me origjinë shtazore jo për konsum human të papërpunuara nga stabilimentet që ndodhen në zonën e mbrojtur

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare të autorizojë transportin e nënprodukteve shtazore jo për konsum njerëzor të papërpunuara të kafshëve të akuakulturës të specieve të listuara nga stabilimentet në zonën e mbrojtur në një fabrikë për përpunim të mëtejshëm në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor.

Neni 94

Masat për zbutjen e riskut në lidhje me aktivitete të caktuara që lidhen me kafshët ujore brenda zonës së mbrojtjes

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, pas kryerjes së një vlerësimi të riskut, zbaton masa për zbutjen e riskut në lidhje me:

- a) aktivitetet e peshkimit tregtar dhe rekreativ në zonën e mbrojtur;
- b) aktivitete të tjera që lidhen me kafshët ujore në zonën e mbrojtur dhe që mund të paraqesin rrezik për përhapjen e sëmundjes; dhe
- c) transportin e varkave të shërbimit të përdorura për aktivitetet e mirëmbajtjes dhe trajtimin e kafshëve ujore në zonën e mbrojtjes.

2. Në kuadrin e masave të parashikuara në pikën 1, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, sipas rastit, urdhëron pastrimin dhe dezinfektimin e pajisjeve, të cilat janë përdorur në ujërat e mbuluara nga zona e mbrojtur.

Neni 95

Masat që zbatohen në bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, qendrat e depurifikimit, qendrat e shpërndarjes, pikat e kontrollit kufitar, stabilimentet e nënprodukteve të kafshëve jo për konsum njerëzor ose çdo vendndodhje tjetër e rëndësishme në zonën e mbrojtjes, duke përfshirë mjetet e transportit

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare në fushën e veterinarisë dhe sigurisë ushqimore sipas fushës së përgjegjësisë zbaton masat e parashikuara në nenin 87 deri në nenin 93 në bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, qendrat e depurifikimit, qendrat e shpërndarjes, pikat e kontrollit kufitar, qendrat e nënprodukteve të kafshëve jo për konsum njerëzor ose çdo vendndodhje tjetër të rëndësishme në zonën e mbrojtjes, duke përfshirë mjetet e transportit.

2. Në stabilimentet dhe vendndodhjet e përmendura në pikën 1, autoritetet kompetente të kontrolleve zyrtare mund të përcaktojnë masa shtesë të përshtatura për situatën specifike, për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A brenda dhe nga zona e mbrojtur.

Neni 96

Heqja e kafshëve të akuakulturës nga stabilimentet e prekura dhe masat e mëvonshme për zbutjen e riskut

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare përcakton një moment në të cilin kafshët e akuakulturës në të gjitha stabilimentet e infektuara hiqen.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare vendos pas kryerjes së një vlerësimi të riskut, që pika 1 të zbatohet edhe për stabilimentet në zonën e mbrojtur në të cilat sëmundja e kategorisë A nuk është konfirmuar, për të kontrolluar dhe parandaluar përhapjen e mundshme të sëmundjeve.

3. Pas largimit/heqjes së kafshëve të akuakulturës, siç parashikohet në pikën 1, pastrimi, dezinfektimi dhe zbrazja kryhet në përputhje me nenet 80 dhe 81.

4. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron ndalimin e njëkohshëm të veprimtarisë për stabilimentet e prekura dhe stabilimentet e përzgjedhura në përputhje me pikën 2.

5. Ndalimi i njëkohshëm i veprimtarisë, i përmendur në pikën 4, zgjat për periudhën kohore të përcaktuar në shtojcën XIII.

Neni 97

Kohëzgjatja e masave të kontrollit të sëmundjeve në zonën e mbrojtjes, ripopullimi i stabilimenteve që përfshihen në zonën e mbrojtur

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mban masat e kontrollit të sëmundjes në zonën e mbrojtur të parashikuar në seksionin 2 të këtij kreu deri kur:

a) masat në nenin 96 janë kryer dhe përfunduar; dhe

b) autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare bazuar në rezultatin e hetimeve të kryera në përputhje me nenin 88, ka përjashtuar çdo shfaqje të sëmundjes përkatëse të kategorisë A në stabilimentet e tjera brenda zonës së mbrojtjes.

2. Kur plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 1:

a) autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare zbaton masat e parashikuara në seksionin 3 të këtij kreu në zonën e mbrojtjes për periudhën kohore të përcaktuar në nenin 101; dhe

b) mund të ripopullohen stabilimentet e përmendura në pikat 1 dhe 2 të nenit 96 dhe të përfshira më parë në zonën e mbrojtjes.

Seksioni 3

Masat e kontrollit të sëmundjeve në zonën e mbikëqyrjes

Neni 98

Masat që zbatohen në stabilimentet në zonën e mbikëqyrjes

1. Në zonën e mbikëqyrjes, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron që masat e parashikuara në nenin 87 të zbatohen në të gjitha stabilimentet që mbajnë kafshë akuakulture të specieve të listuara.

2. Veterinerët zyrtarë vizitojnë stabilimentet e përmendura në pikën 1 dhe kryejnë aktivitetet e parashikuara në pikën 2, të nenit 88 sipas rastit.

3. Stabilimentet brenda zonës së mbikëqyrjes i nënshtrohen mbikëqyrjes që përfshin vizita dhe kampionime siç përshkruhet në pikën 1, të shtojcës XV.

4. Mbikëqyrja e parashikuar në pikën 3 kryhet nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare.

Neni 99

Masat në lidhje me lëvizjen dhe transportin e kafshëve të akuakulturës brenda, nga ose në zonën e mbikëqyrjes

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare ndalon çdo lëvizje të kafshëve të akuakulturës nga stabilimentet brenda zonës së mbikëqyrjes për therje, kultivim të mëtejshëm ose lëshim në natyrë jashtë zonës së mbikëqyrjes.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare siguron që çdo transport i kafshëve të akuakulturës të specieve të listuara brenda ose në zonën e mbikëqyrjes kryhet sipas kushteve të përcaktuara në shkronjën “a”, deri në shkronjën “d”, të nenit 90 dhe në nenin 91.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare urdhëron që të zbatohen masat e duhura plotësuese të biosigurisë për transportin, duke përfshirë shkarkimin në stabilimentin e caktuar të

destinacionit, në mënyrë që të kontrollohet dhe të parandalohet përhapja e mundshme e sëmundjeve.

4. Me përjashtim të pikës 1, dhe në marrëveshje me autoritetin kompetent të kontrolleve zyrtare të vendit të destinacionit, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare autorizon lëvizjet e kafshëve të akuakulturës me kusht që të zbatohen masat e duhura të biosigurisë për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A.

Neni 100

Masat që zbatohen në bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, qendrat e depurifikimit, qendrat e shpërndarjes, pikat e kontrollit kufitar, stabilimentet e nënprodukteve të kafshëve jo për konsum njerëzor ose çdo vendndodhje tjetër e rëndësishme në zonën e mbikëqyrjes, duke përfshirë mjetet e transportit

1. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare në fushën e veterinarisë dhe sigurisë ushqimore sipas fushës së përgjegjësisë të urdhërojnë pa vonesë që masat e parashikuara në nenet 98 dhe 99, të zbatohen në bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, qendrat e depurifikimit, qendrat e shpërndarjes, pikat e kontrollit kufitar, stabilimentet e nënprodukteve të kafshëve jo për konsum njerëzor ose çdo vendndodhje tjetër të rëndësishme në zonat e mbikëqyrjes, duke përfshirë dhe mjetet e transportit.

2. Në vendndodhjet e përmendura në pikën 1, autoritetet kompetente të kontrolleve zyrtare mund të zbatojnë masa shtesë të përshtatura për situatën specifike për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së kategorisë A brenda dhe nga zona e mbikëqyrjes.

Neni 101

Kohëzgjatja e masave të kontrollit të sëmundjes në zonën e mbikëqyrjes

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare heq masat e kontrollit të sëmundjes të parashikuara në këtë seksion kur ka kaluar periudha e mbikëqyrjes, e përcaktuar në pikën 2, të shtojcës XV, për sëmundjen përkatëse të kategorisë A me rezultate të favorshme.

KREU III

MASAT E KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE NË KAFSHËT E EGRA UJORE

Neni 102

Masat në rast të një rasti të dyshuar të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët e egra ujore të specieve të listuara

Në rast të një dyshimi të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët e egra ujore të specieve të listuara autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare:

a) kryen menjëherë një hetim të kafshëve të egra ujore të specieve të listuara të peshkuara, të kapura, të mbledhura ose të gjetura të ngordhura, për të konfirmuar ose përjashtuar praninë e sëmundjes së kategorisë A, në përputhje me pikën 2, të nenit 71;

b) siguron që të gjitha nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor të marra nga kafshët e egra ujore të specieve të listuara të dyshuara për infektim, duke përfshirë guaskat e molusqeve me mish, të përpunohen ose asgjësohen si materiale të kategorisë 1 ose kategorisë 2 në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor;

c) siguron që, aty ku është e mundur, çdo material ose substancë që mund të kontaminohet nga kafshët, që dyshohet se janë të prekura ose nga nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor të marra nga ato kafshë, t'i nënshtrohen pastrimit dhe dezinfektimit ose të asgjësohen duke ndjekur udhëzimet dhe nën mbikëqyrjen e veterinerëve zyrtarë; dhe

ç) siguron informacionin përkatës për operatorët ose autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e popullatës përkatëse të kafshëve.

Neni 103

Masat në rast të një shpërthimi të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët e egra ujore të specieve të listuara

1. Në rast të një rasti të konfirmuar zyrtarisht të sëmundjes së kategorisë A në kafshët e egra ujore të specieve të listuara, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare përcakton një zonë të infektuar në bazë të:

- a) kushteve përkatëse hidrodinamike, topografike dhe epidemiologjike
- b) profilin e sëmundjes dhe popullatën e vlerësuar të kafshëve ujore të specieve të listuara; dhe
- c) faktorët e riskut që kontribuojnë në përhapjen e sëmundjes përkatëse të kategorisë A, veçanërisht ato që lidhen me rrezikun e hyrjes së sëmundjes në stabilimentet që mbajnë kafshë ujore të specieve të listuara.

2. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare përshtat kufijtë e zonës fillestare të infektuar:

- a) për të kontrolluar përhapjen e mëtejshme të sëmundjes përkatëse të kategorisë A; dhe
- b) në rastin e konfirmimit të shpërthimeve të mëtejshme të sëmundjes së kategorisë A te kafshët e egra.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare informon menjëherë operatorët, autoritetet e tjera kompetente përkatëse, veterinerët përkatës dhe çdo person tjetër fizik ose juridik të interesuar për shpërthimin e sëmundjeve dhe masat e marra të kontrollit.

Neni 104

Masat që zbatohen në zonën e infektuar

1. Në zonën e infektuar të krijuar në përputhje me nenin 103, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare:

a) vendos masa për zbutjen e riskut dhe masa të përforuara të biosigurisë, me qëllim që të parandalojë përhapjen e sëmundjes së kategorisë A, nga kafshët e prekura dhe zona e infektuar në kafshë dhe në zona të paprekura;

b) ndalon çdo lëvizje nga njerëzit të kafshëve të egra ujore të specieve të listuara dhe produkteve me origjinë shtazore të marra nga ato kafshë nga zona e infektuar;

c) siguron që të përpunohen të gjitha nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor të marra nga kafshët e egra ujore të specieve të listuara në zonën e infektuar, duke përfshirë guaskat e molusqeve me mish, ose të asgjësohen si material i kategorisë 1 ose kategorisë 2 në përputhje me atë rregullore me përjashtim të kafshëve ujore dhe pjesëve të kafshëve të tilla, përveç gjitarëve të detit, të cilat nuk kanë shfaqur shenja të sëmundjes ngjitëse te njerëzit ose te kafshët;

ç) siguron, aty ku është e mundur, që çdo material ose substancë që ka të ngjarë të kontaminohet nga kafshët e egra ujore të specieve të listuara në zonën e infektuar ose nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor të marra nga ato kafshë t'i nënshtrohen pastrimit dhe dezinfektimit ose të asgjësohen duke ndjekur udhëzimet dhe të jenë nën mbikëqyrjen e veterinerëve zyrtarë; dhe

d) ndalon hyrjen në stabilimentet të kafshëve të akuakulturës të specieve të, brenda dhe jashtë zonës së infektuar ose në ujëmbledhësin ose zonat bregdetare jashtë zonës së infektuar të çdo pjesë të kafshëve ujore të specieve të listuara, qoftë të peshkuara, të kapura, të mbledhura ose të gjetura të ngordhura në zonën e infektuar si dhe çdo produkt, material ose substancë që ka të ngjarë të jetë e kontaminuar me një sëmundje të kategorisë A në zonën e infektuar.

2. Me përjashtim të pikës 1, të shkronjës b, dhe me qëllim të ruajtjes së materialit të vlefshëm gjenetik, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të autorizojë lëvizjet e kafshëve të egra

ujore të specieve të listuara nga zona e infektuar në një stabiliment të autorizuar nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare për këtë qëllim, me kusht që të zbatohen masat e duhura të biosigurisë për parandalimin e përhapjes së sëmundjes së kategorisë A. Stabilimenti i destinacionit konsiderohet si një stabiliment i vendosur në zonën e infektuar për qëllimet e nenit 108.

Neni 105

Masat shitesë që zbatohen në zonën e infektuar

1. Pas kryerjes së vlerësimit të rrezikut, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare përcakton masat shitesë të nevojshme për të kontrolluar ose çrrënjësuar sëmundjen përkatëse të kategorisë A.

2. Si pjesë e kontrollit ose çrrënjësjes së sëmundjes përkatëse të kategorisë A, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund:

- a) të pezullojë aktivitetet e rifurnizimit, peshkimit, mbledhjes/grumbullimit dhe kapjes;
- b) urdhërojnë pastrimin dhe dezinfektimin e detyrueshëm të pajisjeve dhe anijeve të peshkimit dhe të pajisjeve të tjera që mund të jenë të kontaminuara; dhe
- c) rrisë aktivitetet e peshkimit, mbledhjes/grumbullimit dhe kapjes ose zbaton masa të tjera përkatëse për çrrënjësjen e sëmundjes.

3. Masat e parashikuara në pikën 1 zbatohen pas konsultimeve dhe në bashkëpunim me grupin operacional të ekspertëve të përmendur në nenin 107, autoritetet dhe palët e tjera të interesit.

Neni 106

Zgjerimi i masave

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare vendos që masat përkatëse në nenin 102 deri në nenin 105 të zbatohen edhe për kafshët ujore të specieve të palistuara.

Neni 107

Grupi operacional i ekspertëve

1. Në rast të një rasti të konfirmuar të një sëmundjeje të kategorisë A në kafshët e egra ujore të specieve të listuara, autoriteti kompetent të krijojë një grup ekspertësh operacionalë siç përcaktohet në germaat “iii”, të shkronjës “”, të pikës 2, të nenit 43, të ligjit nr. 41/2025.

2. Grupi operacional i ekspertëve ndihmon autoritetin kompetent në:

- a) vlerësimin e situatës epidemiologjike dhe evolucionit të saj;
- b) përcaktimin e zonës së infektuar; dhe
- c) përcaktimin e masave të duhura që zbatohen në zonën e infektuar dhe kohëzgjatjen e tyre.

Neni 108

Masat në stabilimentet brenda zonës së infektuar

1. Në stabilimentet që mbajnë kafshë akuakulture të specieve të listuara brenda zonës së infektuar, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare zbaton masat e parashikuara në nenin 87.

2. Përveç masave të parashikuara në nenin 87, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare ndalon lëvizjen e kafshëve të akuakulturës që mbahen në stabilimentet brenda zonës së infektuar:

- a) jashtë zonës së infektuar; ose
- b) në stabilimentet e tjera në zonën e infektuar.

3. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, pas kryerjes së një vlerësimi risku, kufizon ndalimin në pikën 2 të këtij neni për kafshët e akuakulturës të specieve të listuara.

4. Me përjashtim të pikës 2, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të autorizojë lëvizjen e kafshëve të specieve të listuara jashtë zonës së infektuar ose në stabilimente të tjera në

zonën e infektuar, pas kryerjes së një vlerësimi risku dhe në marrëveshje me autoritetin kompetent të kontrolleve zyrtare të vendit të destinacionit.

Neni 109

Kohëzgjatja e masave në zonën e infektuar

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mban në fuqi masat e parashikuara në këtë kre, derisa informacioni epidemiologjik të tregojë se popullata përkatëse e egër nuk paraqet më rrezik për përhapjen e sëmundjes dhe grupi operacional rekomandon heqjen e masave.

KREU IV

MASAT E KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE PËR SËMUNDJET E KATEGORISË B DHE C, TË KAFSHËVE UJORE

Neni 110

Masat paraprake të kontrollit të sëmundjes që duhen zbatuar kur një sëmundje e kategorisë B ose C dyshohet nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare, në zona ose kompartament që u është dhënë statusi i pastër nga sëmundja

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare zbaton masat e përcaktuara, në vend ose zona ose kompartamente që u është dhënë statusi i pastër nga sëmundja, siç parashikohet në pikën 4, të nenit 36 dhe pikën 4, të nenit 37, të ligjit nr. 41/2025 dhe akteve nënligjore në këtë fushë.

Neni 111

Masat e kontrollit të sëmundjeve zbatohen kur konfirmohet një sëmundje e kategorisë B ose C

Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare zbaton masat e përcaktuara në rast të konfirmimit të një sëmundjeje të kategorisë B ose C në vend, ose në zona, ose kompartament që u është dhënë statusi pa sëmundje, siç parashikohet në pikën 4, të nenit 36 dhe pikën 4, të nenit 37, të ligjit nr. 41/2025 dhe akteve nënligjore në këtë fushë.

SHTOJCA I

EKZAMINIMET KLINIKE, PROCEDURAT E MARRJES SË MOSTRAVE, METODAT DIAGNOSTIKE TË SËMUNDJEVE TË KATEGORISË A DHE TRANSPORTI I MOSTRAVE

(siç përmendet në nenin 3 të kësaj rregulloreje)

A. Procedurat e kampionimit

A.1 MARRJA E MOSTRAVE TË KAFSHËT PËR EKZAMINIMET KLINIKE

1. Ekzaminimet klinike përfshijnë:

- a) kafshët që tregojnë shenja klinike të sëmundjeve të kategorisë A;
- b) kafshët që mund të kenë ngordhur së fundmi nga sëmundja e dyshuar/konfirmuar;
- c) kafshët me lidhje epidemiologjike me një rast të dyshuar ose të konfirmuar; dhe
- ç) kafshët që kanë marrë rezultate pozitive ose jo përfundimtare në ekzaminimet e mëparshme laboratorike.

2. Kafshët që ekzaminohen zgjidhen në mënyrë të rastësishme, në një numër të mjaftueshëm të madh që lejon zbulimin e sëmundjes, nëse është e pranishme, aty ku nuk ka shenja të dukshme të sëmundjes ose lezione pas vdekjes që sugjerojnë sëmundje të kategorisë A.

3. Kafshët që ekzaminohen dhe metoda e marrjes së mostrave zgjidhen në përputhje me udhëzimet e autoritetit kompetent dhe me planin përkatës të kontigjencës siç përcaktohet në

nenin 43 të ligjit nr. 41/2025. Në kafshët që ekzaminohen dhe metodat e marrjes së mostrave merret parasysh profili i sëmundjes dhe:

- a) qëllimin e marrjes së mostrës;
- b) speciet e listuara të mbajtura në stabiliment;
- c) numrin e kafshëve të specieve të listuara që mbahen në stabiliment;
- ç) kategorinë e kafshëve të mbajtura;
- d) të dhënat e disponueshme të prodhimit, shëndetit dhe gjurmueshmërisë së kafshëve të mbajtura relevante për hetimin;
- dh) llojin e stabilimentit dhe praktikën e blegtorale;
- e) nivelin e riskut të ekspozimit;
- ë) gjasat e ekspozimit ndaj agjentit të sëmundjes ose ndaj vektorit;
- f) mungesa e imunizimit të kafshëve për shkak të vaksinimit ose imunitetit të nënës; dhe
- g) historia e qëndrimit në stabiliment;
- gj) faktorë të tjerë përkatës epidemiologjikë.

4. Numri minimal i kafshëve për t'u ekzaminuar është në përputhje me udhëzimet e autoritetit kompetent dhe me planin përkatës të kontigjencës siç përcaktohet në nenin 43 të ligjit nr. 41/2025. Në përcaktimin e numrit minimal të kafshëve për t'u ekzaminuar, duhen marrë parasysh profili i sëmundjes dhe në veçanti:

- a) prevalenca e pritshme në stabiliment;
- b) niveli i besimit të dëshiruar për rezultatet e anketës, i cili në çdo rast nuk duhet të jetë më i ulët se 95%; dhe
- c) standardet ndërkombëtare dhe provat shkencore të disponueshme.

A.2 MOSTRA TË KAFSHËVE PËR EKZAMINIMET LABORATORIKE

1. Në marrjen e mostrave për ekzaminimet laboratorike merret parasysh rezultati e ekzaminimeve klinike të përmendura në pikën A.1 dhe kafshët e përmendura në paragrafin 1 të pikës A.1.

2. Nëse nuk ka shenja të dukshme të sëmundjes ose leziona pas ngordhjes që sugjerojnë sëmundje të kategorisë A, mostrat mbledhen në mënyrë të rastësishme në çdo njësi epidemiologjike të stabilimentit që të lejohet zbulimi i sëmundjes, nëse është i pranishëm.

3. Në kafshët nga të cilat merren mostrat, natyra e mostrave për t'u mbledhur dhe metoda e marrjes së mostrave janë në përputhje me udhëzimet e autoritetit kompetent dhe me planin përkatës të kontigjencës siç përcaktohet në nenin 43 të ligjit nr. 41/2025. Në kafshët nga të cilat merren mostrat, natyra e mostrave për t'u mbledhur dhe metoda e marrjes së mostrave merret parasysh profili i sëmundjes dhe kriteret e përcaktuara në paragrafin 3 të pikës A.1.

4. Numri minimal i kafshëve për mostër të jetë në përputhje me udhëzimet e autoritetit kompetent dhe planin përkatës të kontigjencës siç përcaktohet në nenin 43 të ligjit nr. 41/2025. Në numrin minimal të kafshëve për mostër duhen marrë parasysh kriteret e përcaktuara në paragrafin 4 të pikës A.1 dhe performanca e testeve të përdorura.

5. Në rastin e kafshëve të egra, mostrat mbledhen nga kafshët e gjuajtura, të gjetura të ngordhura ose të zëna në kurth qëllimisht ose merren në bazë të metodave joinvazive si përdorimi i kriporeve dhe litarët e përtpjes ose karremat. Në numrin minimal dhe natyrën e mostrave merret parasysh madhësia e vlerësuar e popullatës së egër dhe kriteret përkatëse të përcaktuara në paragrafët 3 dhe 4 të pikës A.1.

A.3 MARRJA E MOSTRAVE NË STABILIMENTET PËR VIZITA

1. Zgjedhja e stabilimenteve për marrjen e mostrës dhe metoda e marrjes së mostrave të jenë në përputhje me udhëzimet e autoritetit kompetent dhe me planin përkatës të kontigjencës siç përcaktohet në nenin 43 të ligjit nr. 41/2025. Zgjedhja e stabilimenteve për marrjen e mostrës dhe metoda e kampionimit merret parasysh profilin e sëmundjes dhe kriteret e përcaktuara në pikën 3 të pikës A1.

2. Numri minimal i stabilimenteve për t'u vizituar të jetë në përputhje me udhëzimet e autoritetit kompetent dhe me planin përkatës të kontigjencës siç përcaktohet në nenin 43 të ligjit nr. 41/2025.

B. Metodat diagnostike

Teknikat, materialet e referencës, standardizimi i tyre dhe interpretimi i rezultateve të testeve të kryera duke përdorur metodat përkatëse diagnostikuese për sëmundjet e kategorisë A.

Metodologjia diagnostike synon të maksimizojë ndjeshmërinë e mbikëqyrjes. Në rrethana të caktuara, kjo mbikëqyrje përfshin përdorimin e ekzaminimeve laboratorike për të vlerësuar ekspozimin e mëparshëm ndaj sëmundjes.

C. Transporti i mostrave

1. Të gjitha mostrat e marra për të konfirmuar ose përjashtuar praninë e një sëmundjeje të kategorisë A dërgohen, me një etiketim dhe identifikim të duhur, në një laborator zyrtar i cili është informuar për mbërritjen e tyre. Këto mostra shoqërohen me formularët përkatës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara dhe laboratorit që merr mostrat. Këto formularë përfshijnë të paktën:

- a) përcaktimin e origjinës së kafshëve të kampionuara;
- b) informacion mbi speciet, moshën dhe kategorinë e kafshëve të kampionuara;
- c) historinë klinike të kafshëve, nëse është e disponueshme dhe e rëndësishme;
- ç) shenjat klinike dhe gjetjet postmortem; dhe
- d) çdo informacion tjetër përkatës.

2. Të gjitha mostrat të jenë:

a) të ruajtura në kontejnerë dhe paketa të papërshkueshme nga uji dhe të pathyeshme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të zbatueshme;

b) mbajtur në temperaturën më të përshtatshme dhe kushte të tjera gjatë transportit duke marrë parasysh faktorët që të ndikojnë në cilësinë e kampionit.

3. Pjesa e jashtme e paketimit të jetë e etiketuar me adresën e laboratorit marrës dhe mesazhi i mëposhtëm të shfaqet në mënyrë të dukshme: *“Materiali patologjik i kafshëve; i dëmtueshëm; i brishtë; mos e hapni jashtë laboratorit të destinacionit”*.

4. Personi përgjegjës në laboratorin zyrtar që merr mostrat, të informohet në kohën e duhur për mbërritjen e mostrave.

SHTOJCA II

PERIUDHA E MONITORIMIT

(siç është referuar në nenet 8, 17, 27, 32, 48, 57 dhe 59 të kësaj rregulloreje)

Sëmundjet e kategorisë A	Periudha e monitorimit
Afta Epizotike (FMD)	21 ditë
Sëmundja e Rinderpestit (RP)	21 ditë
Sëmundja e Luginës Rift (RVFV)	30 ditë
Sëmundja e Dermatozës nodulare (LSD)	28 ditë
Pleurpneuonia kontagioze e gjedhit (<i>Mycoplasma mycoides subsp. Mycoides</i>) (CBPP)	45 ditë
Lija e dhenve dhe e dhive (SPGP)	21 ditë
Murtaja e Ruminantëve të vegjël (PPR)	21 ditë
Pleuropneumonia kontagioze e dhenve (CCPP)	45 ditë
Sëmundja afrikane e kuajve (AHS)	14 ditë
Morva (<i>Burkholderia mallei</i>) (Glanders)	6 muaj
Murtaja klasike e derrave (CSF)	15 ditë
Murtaja afrikane e derrave (ASF)	15 ditë
Influenca aviare me patogjenitet të lartë (HPAI)	21 ditë
Sëmundja e pseudopestit (NCD)	21 ditë

SHTOJCA III

KUSHTET PËR DISA PËRJASHTIME TË SHKRONJËS “A” TË PIKËS 1 TË NENIT 12 NË KAFSHËT E FAMILJES SË KUAJVE (si është referuar në pikën 4, të nenit 13)

1. Në rast të një shpërthimi të sëmundjes së murtajës afrikane të kuajve, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare bën përjashtime nga shkronja “a” e pikës 1 të nenit 12 për kafshët e prekura dhe të paprekura, me kusht që:

a) Kafshët e prekura, të cilat janë subjekt i përjashtimit janë izoluar në ambiente të mbrojtura nga vektorët që shmangin çdo transmetim të agentit të sëmundjes nga kafshët në vektorët përkatës deri në 40 ditë, që korrespondon me periudhën infektive në pjesën përkatëse të Kreut të Kodit të Shëndetit të Kafshëve Tokësore të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve (WOAH), kanë kaluar që nga hyrja e kafshëve në ambientet e mbrojtura nga vektorët; dhe

b) mbikëqyrja, duke përfshirë nëse është e nevojshme ekzaminimet laboratorike, të kryera nga autoriteti kompetent, tregojnë se asnjë nga kafshët në ambientet e mbrojtura nga vektori nuk paraqet rrezik të transmetit të virusit.

2. Në rast të një shpërthimi të infeksionit me sëmundjen e Morva (*Burkholderia mallei* Glanders) autoriteti kompetent bën përjashtime nga germa “a” e pikës 1 të nenit 12 kafshët e paprekura, me kusht që kafshët që i nënshtrohen përjashtimit të karantinohen deri kur:

a) kafshët e prekura janë eliminuar dhe asgjësuar;

b) pas eliminimit është kryer pastrimi dhe dezinfektimi i stabilimentit siç përcaktohet në nenin 15; dhe

c) kafshët e mbetura i janë nënshtuar një testi të fiksimit të komplementit i cili ka rezultuar negativ në një hollim serumi prej 1:5 në mostrat e marra 6 muaj pasi është kryer pastrimi dhe dezinfektimi siç përcaktohet në shkronjën “b” të kësaj pike.

SHTOJCA IV

PROCEDURAT PËR PASTRIMIN, DEZINFEKTIMIN DHE KUR ËSHTË E
NEVOJSHME KONTROLLIN NDAJ INSEKTEVE DHE BREJTËSVE
(siç është referuar në nenet 12, 15, 16, 39, 45 dhe 57 e kësaj rregulloreje)

A. Kërkesat e përgjithshme

1. Në zgjedhjen e produkteve biocide dhe procedurave për pastrimin dhe dezinfektimin merret parasysh:

- a) agjenti i cili ka shkaktuar infeksionin;
- b) natyrën e stabilimenteve, automjeteve, stabilimenteve dhe materialeve që trajtohen; dhe
- c) legjislacionin në fuqi.

2. Kushtet në të cilat përdoren produktet biocide sigurojnë që efikasiteti i tyre të mos dëmtohet. Në veçanti respektohen parametrat teknikë të ofruar nga prodhuesi, si presioni, temperatura, koha e kërkuar e kontaktit ose e ruajtjes.. Aktiviteti i dezinfektuesit nuk duhet të cenohet nga ndërveprimi me substanca të tjera.

3. Shmanget ndotja përsëri e pjesëve të pastruara më parë, veçanërisht kur larja kryhet me lëngje të aplikuara nën presion.

4. Uji i përdorur për procedurat e pastrimit mbledhet dhe të asgjësohet në mënyrë që të shmanget çdo lloj rreziku i përhapjes së agjentëve të sëmundjeve të kategorisë A.

5. Produktet biocide përdoren në mënyrë që të reduktohet sa më shumë që të jetë e mundur ndikimi negativ në mjedis dhe në shëndetin publik, që lindin nga përdorimi i tyre.

B. Pastrimi dhe dezinfektimi paraprak

Për pastrimin dhe dezinfektimin paraprak sipas nenit 15, me qëllim për të shmangur përhapjen e sëmundjeve të kategorisë A:

a) kadavrat ose pjesët e kafshëve të mbajtura, të ngordhura të specieve të listuara spërkatën me dezinfektues dhe të largohen nga stabilimenti me anë të automjeteve specifike ose kontejnerëve të mbyllur hermetikisht dhe rezistent ndaj rrjedhjeve, për t'u përpunuar dhe asgjësuar;

b) çdo ind ose gjak që ka dalë ose rrjedhur gjatë procesit të eliminimit, therjes ose ekzaminimit postmortem mbledhet dhe asgjësohet me kujdes;

c) sapo kadavrat ose pjesët e kadvrave të kafshëve të mbajtura të specieve të listuara janë larguar për përpunim ose asgjësim, pjesët e stabilimentit në të cilat janë mbajtur këto kafshë dhe çdo pjesë të tjera të ambientit, sipërfaqe ose pajisje të kontaminuara gjatë procesit të eliminimit ose ekzaminimit postmortem spërkatën me dezinfektues;

ç) plehu, duke përfshirë shtratin/shtrojën e përdorur dhe materiali përbërës i shtratit/shtrojës së përdorur, spërkatet tërësisht me dezinfektues;

d) dezinfektuesi i përdorur qëndron në sipërfaqe për të paktën 24 orë;

dh) pajisjet, kontejnerët, enët e konsumit, sipërfaqet ose çdo material që kontaminohet pas larjes dhe dezinfektimit, shkatërrohet.

C. Pastrimi dhe dezinfektimi përfundimtar:

Sipas nenit 57, për pastrimin dhe dezinfektimin përfundimtar:

1. Plehrat, duke përfshirë mbeturinat dhe shtrojën e përdorur, hiqen dhe trajtohen si më poshtë:

a) faza e ngurtë e plehut organik, duke përfshirë mbetjet dhe shtrojën e përdorur:

i. i nënshtrohen trajtimit me avull në temperaturën 70 °C minimalisht; ose

ii. asgjësohen me djegie/incenerim;

iii. groposet thellë mjaftueshëm në mënyrë që të parandalojë aksesin nga kafshët; ose

iv. grumbullohen për t'u ngrohur, të spërkatën me dezinfektues dhe të lihen për të paktën 42 ditë, gjatë së cilës grumbulli është i mbuluar ose të rigrumbullohet për të siguruar trajtim termik të gjitha shtresave;

b) faza e lëngshme e plehut organik ruhet për të paktën 42 ditë, ose 60 ditë në rastin e influencës aviare me patogjenitet të lartë, pas shtimit të fundit me material infektiv.

2. Stabilimentet, sipërfaqet dhe pajisjet lahen dhe pastrohen tërësisht duke hequr yndyrat ose papastërtitë e mbetura dhe të spërkaten me dezinfektues.

3. Pas 7 ditësh stabilimenti pastrohet dhe të dezinfektohet përsëri.

SHTOJCA V
RREZJA MINIMALE E ZONAVE TË MBROJTJES DHE MBIKËQYRJES
(siç është referuar në nenin 21 kësaj rregulloreje)

Të caktuara duke marrë si qendër të zonës, stabilimentin

Sëmundjet e kategorisë A	Zona e mbrojtjes	Zona e mbikëqyrjes
Afta epizotike (FMD)	3 km	10 km
Sëmundja e rinderpestit (RP)	3 km	10 km
Sëmundja e luginës Rift (RVFV)	20 km	50 km
Sëmundja e dermatozës nodulare (LSD)	20 km	50 km
Pleurpneuonia kontagioze e gjedhit (<i>Mycoplasma mycoides subsp. Mycoides</i>) (CBPP)	Stabilimenti	3 km
Lija e dhenve dhe e dhive (SPGP)	3 km	10 km
Murtaja e ruminantëve të vegjël (PPR)	3 km	10 km
Pleuropneumonia kontagioze e dhenve (CCPP)	Stabilimenti	3 km
Sëmundja afrikane e kuajve (AHS)	100 km	150 km
Morva (<i>Burkholderia mallei</i>) (Glanders)	Stabilimenti	Stabilimenti
Murtaja klasike e derrave (CSF)	3 km	10 km
Murtaja afrikane e derrave (ASF)	3 km	10 km
Influenca aviare me patogjenitet të lartë (HPAI)	3 km	10 km
Sëmundja e pseudopestit (NCD)	3 km	10 km

SHTOJCA VI
NDALIMET NË ZONËN E KUFIZUAR
(siç është referuar në nenin 27 të kësaj rregulloreje)

Tabela. Ndalimet e aktiviteteve në lidhje me kafshët e specieve të listuara dhe produkteve që rrjedhin nga ato kafshë

NDALIMET E VEPRIMEVE LIDHUR ME KAFSHËT DHE PRODUKTET SIPAS SËMUNDJEVE TË KATEGORINSË A (1)	FMD	RP	RVFV	LSD	CBPP	SPGP	PPR	CCPP	CSF	ASF	AHS	GLAND	HPAI	NCD
Lëvizjet e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara nga stabilimentet që ndodhen në zonën e kufizuar	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	NA	X	X
Lëvizjet e kafshëve të mbajtura të specieve të listuara në stabilimentet që ndodhen në zonën e kufizuar	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	NA	X	X
Ripopullimi i kafshëve të gjahut të specieve të listuara	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	NA	X	X
Panaire, tregje, shfaqje dhe grumbullime të tjera të kafshëve të mbajtura të specieve të listuara, duke përfshirë mbledhjen dhe shpërndarjen e atyre specieve	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	NA	X	X
Lëvizjet e spermës, ovociteve dhe embrioneve të marra nga kafshët e mbajtura të specieve të listuara nga stabilimentet në zonën e kufizuar	X	X	X	X (2)	X	X	X	X	X	X	X	NA	NA	NA
Mbledhja e spermës, ovociteve dhe embrioneve nga kafshët e mbajtura të specieve të listuara	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	NP	NA	NA	NA
Inseminim artificial ambulant i kafshëve të mbajtura të specieve të listuara.	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	NA	NA	NA
Shërbim natyror ambulant për kafshët e mbajtura të specieve të listuara	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	NA	NA	NA
Lëvizjet e vezëve të çeljes drejt dhe nga stabilimentet në zonën e kufizuar	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	X	X
Lëvizjet e mishit të freskët, duke përjashtuar të brendshmet e kafshëve të mbajtura dhe të egra të specieve të listuara nga thertoret ose stabilimentet e trajtimit të gjahut në zonën e kufizuar	X	X	X	NP	NP	X	X	NP	X	X	NP	NA	X	X

NDALIMET E VEPRIMEVE LIDHUR ME KAFSHËT DHE PRODUKTET SIPAS SËMUNDJEVE TË KATEGORISË A (1) (cont)	FMD	RP	RVFV	LSD	CBPP	SPGP	PPR	CCPP	CSF	ASF	AHS	GLAND	HPAI	NCD
Lëvizjet e të brendëshmeve nga kafshët e mbajtura dhe të egra të specieve e të listuara nga thertoret ose stabilimentet e trajtimit të gjahut në zonën e kufizuar	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	NP	NA	X	X
Lëvizjet e produkteve të mishit të marra nga mishi i freskët i specieve të listuara nga stabilimentet në zonën e kufizuar	X	X	X	NP	NP	NP	X	NP	X	X	NP	NA	X	X
Lëvizjet e qumështit të papërpunuar dhe kulloshtres të marra nga kafshët e mbajtura të specieve të listuara nga stabilimentet në zonën e kufizuar	X	X	X	X	NP	X	X	NP	NA	NA	NP	NA	NA	NA
Lëvizjet e produkteve të qumështit dhe produkteve me bazë kulloshtre nga stabilimentet në zonën e kufizuar	X	X	X	X	NP	X	X	NP	NA	NA	NP	NA	NA	NA
Lëvizjet e vezëve për konsum njerëzor nga stabilimentet në zonën e kufizuar	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	X	X
Lëvizjet e nënprodukteve shtazore jo për konsum njerëzor nga kafshët e mbajtura të specieve të listuara nga stabilimentet në zonën e kufizuar, me përjashtim të kadavrave ose pjesëve të kafshëve të ngordhura														
Pleh organik, duke përfshirë mbeturinat dhe shtratin e përdorur	X	X	X	X	X	NP	X	X	NP	X	X	NP	NA	X
Lëkurat, leshi, qimet dhe puplat	X	X	X	X	NP	X	X	NP	X	X	NP	NA	X	X
Nënprodukte shtazore jo për konsum njerëzor përveç plehut organik, duke përfshirë mbeturinat dhe shtratin e përdorur, dhe të tjera nga lëkura, lëkurat, leshi, qimet dhe puplat	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	NA	X	X

NDALIMET E AKTIVITETEVE LIDHUR ME KAFSHËT DHE PRODUKTET (vazhdim) SIPAS SËMUNDJEVE TË KATEGORISË A (1)	FMD	RP	RVFV	LSD	CBPP	SPGP	PPR	CCPP	CSF	ASF	AHS	GLAND	HPAI	NCD
Lëvizjet e lëndëve ushqimore me origjinë bimore dhe kashtës së përfutur në zonën e kufizuar	X	X	NP	NP	NP	NP	NP	NP	NP	NP	NP	NA	NP	NP

SHËNIME

(1) Shkurtesat për sëmundjet e kategorisë A në përputhje me Shtojcën II

(2) Vetëm ovocitet dhe embrioni

NA = Nuk zbatohet

X = ndalim

NP = Nuk ndalohet

SHTOJCA VII

TRAJTIMET QË ZVOGËLOJNË RREZIQET PËR PRODUKTET ME ORIGJINË SHTAZORE NGA ZONA E KUFIZUAR

(siç është referuar në nenin 27, 33 dhe 49 të kësaj rregulloreje)

Trajtimi	FMD ϕ	RP	RVFV	LSD	CBPP	SPGP	PPR	CCPP	CSF	ASF	AHS	HPAI	NCD
Mishi													
Trajtimi termik në një enë të mbyllur hermetikisht, për të arritur një minimum F_0 $\hat{}$ me vlerë 3	X						X		X	X		X	X
Trajtimi termik për të arritur një temperaturë bazë prej 80°C	X						X		X	X		X	X
Trajtimi termik për të arritur një temperaturë bazë prej 70°C	X						X		X			X	X
Trajtim termik (për mishin e hequr më parë nga kockat dhe yndyrën) për të arritur një temperaturë qendrore prej 70°C për një minimum prej 30 minutash	X						X		X	X			
Në një enë të mbyllur hermetikisht, duke aplikuar 60 °C për të paktën 4 orë	X						X		X	X			
Temperatura bazë prej 73,9°C për një minimum prej 0,51 sekondash $\hat{}$	X											X	X
Temperatura bazë prej 70,0°C për një minimum prej 3,5 sekondash $\hat{}$												X	X
Temperatura bazë prej 65,0°C për një minimum prej 42 sekondash $\hat{}$												X	X
Temperatura bazë prej 60°C për një minimum prej 507 sekondash $\hat{}$												X	X
Trajtimi termik për të arritur tharjen në vlerat maksimale të Aë prej 0,93 dhe pH prej 6													
Trajtimi termik për të arritur një temperaturë qendrore prej 65°C për një periudhë kohe për të arritur një vlerë minimale pasterizimi prej 40							X						
Fermentimi dhe maturimi natyral për mishin me kocka: minimalisht 9 muaj, për të arritur vlerat maksimale të Aë prej 0,93 dhe pH prej 6.	X								X				
Fermentimi dhe maturimi natyral për mishin pa kocka: minimalisht 9 muaj, për të arritur vlerat maksimale të Aë prej 0,93 dhe pH prej 6.	X								X	X			

[illegible]

Kriposja me klorur natriumi (NaCl) ose e thatë ose si shëllirë e ngopur ($A_w < 0,80$), për një periudhë të vazhdueshme prej 30 ditësh ose më gjatë në një temperaturë ambienti prej 20°C ose më lart	X						X		X	X			
Kriposja me kripë të plotësuar me fosfat 86,5 % NaCl, 10,7 % Na_2HPO_4 dhe 2,8 % Na_3PO_4 ose e thatë ose si shëllirë e ngopur ($A_w < 0,80$) për një periudhë të vazhdueshme prej 30 ditësh ose më gjatë në një temperaturë ambienti 20°C ose më lart	X						X		X	X			
Kriposja me klorur natriumi (NaCl) minimalisht 30 ditë ⁽⁶⁾													
Zbardhimi ⁽⁶⁾													
Tharje ⁽⁶⁾													

Trajtimi	FMD ⁽¹⁾	RP	RVFV	LSD	CBPP	SPGP	PPR	CCPP	CSF	ASF	AHS	HPAI	NCD
Qumësht													
Trajtimi termik (procesi i sterilizimit) për të arritur një vlerë minimale F_0 prej 3	X												
Trajtimi termik UHT (Temperatura ultra e lartë): Minimumi 132°C për një minimum prej 1 sekonde	X						X						
Trajtimi termik UHT (temperatura ultra e lartë): Minimumi 135°C për një kohë të përshtatshme mbajtjeje	X												
Trajtimi termik HTST (Pasterizimi me kohë të shkurtër në temperaturë të lartë) nëse pH i qumështit është më i ulët se 7, minimumi 72°C për një minimum prej 15 sekondash	X						X						
Trajtimi termik HTST (Pasterizimi me kohë të shkurtër në temperaturë të lartë) nëse pH i qumështit është 7 ose më i lartë, minimumi 72°C për një minimum prej 15 sekondash, aplikohet dy herë	X						X						
Trajtimi termik HTST (Pasterizimi me kohë të shkurtër në temperaturë të lartë) i kombinuar me një trajtim fizik për të arritur vlerën e pH nën 6 për një minimum prej 1 orë ose për të arritur një minimum prej 72°C, i kombinuar me tharje	X												
Pasterizimi që konsiston në një trajtim të vetëm termik me një efekt të paktën të barabartë me atë të arritur duke aplikuar 72°C për 15 sekonda	X		X	X		X							

⁽¹⁾ Shkurtesat e sëmundjeve në përputhje me shtojcën II.

⁽²⁾ F_0 është efekti vrasës i llogaritur në sporet bakteriale. Një vlerë F_0 prej 3 do të thotë që pika më e ftohtë në produkt është ngrohur mjaftueshëm për të arritur të njëjtin efekt vrasës si 121°C (250 °F) në 3 minuta me ngrohje dhe ftohje të menjëhershme.

⁽³⁾ Vetëm për mishin e shpendëve.

⁽⁴⁾ Vetëm për kafshët e derrit.

⁽⁵⁾ Mall i sigurt.

⁽⁶⁾ Jo për zorrët e gjedbit, deleve, dhive dhe derrit.

Trajtimi	HPAI	NCD
Vezë		
Trajtimi termik: — Vezë e plotë: — 60,0 °C – 188 sec. — E gatuar plotësisht — Përzierje vezësh të plota: — 60 °C – 188 sec. — E gatuar plotësisht — 61,1 °C – 94 sec. — E bardha e vezës e lëngëshme: — 55,6 °C – 870 sec. — 56,7 °C – 232 sec. — E verdha e vezës e pastër ose e thjeshtë: — 60 °C – 288 sec. — 10 % e verdhë e kriposur: — 62,2 °C – 138 sec. — E bardha e vezës e tharë: — 67 °C – 20 orë — 54,4 °C – 50,4 orë — 51,7 °C – 73,2 orë	X	
Trajtimi termik: — Veza e plotë: — 55 °C – 2 521 sec. — 57 °C – 1 596 sec. — 59 °C – 674 sec. — E gatuar plotësisht — E bardha e vezës e lëngëshme: — 55 °C – 2 278 sec. — 57 °C – 986 sec. — 59 °C – 301 sec. — 10 % e verdhë veze e kriposur: — 55 °C – 176 sec. — E bardhë veze e tharë: — 57 °C – 54,0 hours		X

SHTOJCA VIII
TRAJTIME PËR ZBUTJEN E RISKUT PËR PRODUKTET TË CILAT NUK JANË ME
ORIGINË SHTAZORE, TË CILAT VIJNË NGA ZONA E KUFIZUAR
(siç referohet në nenin 36 dhe 52 të kësaj rregullore)

Trajtimi	FMD (1)	RP
Trajtim termik, temperaturë minimale 80°C dhe për të paktën 10 minuta, avull në një dhomë të mbyllur	X	X
Ruajtja në paketë ose balona nën strehë në ambiente që ndodhen jo më afër se 2 km nga vatra më e afërt dhe nxjerrja nga ambientet nuk lejohet para se të kenë kaluar të paktën 3 muaj pas përfundimit të pastrimit dhe dezinfektimit sipas nenit 15.	X	X

(1) Shkurtesat e sëmundjeve në përputhje me shtojcën II.

SHTOJCA IX
SHËNJIMI I MISHIT TË FRESKËT NGA ZONA E MBROJTJES
(siç është referuar në nenet 33 dhe 49 të kësaj rregulloreje)

1. Shenja që vendoset për mishin e freskët të shpendëve me origjinë nga zona e mbrojtur dhe që nuk është i destinuar për një shtet tjetër sipas germës “b” të pikës 1 të nenit 33 të jetë në përputhje me sa vijon:

a) Forma dhe përmbajtja:

Ku “XY” nënkupton kodin përkatës të vendit dhe “1234” nënkupton numrin e miratimit të stabilimentit të përmendur të parashikuar në pikën 25 të pjesës A të kreut III “Kontrollet zyrtare të mishit dhe produkteve të mishit” të udhëzimit nr. 17 datë 24.9.2021 “Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike”.

b) Përmasat:

- ‘XY’ gjerësia 8 mm;
- ‘1234’ gjerësia 11 mm;
- gjerësia e diametrit të jashtëm jo më pak se 30 mm;
- trashësia e vijës së kuadratit 3 mm.

2. Shenja që vendoset mbi mishin e freskët të destinuar për trajtim në një fabrikë përpunimi sipas germës “a” të pikës 2 të nenit 33 konsistojë, në:

a) shenjën e identifikimit të parashikuar në udhëzimit nr. 17 datë 24.9.2021, “Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike” me një kryq diagonal shtesë që përbëhet nga dy vija të drejta që kryqëzohen në qendër të pullës dhe që mundësojnë që informacioni mbi të të mbetet i lexueshëm; ose

b) një vulë ovale, 6.5 cm e gjerë, 4.5 cm e lartë, në të cilën informacioni i mëposhtëm të jetë lehtësisht i lexueshëm:

- Në pjesën e sipërme, emri i plotë ose kodi I ISO me germa kapitale;
- Në qendër, numri i miratuar i thertores;
- Në pjesën e poshtme një nga inicialet që vijojnë CE, EC, EF, EG, EK, EY, EO, ES, EU, EB, EE ose EZ;
- Dy vija të drejta të cilat kryqëzohen në qendër në mënyrë të tillë që të mos pengojnë leximin e informacioneve të tjera;
- Shkronjat të jenë të paktën 0,8 cm të larta dhe figurat të paktën 1 cm të larta.

SHTOJCA X
KOHËZGJATJA E MASAVE NË ZONËN E MBROJTJES
(siç referohet në nenin 39 të kësaj rregulloreje)

Sëmundje të kategorisë A	Periudha minimale e kohëzgjatjes së masave në zonën e mbrojtjes (pika 1 e nenit 39)	Periudha shtesë e cila i shtohet kohëzgjatjes së masave të survejancës në zonën e mbrojtjes (pika 3 e nenit 39)
Afta epizotike	15 ditë	15 ditë
Sëmundja e rinderpestit (RP)	21 ditë	9 ditë
Sëmundja e luginës Rift (RVFV)	30 ditë	15 ditë
Sëmundja e dermatozës nodulare (LSD)	28 ditë	17 ditë
Pleurpneuonia kontagioze e gjedhit (<i>Mycoplasma mycoides subsp. Mycoides</i>) (CBPP)	45 ditë	Nuk aplikohet
Lija e dhenve dhe e dhive (SPGP)	21 ditë	9 ditë

Murtaja e ruminantëve të vegjël (PPR)	21 ditë	9 ditë
Pleuropneumonia kontagioze e dhenve (CCPP)	45 ditë	Nuk aplikohet
Sëmundja afrikane e kuajve (AHS)	12 muaj	Nuk aplikohet
Morva (<i>Burkholderia mallei</i>) (Glanders)	6 muaj	Nuk aplikohet
Murtaja klasike e derrave (CSF)	15 ditë	15 ditë
Murtaja afrikane e derrave (ASF)	15 ditë	15 ditë
Influenca aviare me patogjenitet të lartë (HPAI)	21 ditë	9 ditë
Sëmundja e pseudopestit (NCD)	21 ditë	9 ditë

SHTOJCA XI
KOHËZGJATJA E MASAVE NË ZONËN E MBIKËQYRJES
(siç referohet në nenet 55 dhe 56 të kësaj rregulloreje)

Sëmundje të kategorisë A	Periodha minimale e kohëzgjatjes së masave në zonën e mbikëqyrjes
Afta epizotike	30 ditë
Sëmundja e rinderpestit (RP)	30 ditë
Sëmundja e luginës Rift (RVFV)	45 ditë
Sëmundja e dermatozës nodulare (LSD)	45 ditë
Pleurpneumonia kontagioze e gjedhit (<i>Mycoplasma mycoides subsp. Mycoides</i>) (CBPP)	45 ditë
Lija e dhenve dhe e dhive (SPGP)	30 ditë
Murtaja e ruminantëve të vegjël (PPR)	30 ditë
Pleuropneumonia kontagioze e dhenve (CCPP)	45 ditë
Sëmundja afrikane e kuajve (AHS)	12 muaj
Morva (<i>Burkholderia mallei</i>) (Glanders)	Nuk aplikohet
Murtaja klasike e derrave (CSF)	30 ditë
Murtaja afrikane e derrave (ASF)	30 ditë
Influenca aviare me patogjenitet të lartë (HPAI)	30 ditë
Sëmundja e pseudopestit (NCD)	30 ditë

SHTOJCA XII
PROCEDURAT E MARRJES SË MOSTRAVE DHE METODAT E DIAGNOSTIKIMIT PËR SËMUNDJET E KATEGORISË A TË KAFSHËVE TË UJIT

1. Procedurat e mëposhtme zbatohen gjatë ekzaminimit klinik dhe mbledhjes së mostrave:
 - a) Ekzaminimi klinik dhe marrja e mostrave për analizimin laboratorik përfshin:
 - i. kafshë të akuakulturës të specieve të listuara të cilat kanë shfaqur shenja klinike të një sëmundjeje të kategorisë A; dhe
 - ii. kafshë të akuakulturës të cilat dyshohen ose janë konfirmuar që kanë ngordhur nga një sëmundje e kategorisë A; dhe
 - iii. kafshë të akuakulturës me ndërlidhje epidemiologjike me raste të dyshuara ose të konfirmuara të sëmundjes së kategorisë A.
 - b) Numri minimal i mostrave që merret është:

Lloji i kafshës	Raport i rritjes së mortalitetit	Hyrje e kafshëve të infektuara	Rasti	
			Shenja klinike ose postmortem të dalluara	Dyshim i bazuar në rrethana të tjera

Molusqe (kafshë e plotë)	30	30	—	150
Krustacë	10		10	150
Peshk	—	—	10	30

c) Kriteret shtesë të mëposhtme zbatohen për marrjen e mostrave të molusqeve:

i. kafshët që dyshohet se janë të infektuara zgjidhen për kampionim. Nëse speciet e listuara janë të pranishme në popullatën e kafshëve të përfshira nga dyshimi, ato zgjidhen për kampionim;

ii. nëse ka molusqe të hapura ose të sapo ngordhura, por jo të dekompozuar, ato zgjidhen të parat. Nëse molusqet e tilla nuk janë të pranishme, molusqet e përzgjedhura janë ato më të vjetra të shëndetshme;

iii. nëse stabilimenti përdor burime të ndryshme ujore për prodhimin e molusqeve, ato përfshihen patjetër në kampionim molusqet nga të gjitha llojet e burimeve ujore të pranishme, në mënyrë që të sigurohet një kampionim i të gjitha pjesëve të stabilimentit;

iv. gjatë marrjes së mostrave nga një grup stabilimentesh për kultivimin e molusqeve që në dukje kanë status të njëjtë epidemiologjik, në kampion përfshihen molusqet nga një numër përfaqësues i pikave të kampionimit.

Faktor kryesor që konsiderohet kur përzgjidhen pikat e kampionimit janë dendësia e stokut, rrymave të ujit, prania e specieve të listuara, specieve të ndjeshme dhe vektorët, batimetria dhe praktikat e menaxhimit. Në mostër përfshihen shtretër natyror brenda ose pranë vendit të stabilimentit të molusqeve;

ç) Kriteret shtesë të mëposhtme zbatohen për marrjen e mostrave të krustacëve:

i. nëse ka krustace të dobët ose të vdekur të specieve të listuara në njësitë e prodhimit, ata krustace të zgjidhen të parët. Nëse këto kafshë nuk janë të pranishme atëherë përfshihen krustace nga klasa të ndryshme vjetore, të përfaqësuara proporcionalisht në mostër;

ii. nëse përdoren më shumë se një burim uji për prodhimin e krustaceve, krustacet e specieve të listuara që përfaqësojnë të gjitha burimet e ujit, përfshihen në mostër për të siguruar që të gjitha pjesët e stabilimentit të prodhimit të jenë të përfaqësuara proporcionalisht në mostër;

iii. kur kërkohet mbledhja e mostrave nga popullatat e egra të specieve të listuara sipas gurmës “a” të nenit 102 të kësaj rregulloreje, numri dhe shpërndarja gjeografike e mostrave përcaktohen në një mënyrë që siguron një mbulim të arsyeshëm të zonës që dyshohet se është e infektuar.

Mostrat përfaqësojnë ekosistemet e ndryshme ku ndodhen popullatat e egra të specieve të ndjeshme, siç janë sistemet detare, grykëderdhjet, lumenjtë dhe liqenet;

d) Kriteret shtesë të mëposhtme zbatohen për marrjen e mostrave të peshqve:

i. nëse ka peshq të dobët, me sjellje jonormale ose të ngordhur së fundmi, por jo të dekompozuar, ata peshq zgjidhen. Nëse këto kafshë nuk janë të pranishme, atëherë përfshihen peshq të specieve të listuara, që i përkasin klasave të ndryshme vjetore, të përfaqësuara proporcionalisht në mostër;

ii. nëse përdoren më shumë se një burim uji për prodhimin e peshqve, speciet e listuara që përfaqësojnë të gjitha burimet e ujit përfshihen në mostër për të siguruar që të gjitha pjesët e stabilimentit të prodhimit të jenë të përfaqësuara proporcionalisht në mostër;

iii. nëse ka troftë ylberi (*Oncorhynchus mykiss*) ose peshk evropian (*Perca fluviatilis*), vetëm peshq të këtyre specieve zgjidhen për mostër. Nëse as trofta ylber dhe as peshku evropian nuk janë të pranishëm, mostra përfaqëson të gjitha speciet e tjera të listuara që janë të pranishme, duke ndjekur kriteret në pikat “a” deri në “ç”;

iv. kur kërkohet mbledhja e mostrave nga popullatat e egra të specieve të listuara sipas gurmës “a” të nenit 102 të kësaj rregulloreje, numri dhe shpërndarja gjeografike e mostrave përcaktohet në një mënyrë që siguron një mbulim të arsyeshëm të zonës që dyshohet se është e infektuar.

Mostrat të jenë gjithashtu përfaqësuese për ekosistemet e ndryshme ku ndodhen popullatat e egra të specieve të ndjeshme, siç janë sistemet detare, grykëderdhje, lumenjtë dhe liqenet;

dh) Zgjedhja e organeve që merren për mostër, përgatitja, ruajtja dhe dërgimi i mostrave në laborator bëhen në përputhje me rekomandimet nga laboratorit referencë i Bashkimit Evropian për sëmundjen përkatëse.

2. Mostrat të analizohen në laborator duke përdorur metodat dhe procedurat diagnostikuese të miratuara nga laboratorit i referencës brenda vendit dhe ai referencë i Bashkimit Evropian për sëmundjen përkatëse kur mostrat dërgohen jashtë vendit për analizim

SHTOJCA XIII PERIUDHA MINIMALE E PUSHIMIT PËR STABILIMENTET E PREKURA TË AKUAKULTURËS

Periudhat e pushimit/ siç janë të dhëna në nenin 81 dhe pushimi i sinkronizuar/ siç janë të dhëna në pikën 4 dhe 5 të nenit 96 të kësaj rregulloreje

Sëmundje të kategorisë A	Periudha minimale e pushimit/ për stabilimentet e prekura	Periudha minimale e pushimit/ për stabilimentet e prekura në të njëjtën zonë të mbrojtjes	Kërkesa shtesë
Mikrocitoza	6 muaj	4 javë	përfshin periudhën më të ftohtë të vitit
Infeksioni nga <i>Perkinsus marinus</i>	6 muaj	4 javë	përfshin periudhën më të ftohtë të vitit
Sindromi Taura	6 javë	4 javë	Përfshin periudhën më të ngrohtë të vitit
Sëmundja e kokës së verdhë	6 javë	3 javë	përfshin periudhën më të ngrohtë të vitit
Nekroza hematopoetike epizootike	8 javë	4 javë	përfshin periudhën më të ngrohtë të vitit

SHTOJCA XIV KRITERET PËR KRIJIMIN E ZONAVE TË KUFIZUARA LIDHUR ME KATEGORINË A TË SËMUNDJEVE NË KAFSHËT UJORE

1. Zonat e kufizuara përcaktohen rast pas rasti siç referohet në nenin 85 duke marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

a) numri i akumuluar, përqindja e akumuluar dhe shpërndarja e vdekjeve të molusqeve/ krustaceve/ peshqve në vendin e prodhimit ose grupin e vendeve të prodhimit të infektuar me sëmundje të kategorisë A;

b) informacion domethënës lidhur me lëvizjet drejt dhe nga stabilimenti i infektuar;

c) largësia dhe dendësia e stabilimenteve fqinje;

ç) prezenca e kafshëve të specieve të egra të ujit;

d) çdo njohuri lidhur me ngordhjet, rastet e dyshuara ose shpërthimet të kafshët të egra të ujit që janë, ose të jenë të lidhura me sëmundjen specifike të kategorisë A;

dh) afërsia me vendet e përpunimit, dhe speciet e pranishme në ato vende, veçanërisht sa u përket specieve të listuara;

e) praktikatat e kultivimit të zbatuara në stabilimentet e prekura fqinje;

ë) kushtet hidrodinamike dhe faktorë të tjerë të identifikuar me rendësi epidemiologjike.

2. Për demarkimin gjeografik të zonës së mbikëqyrjes dhe mbrojtjes për molusqet dhe krustacët të prekur nga një sëmundje e kategorisë A, zbatohen kushtet minimale të mëposhtme:

a) zona e mbrojtjes krijohet menjëhershme në afërsinë e një vendi ose grupi vendesh të prodhimit që janë konfirmuar zyrtarisht si të infektuar me një sëmundje të kategorisë A dhe përputhet me një zonë të përcaktuar sipas të dhënave të përshtatshme hidrodinamike dhe epidemiologjike;

b) zona e mbikëqyrjes krijohet jashtë zonës së mbrojtjes dhe përputhet me një zonë që rrethon zonën e mbrojtjes, e cila përcaktohet sipas të dhënave të përshtatshme hidrodinamike ose epidemiologjike.

3. Për përcaktimin gjeografik të zonave të mbrojtjes dhe mbikëqyrjes për sëmundjet e kategorisë A që prekin peshqit, zbatohen kërkesat minimale si vijon:

a) Zona e mbrojtjes caktohet rreth stabilimentit ku është konfirmuar sëmundja e nekrozës hematopoetike epizootike. Kjo zonë korrespondon:

i. në zonat bregdetare: në një zonë të përfshirë brenda një rrethi me rreze të paktën sa një lëvizje e plotë e baticës ose të paktën 5 kilometra, sipas asaj që është më e madhe, me qendër në njësinë (fermë, impiant etj.) ku nekroza hematopoetike epizootike është konfirmuar zyrtarisht, ose në një zonë të barasvlershme të përcaktuar në bazë të të dhënave hidrodinamike ose epidemiologjike të përshtatshme;

ii. në zonat taksore të brendshme: tek e gjithë zona e kapjes së ujit të vendit të prodhimit ku është konfirmuar zyrtarisht sëmundja e nekrozës hematopoetike epizootike. Autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare kufizon zgjerimin e zonës në pjesë të zonës së kapjes së ujit, ose në zonën e vendit të prodhimit, me kusht që kjo të mos dëmtojë parandalimin e përhapjes së sëmundjes;

b) Zona e mbikëqyrjes caktohet nga autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare jashtë zonës së mbrojtjes dhe:

i. në zonat bregdetare: t'i përkasë një zone, që rrethon zonën e mbrojtjes, e cila përfshin lëvizjet bregdetare që mbivendosen; ose një zonë, që rrethon zonën e mbrojtjes, dhe që përfshihet në një rreth me rreze 10 km nga qendra e zonës së mbrojtjes; ose një zonë ekuivalente e përcaktuar sipas të dhënave hidrodinamike ose epidemiologjike të përshtatshme;

ii. në zonat tokësore të brendshme: Të jetë një zonë e shtuar jashtë zonës së caktuar të mbrojtjes.

SHTOJCA XV

SKEMAT E MBIKËQYRJES DHE KOHËZGJATJA E MASAVE TË KONTROLLIT NË ZONËN E MBIKËQYRJES PËR KAFSHËT E AKUAKULTURËS PËR SËMUNDJET E KATEGORISË A

(siç referohet në nenet 98 dhe 101 e kësaj rregulloreje)

1. Skema e mbikëqyrjes

Vendet dhe grupet e vendeve të akuakulturës që mbajnë specie të listuara brenda një zone mbikëqyrjeje i nënshtrohen mbikëqyrjes siç parashikohet në nenin 98 për të kontrolluar për praninë e infeksionit me sëmundjen përkatëse të kategorisë A. Mbikëqyrja përfshin vizita shëndetësore, përfshirë marrjen e mostrave nga njësitë e prodhimit. Këto vizita kryhen nga autoriteti kompetent në përputhje me tabelat 1 dhe 2.

Kriteret e përcaktuara në pikën 1 të shtojcës XII, zbatohen për marrjen e mostrave, siç është e përshtatshme për specie.

Tabela 1. Skema për mbikëqyrjen duke përfshirë vizitat shëndetësore dhe marrjen e mostrave në stabilimente dhe grupet e stabilimenteve për kafshët e akuakulturës të prekshme nga sëmundjet e kategorisë A, përveç nekrozës hematopoetike enzootike

Sëmundjet e kategorisë A	Numri i vizitave shëndetësore në vit	Numri i analizimeve laboratorike në vit	Numri i kafshëve në mostër	Periudha e vitit për marrjen e mostrave	Periudha e rezidencës së kafshës së kampionuar në stabiliment
Infeksioni me <i>Mikrocytos mackini</i> (Mikrocitoza)	1	1	150	Kur prevalenca e infeksionit dihet që është më e larta ose Prill-Maj, pas periudhës 3–4 mujore kur temperaturat e ujit të detit janë më pak se 10 °C	4 muaj
Infeksioni me <i>Perkinsus marinus</i>	1	1	150	Kur prevalenca e infeksionit dihet që është më e larta ose në muajin Shtator, Tetor ose Nëntor	4 muaj
Infeksioni me virusin e Sindromës Taura	2	2	150	Në periudhën e vitit kur temperatura e ujit ka gjasa të arrij nivelin më të lartë vjetor	2 muaj
Infeksioni me virusin e sindromës së kokës së verdhë	2	2	150	Në periudhën e vitit kur temperatura e ujit ka gjasa të arrij nivelin më të lartë vjetor	2 muaj

Tabela 2. Skema specifike për mbikëqyrjen duke përfshirë vizitat shëndetësore dhe marrjen e mostrave në stabiliment për nekrozën hematopoetike epizootike në kafshët e ujit ⁽¹⁾

Lloji i stabilimentit	Numri i vizitave mjekësore në vit (2 vjet)	Numri i mostrave të marra në vit (2 vjet)	Numri i peshqve në kampion Numri i peshqve në rritje	Numri i peshqve të stoqeve riprodhuese (2)
a) Stabilimente me specie për mbarështim	2	2	150 (Inspektimi i parë dhe i dytë)	150 (Inspektimi i parë dhe i dytë)
b) Stabilimente vetëm me specie për mbarështim	2	1	0	150 (2) (Inspektimi i parë dhe i dytë)
c) Stabilimente pa specie për mbarështim	2	2	150 (Inspektimi i parë dhe i dytë)	0

Numri më i lartë i peshqve në vaskë: 10

(1) Marrja e mostrave të peshqve për ekzaminim në laborator kryhet kur temperatura e ujit është ndërmjet 11 dhe 20 °C. Kërkesa për temperaturën e ujit zbatohen gjithashtu edhe për inspektimet shëndetësore. Në vendet ku temperatura e ujit nuk arrin 11 °C gjatë vitit, marrja e mostrave dhe vizitat shëndetësore kryhen kur temperatura e ujit është në nivelin më të lartë.

(2) Mostrat nga stoqet riprodhuese nuk përfshijnë lëngje gonadale, spermë ose vezë, pasi nuk ka prova që nekroza hematopoetike epizootike shkakton infeksion të traktit riprodhues.

2. Kohëzgjatja e masave kontrolluese në zonën e mbikëqyrjes

Sëmundjet e kategorisë A	Periudha minimale e mbikëqyrjes
Infeksioni me <i>Mikrocytos mackini</i> (mikrocitoza)	3 vite
Infeksioni nga <i>Perkinsus marinus</i>	3 vite
Infeksioni me virusin e sindromës Taura	2 vite
Infeksioni me virusin e sindromës së kokës së verdhë	2 vite
Nekroza hematopoetike epizootike	2 vite

Kur periudha e mbikëqyrjes ka mbaruar dhe nuk ka pasur asnjë konfirmim të ri të infeksionit me sëmundjen përkatëse të kategorisë A, masat në zonën e mbikëqyrjes hiqen siç parashikohet në nenin 101 të kësaj rregulloreje.